

Epigrafi dhe fjalia e parë e romanit “Ana Karenina”:

A JANË PËRKTHYER SAKTË NË SHQIP?

Dhe dy pyetje që vijnë natyrshëm:

1. A mund të ketë ndikuar përkthimi i kësaj fjalie në fjalorët shqip-gjuhë e huaj; gjuhë e huaj-shqip?
2. Po në përjashtimin nga fjalori i gjuhës shqipe (2020) të mbiemrit të nyjshëm “i palumtur”?

Nga Bujar Hudhri



ÇMIMI “LUMO SKËNDO”
PËR VEPRËN MË TË MIRË
nga Uran Butka (fq. 13)

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani i Agron Tufës
*Ngjizja e papërlyeme si
epiqendër e një dhune kolektive*

Nga *Ballsor Hoxha* (fq. 16)

RIKARD LJARJA – NJË IMAZH
LËVIZËS NË KOHË

Nga *Josif Papagjoni* (fq. 6)

Mbi “Arbëreshët midis realitetit dhe mitit”
të autorit Fatmir Toçi

ARBËRESHËT – KRAHU
I SHQIPTARISË

Nga *Prof. dr. Hysen Matoshi* (fq. 7)

ENË KOMUNIKIMI

ME VASSILIKI RAPTIN

Nga *Prof.ass.dr. Maklena Nika* (fq. 21)

Mbi romanin “Kënga e Bilbilit”
nga autori bullgar Stefan Ivanov

LIRIA NË PIKËPYETJE

Nga *Dr. Eris Rusi* (fq. 15)

FJALORI FISHTJAN

I FRANO KULLIT

Nga *Ernest Marku* (fq. 17)



– Proza romanore e Fatos Kongolli –

REALIZËM
PSIKOLOGJIK NË
STRUKTURA MODERNE
E MODERNISTE

(fq. 8)

Nga *Bashkim Kuçuku*

Dy poezi të G.

Capparozzos, përkthyer
prej Ndre Mjedës dhe
Ernest Çobës

(fq. 5)

Përgatitur nga *Andreas Dushi*

ABSURDITETI I LUFTËS:
"DASHURIA ËSHTË NË
AJËR" E BANSKY-T

Nga *Sotheby's* (fq. 20)



BIBLIOTEKË

Xhevair Lleshi (fq. 11)

Fqinja e dikurshme

Flurans Ilia (fq. 12)

Dy tregime

Jani Malo (fq. 14)

Shpjegim për orët

Dafjola Nepravishta (fq. 15)

Në qiellin tim bien yje

Kristoffer Leandroer (fq. 18)

Poemë e pastrehë (Përktheu

Besnik Mustafaj)

Pier Paolo Pasolini (fq. 19)

Kundër flokëve të gjatë

George Wallace (fq. 23)

Poeti

PENGU I KOMPENSUAR
I NJË PROJEKTI
TË PAREALIZUAR

nga *Shaip Beqiri* (fq. 10)

Cézanne, GRATË QË
BËJNË BANJË

Dr. *Bledar Kurti* (fq. 22)

Epigrafi dhe fjalia e parë e romanit “Ana Karenina”: A JANË PËRKTHYER SAKTË NË SHQIP?

Dhe dy pyetje që vijnë natyrshëm:

1. A mund të ketë ndikuar përkthimi i kësaj fjalie në fjalorët shqip-gjuhë e huaj; gjuhë e huaj-shqip?
2. Po në përjashtimin nga fjalori i gjuhës shqipe (2020) të mbiemrit të nyjshëm “i palumtur”?

Nga Bujar Hudhri

Shkrimtari dhe kritiku i shquar italian Claudio Magris shprehet diku në lidhje me ripërkthimin e letërsisë klasike se “kryeveprat e mëdha duhet të përkthehen pothuajse për çdo brez, sepse ato përmbajnë një potencial të fshehur...”. Dhe veprat klasike kudo në botë ripërkthehen, ashtu sikundër edhe te ne. Në anglisht janë mbi 15 përkthime të “Iliadës”. Në rusisht mbi 40 përkthime të “Hamletit”. Po përse është e nevojshme që veprat klasike të ripërkthehen? Do të rreshtonim disa faktorë, si cilësia jo e mirë e përkthimeve të mëparshme, vjetrimi i përkthimit kundrejt kohës kur jetojmë. Tani mund të jenë botuar komentare për të shpjeguar këto vepra klasike, janë botuar variante dorëshkrimesh, kujtime, letra, ditarë të autorëve apo të të tjerëve mbi autorin. Të gjitha këto nuk mund të dihen më parë. Kjo e ka bërë më të lehtë punën e përkthyesit, krahasuar me vite dhe dekada kur janë përkthyer për herë të parë apo të dytë. Shpesh paraqiten raste kur nga këto shpjegime kemi edhe një kuptim të ri, të saktë, të tekstit. Po ashtu sot kemi ndihmën e pakufishme të internetit, që na jep mundësi të konsultohemi me studime dhe variante përkthimesh në gjuhë të tjera. Ripërkthimet, përveç të tjerash, janë një fat i madh për lexuesin dhe kulturën e çdo vendi. Kështu letërsia më e mirë vijon të jetë e pranishme, edhe më e afërt për kohën që jetojmë, sidomos për brezin e ri të lexuesve.

Një nga veprat klasike që ripërkthehet shpesh është “Ana Karenina”, e cila që nga viti 1878, kur u botua për herë të parë, njihet rreth një mijë botime në të gjitha gjuhët e botës. Vetëm në shqip, e botuar pothuaj 60 vjet nga botimi i parë në origjinal, brenda harkut të 65 vjetëve, kemi tri variante përkthimi. Varianti i parë është botuar në vitin 1936 nga shtëpia botuese “Ora” dhe është përkthyer nga Tajar Zavalani; varianti i dytë, i botuar më 1961 nga “Naim Frashëri”, është përkthyer nga Vedat Kokona dhe i treti, me përkthyes Jorgji Doksani, është botuar nga “Neraida” më 2000.

Do të ishte normale të shtronim pyetjen për versionet shqip: a janë vjetruar këto përkthime? Nga njëri variant në tjetrin a kemi përmirësim? Apo, për nevojën të tregut, ka pasur ngutje dhe kemi bërë hapa pas? Kjo është një detyrë që do të kërkonte shumë mund, kohë dhe hapësirë për një gazetë, ndaj në këtë shkrim, pa hyrë fare në brendësi të përkthimit të kësaj vepre rreth 1000-faqëshe, do të përqendrohemi nëse janë përkthyer saktë dy elementet më të rëndësishme që gjenden në krye të romanit, menjëherë pas titullit “Ana Karenina”: epigrafi dhe fjalia e parë e romanit.

1. EPIGRAFI I ROMANIT

Në përkthimin e Zavalanit nuk ekziston asnjë epigrafi. Në fondin e Bibliotekës Kombëtare, ku gjendet përkthimi i tij, shohim që romani shoqërohet me një parathënie të përkthyesit dhe direkt fillon pjesa e parë. Pra, është e pamundur (besoj) që kjo fletë të jetë e shkëputur nga libri.

Në variantin e Kokonës kemi këtë përkthim të epigrafit:
“Mua më përket **shpagimi** dhe unë do të **shpaguhem**.”

Krejt ndryshe e përkthen Doksani 40 vjet më vonë:
“**Ndëshkimi** bie mbi mua, unë do të **shpaguaj**.”

Sikundër mund të shihet, kemi këto dallime:
Kokona emrin në rusisht **отмщение** e përkthen korrekt **shpagim**, ndërsa



Doksani po këtë emër e përkthen pasaktësisht **ndëshkim**. Kokona foljen në rusisht **воздам** e përkthen pasaktësisht në trajtën joveprore **shpaguhem**, ndërsa Doksani po këtë folje e përkthen korrekt në trajtën veprore **shpaguaj**.

Duke i analizuar të gjitha dallimet që vërejtëm më sipër, **mendoj se as Kokona dhe as Doksani nuk e kanë përkthyer saktë epigrafin.**

Në origjinal, teksti i epigrafit është:

«(1) Мне (2) отмщение (3) и (4) аз (5) воздам».

(1) “**Мне**”, përemri “**unë**” në rasën dhanore. Gjuhëtarët thonë që kjo formë e përemrit vektor “**unë**” në gjuhën e vjetër kishtare sllave përkon sot me kuptimin e përkatësisë. [imja, imi].

(2) “**отмщение**” në shqip përkthehet “**hakmarrje / shpagim**”.

(3) Lidhëza **и** përkthehet në shqip [dhe]

(4) «**Аз**» -është përemri vektor “**unë**” në rusishten e vjetër, sepse në rusishten e sotme ky përemër vektor është «**я**» [unë].

(5) **воздам** në shqip ka kuptimin: “**shpaguaj, marr hak, hakmerrem, ia kthej dikujt me të njëjtën mënyrë.**”

Si përfundim, mendoj se epigrafi mund përkthehet kështu:

“Imja është hakmarrja dhe unë do të hakmerrem/do të shpaguaj”.

Në pjesën e tretë të “Historisë së letërsisë ruse të shek. XIX” mësohet se nga buron ky citat: *Romani [Ana Karenina] hapet me një epigrafi të marrë nga Bibla: «Мне отмщение, и аз воздам». Kuptimi krejtësisht i qartë i thënies biblike bëhet shumëkuptimësh kur përpiqen ta trajtojnë në lidhje me përmbajtjen e romanit. Në këtë epigrafi duken gjykimi i autorit për heroinën dhe po ashtu mbrojtja e saj prej autorit. Epigrafi perceptohet edhe si një kujtesë për shoqërinë, se si asaj nuk i takon e drejta për të gjykuar njeriun. Shumë vjet më vonë Tolstoi e pranoi se e zgjodhi këtë epigrafi që “të shprehte mendimin që ajo e keqe që njeriu kryen, ka si pasojë gjithçka të hidhur, që i vjen jo nga njerëzit, por nga Zoti dhe këtë e provoi mbi vete edhe Ana Karenina.*

(История русской литературы XIX века. В 3 ч. Ч. 3 (1870—1890). Автор: Ауэр Александр Петрович, Вершинина Наталья Леонидовна, Капитанова Людмила Анатольевна)

Epigrafi, pra, është marrë nga Dhiata e Re, letra e apostullit Pal drejtuar romakëve, 12:19. Sikurse mund të vihet re, këtij teksti kanonik Tolstoi i ka shtuar lidhëzën “dhe” [союз И]. Sipas studiuesve, Tolstoi e ka bërë që t’i largohet paksa shkrimit të shenjtë dhe t’i afrohet gjuhës së përditshme.

Përkthimi i këtij epigrafi gjendet në variantin shqip të biblës, në letërën e apostullit Pal drejtuar romakëve: 12:19. “Mos u hakmerreni për veten tuaj, o të dashur, por i jepni vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkruar: **‘Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpague’**, thotë Zoti”.

Krahasuar me citatin e mësipërm të biblës, mund të argumentojmë pse Kokona dhe Doksani kanë gabuar:

1. **Kokona e përkthen:** “Mua më përket shpagimi dhe unë do të shpaguhem”. Meqenëse këto janë fjale të Zotit, atëherë nuk mund të jenë në vetvetore, “shpaguhem”, se Zoti nuk merr hak për veten e tij (**SHPAGUHEM** vetv. 1. **Marr hakun**, hakmerrem për një të keqe që më kanë bërë. *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2020),

por marr hak për të tjerët (**SHPAKUJ** 1. E ndëshkoj dikë në shenjë hakmarrjeje, **i marr hakun**. *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2020).

2. Doksani e përkthen: “**Ndëshkimi** bie mbi mua, unë do të shpaguaj”. Meqenëse këto janë fjalë të Zotit, nuk mund të bjerë “ndëshkimi” mbi Zotin, sepse askush mund ta ndëshkojë atë, por Zotit i përket “shpagimi” (**SHPAKIM m.1**. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve **SHPAKUJ, SHPAKUEM**. *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2020).

2. FJALIA E PARË E ROMANIT

Fjalja hyrëse e romanit për çdo shkrimtar serioz është vendimtare, sepse ajo mund ta afrojë, por edhe mund ta largojë lexuesin. Ky është rasti kur ndeshen të tre për herë të parëD .he shkrimtari s’mund ta humbë assesi këtë takim. Ka autorë, si Marquez, Stephen King, që mund të harxhojnë muaj, disa herë vite, për të gjetur fjalinë e parë më të përshtatshme. Ka plot shembuj nga letërsia botërore ku fjalitë e para të nguliten në kujtesë, edhe pse mund ta kesh harruar apo mund edhe të mos e kesh lexuar romanin, sepse tashmë këto janë bërë ikonike.

Dhe një ndër më të bukurat fjali të para në letërsinë botërore është, pa dyshim, në romanin “Ana Karenina”:

Все **счастливые** семьи похожи друг на друга, каждая **несчастливая** семья **несчастлива** по-своему

Kjo fjali është në kohën e tashme, ndërkohë që i gjithë libri është shkruar në kohën e shkuar. Tolstoi ka dashur që kjo fjali të jetë si një kornizë, përmes së cilës lexuesit mund të rrokin të gjithë romanin, shkruan një nga studiuesit e tij.

LE TË SHOHIM SE SI ËSHTË SJELLË NË SHQIP NGA TRE PËRKTHYESIT

1. Tajar Zavalani

“Të gjitha familjet **e lumtura** janë **njësoj**, kurse çdo familje **fatkeqe** ndryshon nga të tjerat.”

E ndajmë fjalinë në dy pjesë për ta analizuar:

a)Pjesa e parë e fjalisë “Të gjitha familjet **e lumtura** janë **njësoj**” **nuk është përkthyer saktë,**

sepse Tolstoi nuk ka shkruar se familjet e lumtura janë njësoj (**në këtë rast do të ishte odinakovyе=одинаковые**) [**njësó**] ndajfolje; në po atë mënyrë, pa dallim; në po atë masë, barabar (sipas: *Fjalor i gjuhës shqipe*), por janë të ngjashme (**pokhozhi drug na druga=** похожи друг на друга) [**ngjash/ëm (i), -me (e)** mbiemër; që ngjan shumë me një tjetër (sipas: *Fjalor i gjuhës shqipe*).

b) Edhe pjesa e dytë e fjalisë: “kurse çdo familje **fatkeqe** ndryshon nga të tjerat.” **nuk është përkthyer saktë,**

sepse mungon togfjalëshi [**është fatkeqe**]: Tolstoi përdor figurën stilistikore të përsëritjes për të theksuar, apo për të vënë në pah, mbiemrin **fatkeq** për familjet. Nuk mund të lejohet një shkurtim i tillë i tekstit, sepse përkthyesi nuk mund ta zëvendësojë autorin, por vjen pas tij.

2) Përkthimet e Vedat Kokonës dhe Jorgji Doksanit janë pothuaj identike:

Të gjitha familjet **e lumtura** i ngjajnë njëra-tjetrës, çdo familje **fatkeqe** është **fatkeqe** ndryshe nga të tjerat.

(Vedat Kokona, 1961)

Të gjitha familjet **e lumtura** i ngjajnë njëra-tjetrës, çdo familje **fatkeqe** është **fatkeqe** në mënyrën e vet.

(Jorgji Doksani, 2000)

PASAKTËSIA E TRI VARIANTEVE NË SHQIP

Në variantet e përkthimit në shqip (Zavalani, Kokona, Doksani) vërehet se në pjesën e dytë të saj, mbiemri **несчастливая** sipas tyre përkthehet **fatkeqe**.

Pse mendoj se nuk është përkthyer saktë?

Sepse Tolstoi në fjalinë e parë ka krijuar një çift **antonimik** të mbiemrave [: счастливая – несчастливая / i lumtur-i **palumtur**].

Në gjuhën ruse mbiemri **счастливая /e lumtur** me ndihmën e parashtesës [**не**] bëhet **несчастливая /e palumtur**, sepse (parashtesa **не=приставка не...**) [ashtu sikundër në gjuhën shqipe] përdoret për formimin e emrave dhe mbiemrave dhe shënon kundërshtinë e plotë të asaj që shpreh fjala pa këtë parashtesë): në këtë rast, mbiemri **счастливые**, duke marrë parashtesën **не**, bëhet **të palumtura** dhe jo **fatkeqe!**

Mbiemri në shqip [**fatkeq**] është një fjalë e përbërë dhe nuk formon çift **antonimik** me mbiemrin e nyjshëm [**e lumtur**], por me [**fatlum**]. Duke e krahasuar këtë fjali me përkthimet në gjuhët e tjera mendoj se kjo fjali e parë e romanit duket sikur të jetë përkthyer nga frëngjishtja.

Ja varianti frëngjisht:

“Toutes les familles **heureuses** se ressemblent, mais chaque famille **malheureuse** l’est à sa façon.»

Mbiemri [**malheureuse**] përkthehet në shqip **fatkeq** dhe është një fjalë e përbërë. Arsye tjetër pse mendoj se vjen nga varianti frëngjisht është sepse Tajar Zavalani ka mbaruar kolegjin francez në Korçë, Selanik, Francë. Një njohës i shkëlqyer i frëngjishtes, ai mund të përkthente nga rusishtja në frëngjisht. Po ashtu, edhe përkthyesi i njohur Vedat Kokona ka qenë një njohës i shkëlqyer i frëngjishtes.

Për dy versionet e para (Zavalani, Kokona) mund të jemi mirëkuptues deri diku, përdërisa mbiemri **i palumtur** haset për herë të parë në fjalorin e gjuhës shqipe më 1980 (megjithëse ishte shumë e lehtë të krijohej ky neologjizëm si kalk nga gjuhët e tjera).

Në rastin e përkthimit të vitit 2000 nga Doksani, i cili ka studiuar në Moskë për gjuhë ruse dhe gjithë jetën është marrë me rusishten, do të ishte normale që kjo pasaktësi të shmangej. Shto këtu që ai ka përkthyer pas vitit 1990 mijëra faqe nga shkrimtarët më të rëndësishëm rusë, madje edhe në kolana. E theksoj këtë posaçërisht, sepse çdo përkthim pasardhës duhet të jetë patjetër më i saktë, ndryshe ç’kuptim ka pse bëhet.

E krahasojmë këtë fjali edhe me përkthimet në gjuhët kryesore europiane:

1. **Happy** families are all alike; every unhappy family is **unhappy** in its own way.

2. Alle **glücklichen** Familien sind einander ähnlich; jede **unglückliche** Familie jedoch ist auf ihre besondere Weise **unglücklich**.

3. Toutes les familles **heureuses** se ressemblent, mais chaque famille **malheureuse** l’est à sa façon.

4. Las familias **felices** son todas iguales; cada familia **infeliz** es **infeliz** a su manera.

5. Le famiglie **felici** sono tutte uguali; ogni famiglia **infelice** è **infelice** a modo suo.


6. As famílias **felizes** são todas iguais; toda família **infeliz** é **infeliz** à sua maneira.

Sikundër mund të vihet re, mbiemri **несчастливая** me ndihmën e mbiemrave të formuar me parashtesën mohuese [pa] në shqip ; [**un**] në anglisht; [**un**]- në gjermanisht; [**in**]- në spanjisht, italisht dhe portugalisht, përkthehet saktë nga rusishtja.

Ndërsa në të tria përkthimet në gjuhën shqipe nuk është gjendur fjala e duhur.

Do të përmendja me këtë rast një thënie të Mark Tueinit:

“Ndryshimi midis fjalës së duhur dhe pothuajse të duhur është shumë i madh. Sikundër një xixëllojë ndryshon nga vetëtima.”



A KA NDIKUAR KJO FJALI E PARË E “ANA KARENINËS” NË HARTIMIN E FJALORËVE SHQIP-GJUHË E HUAJ DHE ANASJELLTAS?

Në pamje të parë duket sikur kjo pyetje është pa kuptim, vërtet. Por do të theksoja në këtë rast (pa kaluar në temë tjetër, shpresoj) se pikërisht kjo fjali e parë (e përkthyer nga Zavalani, Kokona, Doksani) ka ndikuar që në fjalorët dygjuhësh (shqip-gjuhë e huaj; gjuhë e huaj-shqip).

Ja konkretisht:

1. Në fjalorin rusisht-shqip, me autorë M. Mançe, L. Dhimitri, Xh. Zyka, N. Malo (EDFA, 2005), **nuk e kanë përfshirë mbiemrin НЕЧАСТЛИВЫЙ**, -ая, -ое; -лив, -а, -о. [i palumtur] që gjendet në fjalorin e romanit “Ana Karenina” (1878), ndërsa gjendet mbiemri НЕЧАСТНЫЙ, -ая, -ое; -тен, -тна, -тно. - që përkthehet si 1. fatkeq; 2. i kobshëm. Vetëm **me këtë shembull mund të konkludojmë se tri variantet në shqip janë përkthyer pasaktësisht**, sepse automatikisht НЕЧАСТЛИВЫЙ i bie të jetë [i palumtur].

2. Këtë dilemë të mospërbaljes me mbiemrin **i palumtur** mendoj se e kanë pasur edhe dy hartuesit e fjalorëve gjermanisht-shqip; shqip-gjermanisht dhe anglisht-shqip; shqip-anglisht.

a) Fjalor shqip-gjermanisht (50.000 fjalë) i Ali Dhrimos

Mbiemri në shqip **i palumtur** përkthehet gjermanisht **unglücklich** (faqe 905).

Pas dy vjetësh, po ky mbiemër në gjermanisht **unglücklich** përkthehet në shqip **fatkeq, fatzi, fatlig, orëzi, ditëzi, derëzi**. [Fjalor gjermanisht-shqip (61.000 fjalë) i Ali Dhrimos]

b) Fjalor shqip-anglisht (me 45.500 fjalë) i Pavli Qeskut

Mbiemri në shqip **i palumtur** përkthehet në anglisht **unhappy**. (faqe 517)

Pas dy vjetësh, po ky mbiemër në anglisht **unhappy** përkthehet në shqip **fatkeq, fatzi**. (faqe 1861)

[Fjalori i madh anglisht-shqip (me 126.000 fjalë) i Pavli Qeskut]

c) Fjalori italisht-shqip (50.000 fjalë) i F. Lekës dhe Z. Simonit. **felice**-

përkthehet **-i lum, i lumtur**, ndërsa **infelice**- mb. **fatkeq, fatzi** (faqe 561)

d) Fjalori spanjisht-shqip (50.000 fjalë) i Kristofor Ndreut. **feliz**-

përkthehet **-i lum, i lumtur** ndërsa **infeliz**- mb. **fatkeq, fatzi**,

MBIEMRI I PALUMTUR ËSHTË HEQUR NGA FJALORI I GJUHËS SHQIPE 2020

Nëse do të konsultoheshim me këta fjalorë, për çudi, mbiemri i nyjshëm **i/e palumtur** gjendet në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (1980), *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* (2006), por është zhdukur në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (?) në botimin e vitit 2020*.

Shkrimtarët dhe studiuesit që e përdorin këtë mbiemër janë të shumtë. Mbase gjuhëtarët tanë nuk po lexojnë shumë letërsi artistike, sepse si mund të justifikohet përjashtimi i këtij mbiemri nga fjalori më i fundit i gjuhës sonë?

Mendimi im është se, nëse në variantin e përkthimit të këtij romani qysh në vitin 1961 (V. Kokona) do të ishte krijuar dhe përdorur mbiemri **i palumtur**, nuk do të ishin vërejtur anomalitë e mëvonshme që i përshkruam më sipër.

Duke qenë fjalia e parë e një kryevepre botërore, e cila ka pasur disa breza lexuesish, shumë prej të cilëve e dinë përmendësh, ky mbiemër do të ishte ngulitur fare lehtë jo vetëm në gjuhën librore, por edhe në gjuhën e përditshme.

Do të sillja si shembull vargun e parë të poezisë së Migjenit “**Na**, të birtë e shekullit të ri”. Përemri vector “**Na**”, është ngulitur në memorien tonë kulturore, megjithëse të gjithë respektojmë standardin e gjuhës shqipe për vetën e parë shumë që është përemri “**ne**”.

PËRFUNDIM

Një variant i katërt në shqip i romanit “Ana Karenina”, sikur të isha unë përkthyesi, do të kishte këtë fillim:

Epigrafi:

“Imja është **hakmarrja** dhe unë do të **shpagoj**”.

Fjalia e parë e romanit:

Të gjitha familjet **e lumtura** i përngajnë njëra-tjetrës, **çdo** familje e **palumtur**, është e **palumtur** ndryshe.

I ndodhur përballë tre përkthyesve të njohur dhe një kryevepre botërore, nuk mund të mos pranoj, modestisht, se dikush, dikur, në të ardhmen, do të na e sjellë edhe më mirë këtë përkthim, sepse, sikundër thotë me të drejtë filologu dhe papirologu i shquar italian, Marcello Gigante: “Homeri mbetet, ndërsa përkthyesit e tij shkojnë e vijnë... Përkthimi është një vepër e papërkryer, e paplotë, një vepër e hapur... Nesër është një ditë tjetër: Fillon jeta e re e klasikes antike.”

DY POEZI TË G. CAPPAROZZOS, PËRKTHYER PREJ NDRE MJEDËS DHE ERNEST ÇOBËS



Përgatitur nga Andreas Dushi

Deri më sot, akoma nuk ka ardhur në gjuhën tonë një përkthim i plotë i një vepre, e aq më pak i gjithë korpusit letrar, të poetit italian Giuseppe Capparozzo. Ai lindi më 1802 dhe vdiq në moshë të re, 45 vjeç. Ishte mësues i letërsisë në Vicenza e mandej në Veneto e Ceneda, për ta mbyllur jetën në Venecia, me 13 maj të 1848.

Ai nuk ishte i përkushtuar vetëm ndaj mësimdhënies, por edhe besimit, prandaj një pjesë e krijimtarisë së tij poetike ka pikërisht të tillë tematikë. Kronologjikisht, ai i përket romantizmit italian, ndërsa realisht, mbetet i hapur diskutimi nëse ishte vërtetë një poet romantik apo jo, pasi në fillim, tipare të tilla mungojnë, ndërsa në poezitë e fundit, shohim se bëhen gjithmonë e më të pranishme.

Nga poezitë e tij, kam arritur të gjej dy të ardhura në shqip. Përkatesisht “Vllavrasi” përkthyer nga dom Ndre Mjeda, botuar në “Juvenilja”, 1917 dhe “Urata e mbrâmjes”, përkthyer nga mons. Ernest Çoba, botuar në “Keze të hueja”, 2020. Për datën e përkthimit të realizuar nga Mjeda, nuk kemi të dhëna ndërsa përkthimi i Çobës mban datën 24 tetor, 1930. Në fund të këtij përkthimi, vendoset edhe një shënim nga përkthyesi:

“Ky shkrimtar, lé në vjetë 1802 e dekë më 1854, shkruini të gjith jeten e vet tue msue djelmnin, e perbani shum pojezi lyrike, nder të cillat disa me subjekt fetar; apologë, epigrame. Vjershat i ká shum të rrjedhshme e të permállshme, nder të cillat mund të

shijohet edhe në giuhë t'onë pojezia. *Vllavrasi*, sjellë aq originalisht e rrjedhtas shqyp sá nuk mund të dálë e perkthyme, prej pëndës s'artë të D. Ndre Mjedës.”¹

Kontributi letrar i mons. Çobës është bërë i njohur vonë², ndërsa për jetën e tij shkruhet qysh heret. Në botimin e parë të realizuar për të

¹ Monsinjon Ernest Çoba, “Keze të hueja”, botuar nën kujdesin e Lisandri Kolës, “Forentia”, 2020, fq. 36.
² Për më shumë, lexo “Kunora e përkthimeve të monsinjon Ernest Çobës” nga Lisandri Kola, parathënia e librit të cituar më lart, fq. 7 – 15.



rrëfyer jetën e meshtarëve katolikë shqiptarë që vuajtën gjatë komunizmit, për të thuhet:

“Imzot Ernesto M. Çoba u lind me 16 shkurt 1913. Rrjedh nga një familje e vjetër qytetare shkodrane. Mësimet e para e të mesme i ka krye në Kolegjin Saveriane e në Seminarin Papnur. Asht shugure meshtar me 9 shkurt 1936. Ka shërbye në detyra të ndryshme pranë seminarit Papnur e si mësues i besimit edhe në shkollat e qytetit.

Ka krye njeherit detyrën e zv/famullitarit e të famullitarit të Shkodrës pas vdekjes së Imzot Thaçit dhe arrestimit të Monsinor Mikel Koliqit. Së bashku me Imzot Pjetër Demën asht shugurue ipeshkëv nga Imzot Bernardin Shllaku në Prill të vitit 1952. Pas vdekjes së Imzot Shllakut ka drejtue dioçezin e Shkodrës. Me mbylljen e Kishave ka qëndrue në familje. Asht arrestue në vitin 1976 dhe dënue me 25 vjet me motivacionin ‘Ka mbajtur lidhje me Selinë e Shejtë me anë të legatës Italiane për çështje fetare’. Vuajti dënimin në Tiranë deri sa vdiq në spitalin e burgut po në atë qytet, më 8 janar 1980.”³

Në vijim po paraqesim dy poezitë e Capparozzos, përkthyer prej Mjedës e Çobës.

VILÁVRÁSI

shqipëruar nga Mjeda

Neper terr qi lëshote nata.
Ngarkue teshat kaliboç,
Per një pýllë kù s rá kurr spata,
Ndiqte rrugen një djaloq.

Landët e pýllës si’j ujk ju dukshin,
Qi prei újet n’mal luron;
Cuba t’rrebtë, qi n’prit’u strukshin,
Gjethet e lisave kujton.

O Shqypnii! gjimote i shkreti,
Male, mbushë me gjuetarë plot;
Késoll’e bardhë, kù pors mbreti
Shkon barija dit e mot.

O ju lugje te Prevezes!
Këtú mue zëmra po m’ vajton;
Te ju hâna me dritë t’rrezes
Shtigjt udhtarit ja kalxon.

Fis i dashtun, kù n’dritë dola
Afer détit t’pápshtjellim;
Shpi e bardhë kù s’parit fola
N’prêhen t’nanës tui gjetë pushim.



Njeshtú thot’e me trimnië
U nis udhës shtegtari prap:
Fishkloj landa tu’u perzië
E prei frigës ngau djali vrap.

Por n’nji cub mbas gardhit hasi;
Nдалu, i thotë, nuk ké kah mba!
Nji kubure n’bri ja rراس,
E mbi tokë permbyz e la.

Ah! nanë shkreta! i shuemi briti,
E permbyz u lëshue mbi’j curr;
Per tre muej e shkreta m’priti,
E tekëndeje nuk m’shef má kurr.

Po jot’âme, si per qestië,
Ja bân gjaksi me idhnim plot;
Ti m’difto kù rri me shpië,
Fjala e jote nuk hupë dot.

N’skaj t’Shqypnis shkon vorfnisht jeten,
E pá djelm e mjera mbet;
Dy má t’mëdhajt nder luftna mbeten,
E ketú i treti qe po jet.



Pat një tjetrë.... fija e zânit
Ju kput djalit e gjimoj;
U dridh gjaksi, e aj farë luânit
Pushken n’tokë me’j herë e lëshoj.

Pat një tjetre, qi ajo e dote
Permbi dritë të syve vet;
Kurr prei prehnit nuk e lëshote
Shokë nder cuba vojte e gjet.

Vllá, i pergjegji zëmervshtiri,
Njitú t’vrava e këtú po des;
Nuk kam sy me m’pá má njeri.
Ngryk’me t’ý njito po jes

Jo, ti shëndosh! e fill te shpija
Te nanë zeza fluturò:
Pa asnji fëmij, e mbytë vetmija,
E mbëlton skami: mos e lësho.

Shka t’i tham mandej nanës ngratë.
N’kjoftë se pvetë per ty ndoj send?
Thuej se mora një rrugë t’giatë
Se bashkë n’qiehell dikúr xâm vënd.

URATA E MBRÂMJES

shqipëruar nga Çoba

Vertë e ambel ásht urata
e njajë zëmres s’pásherri
kúr kaluemun teksá nata
drita e diellit nisë me gdhi,
por má e ambel á e urates
në heshtinë e muzgut t’natës.

Kúr shtegtari i perkushtuem
n’cak t’nji udhe hapin ngurrë
e lodhun e pá pushuem
ulet ndëjun mbi një gúr
edhë n’paq ja thotë uratës
në heshtinë e muzgut t’natës.

E n’mungade e neper déta
kù má e mshefët po ishte hija
shkon nder vënde t’mbyllme e t’shkreta
nieri i dhanun kah vetmija,
n’per dhambë tue ja thanë një uratës
në heshtinë e muzgut t’natës.

Tue pergjegjë si rrin jehona
neper pyrgje të ndertes’e
létë e létë njáshtú kumbona
qe, po ndíhet tue dënese
e u bâhet shoqe uratës
në heshtinë e muzgut t’natës.

Qajò qi nalt në qiellë
Ishon mbí në një t’shndritun t’zbëtë,
qajò rê qi se po pshtiehellë
duket diell’n gati t’pájetë
shqim të fton n’t’thanun t’uratës
në heshtinë e muzgut t’natës.

Edhë hyjt qi të shkretuem
reshin rreze aq t’gazmueshme
janë dritarët e pámbaruem
qi t’krijesës n’ndertës t’mreklueshme
madhëni i apin uratës
në heshtinë e muzgut t’natës.

N’çdhëna, vall, n’t’cillat briqe
kù tue ushtue ndihet zâ njerit
n’t’cillen breshtë, n’t’cillat zgavrriqe
jeton gjinde aq permndërit
qi n’lavd t’Hyut s’ja thotë një uratës
në heshtinë e muzgut t’natës.

24-X-1930

3 “Martirizimi i Kishës Katolike Shqiptare 1944 – 1990”, përgatitur nga një redaksi me drejtor Mons. Zef Simonin, Shkodër, 1993.

Shumë vetë mbeten në mbamendjen së njerëzve, më gjerë të komunitetit, shoqërisë, kombit, për do ndihmesa të papërsëritshme, të vetëmjaftueshme, qenësore në llojin e tyre. Kadare, për shembull, është një lojtar i famshëm i gjuhës, i fjalës, i ligjërit, i sfidave qytetërore, i ideve demistifikuese, i kredhjes në brendësitë e historisë dhe qenies kombëtare shqiptare etj. Sali Shijaku, Myslim Mulliqi, Gazmend Leka, Bashkim Ahmeti sjellin në kanavacë disa përfytyrime a shpërfytyrime që lidhen me njeriun shqiptar dhe tokën e tij, me arkeotipin, natyrën, qytetin a fshatin shqiptar, mitin, legjendat, turbullirat shpirtërore, me furitë e shpirtit, mistikën e desakralizuar apo të sendërtuar në imazhe surealiste, transhedentale. Dhe kështu muzika, teatri, arkitektura. Po Rikard Ljarja?

Sa e përmend këtë emër menjëherë ia beh në sy aktori ynë i njohur. Një yll i kinemasë, të tjerët i thonë Star. E ç'rëndësi ka fjala! Për mua ai ishte një imazh shëtitës në syrin dhe mendësinë e shqiptarëve. Një imazh human, i thjeshtë, i ëmbël, pranues. Imazh i njeriut të bukur, të pashëm, plot hir mashkullor. Imazh i një shqiptari të mirë, të thjeshtë, të pabëzaj. Sy që flet. Zë i bukur bariton. Imazh kinematografik rrallë i përsëritshëm më. Madje-madje, ai sikur është imazhi i krejt një kohe. Aktor, regjisor, skenarist dhe së fundmi shkrimtar. Gjithë këtë hapësirë shumëdimensionale e sjell edhe libri "RIKARDI - Nuk kam asnjë peng", botim i Onufrit, përgatitur nga Marjera Ljarja, e shoqja e tij, aktore e njohur, dhe Dashnor Kaloçi. Një libër malli, kujtimi e respekti për gjithë miqtë dhe artdashësit e tij...

Si strukturë është një libër mozaik: të tjerët për Rikardin dhe Rikardi për vete. Pastaj Rikardi për Shkodrën e tij, për botën shqiptare, për historinë, aromatin që vijnë nga eposet e lashta. "Fjalë, fjalë, fjalë..." - shkruan ai në parathënien e këtij libri. - S'kam ç'them. Është histori e gjatë, dhe nuk jam specialist i kësaj fushe. Por desha të them se të shkruarit letërsi nuk ka asnjë shpjegim të saktë sipas meje". Po, të shkruarit është një nga pushtetet e mëdha të mendimit, komunikimit, përcjelljes mbresalënëse të kumteve, zbrërthimit të mistereve të qenies njerëzore, qysh nga ravijëzimet e mureve nëpër shpella, më vonë me geramat mbi pllaka balte, papiruse, kuneifeore, hieroglif egjiptiane, arabe a kineze, gjer te "geramat" mbi ekran, imazhet lëvizëse. Rikardi nuk do tatuime mbi fjalën e tij, përkundrazi "dua të jem ashtu si jam, i vërtetë. Me të tëra gabimet. Pa më zbukuruar, korrigjuar, redaktuar, korrektuar e ku e di unë se çfarë. Dua të jem UNË."

Ti je "TI" Rikard, edhe te ky libër i yti dhe për ty. Je "Ti", tanimë më shumë si njeri, si mendimtar, afërmendsh edhe si artist teksa bën vlerësime për krijimet e tua në kinematografi, por edhe të të tjerëve, të kohës, të ndryshimit të mendësive, sistemeve politike, referencave morale. Një gjë që më ka lënë mbresë të ty Rikard është DINJITETI. Ti je ai që ke qenë, ai që je. Nuk u tundove nga lakadredhjet prej "bythëtundësish" e trushkullurish me qëndrimet e tyre ekstreme ndaj krijimeve, sëmundje foshnjore e "fillimit të fillimit", ku gjithçka e bërë me mundim e sakrificë më parë duhet flakur, duhet mohuar e asgjësuar. Por kjo psikologji dështoi, shoqëria nuk e qasi. Mbjaj mend një diskutim të rreptë që kemi bërë dikur në një emision me një filolog, Agron Tufa, dhe ndoca "antikomunistë" të ndezulluar, që kërkonin t'i ndalonin gjithë filmat e prodhuar para vitit 1990, se kinse ata qenë "filma të kuq". Çfarë marrëzie! Harronin se arti nuk ishte një zeje politike, as një poçë pas bishtit të qenit, por kishte në themel shpirtin e njeriut, sintezën e kohës. Dhe ai "shpirt" diku mes fjalëve, heshtjes dhe imazhit, "fle". Gjeje, or mik. Aty është e vërteta e njeriut. Pikërisht Rikard Ljarja kishte një qëndrim të kthjellët, sikurse pjesa më e shëndoshë e kineastëve tanë, që nuk e lejuan këtë "dumbabizëm" të ri kinse kulturor. Unë nuk kam qenë miku yt i ngushtë Rikard, por një ndër të shumtët e tu.

RIKARD LJARJA - NJË IMAZH LËVIZËS NË KOHË

Nga Josif Papagjoni

Dhe për këtë libër, ku ti je i vërtetë, po them dy fjalë të miat...

RIKARDI ishte artisti i filmave të shumtë shqiptarë, një imazh i shumëpërdorur nga të rinj e të vjetër, "imazh lëvizës", madje aq popullor dhe i kudogjendur sa u sajua dhe një anekdotë bash nga qyteti i tij i lindjes, Shkodra. Njerëzit sikur donin të identifikoheshin me këtë imazh. Sepse ai ishte pjesë e së mirës, e së bukurës, e njerëzores. Shkodran nga prindërit, ai lindi në Shkodër më 1 prill. Mbaroi Shkollën e lartë për Aktor "Aleksandër Moisiu" (1965) dhe më pas u emërua në Teatrin "Migjeni" të Shkodrës. Unë mbaj mend pak role të tij në teatër, paçka se teatri ishte për të një magji, një pushtet emocional i patejkalueshëm dhe i pakrahueshëm ose siç e quante ai në një shkrim të vetin "Shenjtëria e tij Teatri". Fati e çoi drejt kinematografisë dhe në vitet 1973-1996 punoi si regjisor në Kinostudion "Shqipëria e re", ndërsa më pas deri në v. 2002, kur doli në pension, ishte drejtor artistik në televizionin publik shqiptar. Qysh në fillim, i prerë për ekranin, ai u shqua për talentin e tij si aktor i filmit dhe shpejt u aktivizua në rolin e parë, atë të Dritanit te *Komisari i dritës* (1966), me të cilin krijoi një portret

të mëvetësishëm prej mësuesi atdhetar e të pushtuar nga ideat e bukura të diturimit të fëmijëve në malësi. Interpretimi i tij i dha këtij personazhi besueshmërinë, natyrshmërinë dhe prerjen njerëzore, përkundër skemave të një heroizmi bërtitës, imponues e "madhështor". Ai bëri një "revolucion" në mënyrën e aktrimit. U iku skemave të teatrit dhe loja e tij sollti modelin e një loje sa më të natyrshme e të vërtetë para kamerës, ku edhe një rrudhë, një gjest, një lëvizje syri bëhen tejet të dukshme. Heroi në qenien e tij erdhi i thjeshtë, pa fryrje, i besueshëm, burimor. Interpretimi i tij u bë model për artistët e tjerë të ekranit. Qe një hop. Suksesi i merituar që arriti me rolin e Dritan Shkabës i çeli shtigjet për t'u afirmuar si një nga aktorët më të kërkuar të kinematografisë në figurat e heronjëve të luftës e të punës, të cilët u interpretuan prej tij nga një sipëri e dukshme humane duke kërkuar në aktin heroik të thjeshtë dhe të domosdoshmen.

Një vit më pas interpretoi rolin e Skënder Gurit në filmin *Dueli i heshtur* (1967). Fotogjenia e tij, zëri i pastër bariton, vetësiguria dhe vetëpërmbajtja, të shoqëruara nga një qetësi e brendshme e veprimit psikik dhe aftësia për të krijuar

suspansën dhe kontrapunktet e nevojshme gjatë procedimit të aksionit filmik, krijuan gjasat që Rikardi të bëhet nga aktorët e parapëlqyer të regjisorëve. "Po mbushen afro 50 vjet që është xhiruar "Komisari i dritës" dhe pas tij edhe "Dueli i heshtur", - shkruan ai te ky libër. - Isha vetëm 23 vjeç atëherë. Oh, çfarë privilegji! Kanë kaluar pra 50 vjet dhe unë kudo ku kaloj, rrugës, në kafene, apo kudo ku janë njerëzit, vazhdojnë të më urojnë njësoj sikur filmi të ketë dalë dje. E çfarë duhet të them unë, "Poshtë komisari i dritës"?!"

Maja më e lartë që ai mbërriti në aktrim ishte Deda te filmi *Rrugë të bardha*, 1974. Prirja për t'i dhënë lojës vërtetësinë deri në detaje të veprimit njerëzor, në një situatë të jashtëzakonshme, ku përkushtimi i pabujë ndaj detyrës si fillrojtës për të lidhur linjat e këputura telefonike në kohë stuhie me borë, nga njëra anë dhe shpallësja e një shpirti të ndrojtur, të butë, poetik por këmbëngulës e vullnet-hekurt, nga ana tjetër, realizuan shkriren e të madhërishtes dhe heroikes me të thjeshtën dhe të zakonshën. Ai përputhi me sens mase veprimet e vërteta fizike prej fillërojtësi me ndjeshmërinë dhe fjalën e ngarkuar me emocion. Rikardi ka luajtur mbi 25 role në kinematografi, dhe veç figurave artistike të realizuara më sipër, spikati edhe te Naimi (*Plagë të vjetra*, 1969), Rrema (*Shtigje lufte*, 1974), Dino (*Radjostacioni*, 1979) etj. Loja e tij shënoi një stil të veçantë. Kryesisht ajo u trajtua në tone të ulta, të qeta, me një zë të ngrohtë, bindës dhe një portret filmik tërheqës, fotogjenik. Ai ishte, siç e cilëson edhe Marash Hajati në një shkrim për artin e tij, "mjeshteri i heshtjes". Është e vërtetë, Rikardi dinte ta luante për bukuri heshtjen, atë çka bulëzonte thellë gjendjes shpirtërore, anktheve, frikërave dhe vendosmërisë së tij. Te "Dueli i heshtur" ka aq shumë heshtje, domethënë veprime psikologjike pa fjalë, veçse me mimikë, me sy, një tension i brendshëm krejt. Edhe "Rrugë të bardha" po i tillë është: Aktori përballë tufanit, vdekjes, ecja mbi borë, telat, mërmërima, biseda me veten, vetëfljimi. E pra, nga kjo "heshtje", që s'ishte veçse shpirti i personazheve, buronte një ndjeshmëri e thellë njerëzore, tone meditative, ato lirike e poetike.

Në këtë libër, si element bazik, janë edhe mendimet e Rikardit në disa gazeta të kohës. Dhe këtu përfshihen intervistat me A. Markun, F. Kongolin, F. Nikollin, D. Kaloçin, A. Milen, A. Bardhylin, por edhe shkrime të dedikuara atij, ku spikat ai i Marash Hajatit. Paçka se shumëkush asaj kohe mund ta kërkonte modelin e heroit në caqet e një lloj butaforie (gjë e cila ka kapur për këmbësh shumë vepra të bukura arti), përkundrazi, loja e Rikardit dhe imazhi i tij sillte në ekran çuditërisht *Njeriun*. Heronjtë e tij, Dritani, Skënderi, Deda, Rrema etj., janë njerëz të thjeshtë, mbushur me shpresa e iluzione, të bukur, të afërt, pa qibër, vetëfljues, që çaponin mal mbi mal e pyll më pyll për t'u shërbyer njerëzve, qytezës, katundit, vendit. Pas përmbysjeve të mëdha e utopive të mëdha gjithnjë buisin edhe shpresa të mëdha. Njerëzit e dalë nga luftërat dhe shkatërrimet, sidomos të rinjtë, mëkoheshin pikërisht me këtë shpresë si mundësi përtëritjeje, si një ideal i bukur, i cili vishet nga pasioni njerëzor. I tillë ishte Dritan Shkaba. Ai vritet pas shpine, pabesisht. Ka dhimbje vdekja e tij, dhemb shpirti i gjorë. Sepse ai është një riosh, të cilit i pritet jeta në mes, i vritet një *ëndërr, një dashuri*. Dhe fle ky djalosh në një kasolle me kashtë, grumbullon ca fëmijë rrobe-grisur e të varfër, por me dritë në sy, dhe u jep mësim; është përhapësi i dritës, i diturisë, i "fjalës", si apostujt dikur motit që shpërndanin kumtin mesianik. "Diogjenë" të tillë janë të përhershëm dhe të përjetshëm. Po Deda të "Rrugë të bardha", cili është vallë? Paçka se një fillërojtës i thjeshtë skërkave, pyjeve dhe maleve me borë të veriut, a nuk është edhe ai një misionar i lidhjes së shpirtave, zemrave, njerëzve, një metaforë në miniaturë e një Jezu Krishti të ri mbërthyer aty, në kryqin e shtyllës telefonike: një "Via Crucis" para vdekjes, siç pohon vetë Rikardi. Por një



pohim të tillë ma ka bërë edhe vetë regjisor Viktor Gjika, të cilën e kam shkruar në një librin tim. Dritan Shkaba, Skënder Guri, Deda ngrihen mbi një trinom: fjala, drita, atdheu, martiri. Ata martirizohen për të tjerët, por disi ndryshe... Dua të kujtoj këtu një episod gjatë xhirimeve të filmit "Rrugë të bardha" pyjeve të Fushë-Arësit. Unë punoja në atë qytezë sharraxhinj atij viti (1974) dhe rrija për qejf me aktorët dhe ekipin realizues të filmit. Qe një dhomë e madhe, në mes të saj një sobë e skuqur flakë ku hidheshin vazhdimisht dru. Aktorët e mardhur e të lagur nga dëborat ngroheshin, teshat e tyre avullonin, njësoj si në film te skena Deda-Zana. Dhe muzika e mrekullueshme e Limoz Dizdarit. Ja ku erdhi dhe Rikardi. Më është ngulur në kokë figura e tij, fytyra e akulluar. Ai përplasi çizmet në tokë si prej Dede. Bora u hap në dysheme. Hoqi pelicën e lagur dhe u qas tek ajo e bekuar sobë plot me dru duke u fryrë duarve. Iu ngroh lëkura, trupi. Papo nisi pastaj një humor mes artistësh, hidh e prit. Robert Ndenrika e ngacmonte Rikardin: Po ç'tu desh, mor qyq, mbete ngulur në shtyllë të telefonit. Viktor Gjika qeshte me të madhe me atë mirësinë e tij në sy. Çfarë bukurie! Çfarë njerëzie. S'më hiqet nga koka ky imazh!

Rikard Ljarja hyri i mëvetshtëm në regjinë filmike me filmin e tij të parë *Në pyjet me borë ka jetë*, 1978, ku edhe u njoh e u lidh në martesë me aktoren Marjeta Ljarja. Vijoi mëpastaj me xhirime filmash të tjerë si regjisor, 10 të tillët, ku bien në sy veçanërisht filmat *Radjostacioni* (1980), - një tablo lufte dhe paslufte me përplasje kundërshtish, klasash (fitimtarë e të rrëzuar) nën një linjë subjektore përbashkuese: ngritjen e radiostacionit të ri që do t'i shërbente paskëtaj pushtetit të ardhur nga lufta; *Skëterrë '43* (1980), - veprimi dhe situata tragjike në një kamp përqëndrimi nazist, ku vuajtja, torturat, rezistenca për mbijetesë, të pleksura me faktorin politik vetëdijësues të kohës, krijojnë një tablo të kahut epiko-heroik, paçka se hasen aty edhe mbishtresime të koncepteve dhe miteve politike, që vinin nga estetika socrealiste. Një qasje gjithsesi dramatike mundi të përditësonte ai në filmin *Fundi i një gjakmarrjeje*, 1983, ku armiqësia fisnore e personale ridimensionoheshin në miqësi dhe në hakmarrje tashmë kundër pushtetit dhe sipërmarrësve italianë, brenda optikës së njohur socrealiste. Nivelin më të mirë të realizuar si regjisor Rikardi e mbërriti me filmin *Kur hapen dyert e jetës*, 1980, me të cilin fitoi çmimin "Aleksandër Moisiu". Falë një situatë të rëndë e të jashtëzakonshme (kryerja e një operacioni në një klinikë fshati, në kushte izolimi nga dëborat), filmi përcillte idenë e guximit, vullnetit dhe përkushtimit për punë, e pleksur në mënyrë organike me korrupsionin dhe abuzimet që vinin nga shfrytëzimi dhe tepria e pushtetit, me vetëdijen dhe qëndrimet patriarkale, sikurse edhe me linjën spekulative të "optimizmit" dhe thirrjes ndaj të rinjve për t'u ngulur dhe për të ndërtuar lumturinë e tyre në fshat.

Rikardi ka shkruar edhe letërsi, ndër ta romanet: *Në një humbëtitirë këtej rrotull*, *Kohë qensh*, *Josifopedia*. Ka një stil lakonik, fjalë të prerë, peshë në mendim, heshtje të nënkuptuar, narrative dinamike, pak përshkrime e më shumë mendim, përsiatje. Letërsia në dekadën e fundit të jetës u bë "mikja" e dytë me të cilën ai kuvendonte. Ka ky libër edhe eseistike, ku unë do të veçoja shkrimin kushtuar Ndreku Lucës (*Madhështia e thjeshtësisë*), esenë për Gjirokastrën (*Më kish marrë malli për ty*), ose të tjera si: "Ejani të pështyjme", "Arnaut Osmani, Frederik Engels dhe Sigmund Freud" etj. Nuk po zgjatëm shumë te kjo qasje, po risjell diçka nga një prej shkrimeve të tij të përfshira në këtë libër:

"Ç'është atdheu? A nuk jam unë atdheu, gruaja dhe fëmijët, oborri im, toka ku kam mbjellë sivjet bostan a grurë, a nuk është atdheu komshiu im, lagjia, fshati përkarshi, ai lumi që s'pushon së rrjedhuri, a nuk është atdheu gjuha që flasim, këngët që këndojmë e vaji, e gjama, a nuk është atdheu varret e gjyshërve e stërgjyshërve, a nuk është atdheu gjithçka nën këtë tokë e mbi këtë tokë deri tek flamuri? Sigurisht që ky është atdheu..."

Mbi "Arbëreshët midis realitetit dhe mitit" – vështrim i shkurtër socio-kulturor të autorit Fatmir Toçi

ARBËRESHËT – KRAHU I SHQIPTARISË

Nga Prof. dr. Hysen Matoshi

Arbëreshët përbëjnë ngulimin më të Arëndësishëm dhe më me ndikim në botën shqiptare. Të shkëputur fizikisht nga trugu i Atdheut, arbëreshët përgjatë shekujve mbetën të lidhur shpirtërisht, mendërisht, kulturalisht dhe historikisht e rrënjët e tyre, me Arbërinë e djeshme dhe me Shqipërinë e sotme në kuptimin e saj etnik. Ata u bënë urë lidhëse, dykahëse, ndërmjet bashkëkombësve të tyre dhe pjesës perëndimore të Evropës. Veçoritë linguistike, etnopsikologjike, kulturore, qytetëruese të kombit tonë, qofshin ato të periudhës kombëtare, qofshin të asaj parakombëtare, u bënë të njohura në një pjesë të madhe të Evropës dhe veçmas në vendin pritës në sajë të ngulimeve shqiptare që i themeluan arbëreshët tanë në krahina të ndryshme të Italisë. E, megjithatë, roli i arbëreshëve nuk përmbillet në këtë dimension, ngaqë, sikundër e dimë, ata u bënë përçuesit e ideve të zhvillimit tonë shoqëror e kulturor, ide të cilat, në formate të ndryshme, kishin lëshuar rrënjë te kombet e përparuara të Evropës; kombëtarizimi i letërsisë shqipe nuk mund të merret me mend pa kontributin e arbëreshëve tanë, sikundër që edhe Rilindja jonë Kombëtare nuk mund të ishte e tillë pa idetë e mëdha kombformuese të Risorxhimentos Italiane. Arbëreshët, përveçse për bashkimin e Italisë dhe rilindjen e saj dhanë ndihmesë të madhe ideologjike edhe për Rilindjen Kombëtare Shqiptare.

Për këtë fakt, pra për ndërgjegjësimin kombëtar të shqiptarëve, për zhvillimin e kulturës shqiptare, për përparimin e gjithmbarshëm kombëtar, arbëreshët janë faktor i rëndësishëm i historisë dhe i kulturës shqiptare, faktor dinamik dhe

kativ i saj. Historia shekullore e trojeve autoktone etnike të shqiptarëve pa këtë ngulim, por edhe pa ngulimin tjetër në veri, pa arbëreshët e Zarës, asnjëherë nuk do të jetë e plotë.

Si pjesë organike e korpusit shqiptar, arbëreshët ishin dhe mbeten preokupim i madh i studiuesve dhe i autorëve tanë. Sot kemi kënaqësinë të prezantojmë punën disavjeçare kërkimore të Fatmir Toçit, autor dhe botues i njohur shqiptar. Monografia *Arbëreshët midis realitetit dhe mitit – vështrim i shkurtër socio-kulturor* përbën një vepër me interes për njohjen më të plotë shkencore të arbëreshëve në disa plane. Është fjala për një kontribut historiografik, kulturologjik, enciklopedik dhe bibliografik. Marrë parasysh këtë materie studimore, dokumentare, burimore dhe referenciale, kjo monografi rreth 500-faqëshe do të jetë literaturë e nevojshme për studiuesit, por edhe për lexuesit e zakonshëm, të cilët duan të dinë më shumë për këtë krah të rëndësishëm të botës shqiptare, për shtrirjen e arbëreshëve në krahina të ndryshme të Italisë, për rolin që kanë luajtur ata gjatë historisë, për familjet e mëdha arbëreshe, për Skënderbeun, rolin e tij historik dhe për relacionet e tij me faktorët e rëndësishëm të kësaj hapësire, për rolin e kishës bizantine në ruajtjen e identitetit arbëresh, për kulturën tradicionale, për letërsinë arbëreshe dhe kryeautorin e saj Jeronim de Radën etj. Ndonëse pjesa e parë është titulluar *Arbëreshët – një histori mbijetese*, shpreh bindjen se informacioni i ofruar, analizimi i tij dhe sintetizimi i gjetjeve janë dëshmi të rëndësishëm të një procesi zhvillimor në përmasën e gjerë, një histori

orientuese në rrugëtimin e kronologjisë sonë kombëtare.


Pjesa e dytë e monografisë më shumë shfaqet me përbërës enciklopedikë dhe është një bazë e mirë të dhënash mbi ngulimet arbëreshe në krahina të ndryshme të Italisë, historikun e formimit dhe aktualitetin e tyre, pa lënë anash veçanti të caktuara kulturore. Kjo pjesë, krahas dedikimit shkencor, mund të shërbejë edhe si një udhërrëfim aq i nevojshëm për identifikimin e shtrirjes së arbëreshëve gjithandej Italisë. Bazuar në punën e Fatmir Toçit, del se harta e identifikimit të shtrirjes së tyre është zgjeruar jashtëzakonisht shumë, duke tejkaluar stereotipin e kërkimit të arbëreshëve vetëm në krahinat e Sicilisë dhe të Kalabrisë. Një kontribut tjetër i rëndësishëm studimor lidhet me trajtimin e kishës arbëreshe, e cila i përket ritit lindor ose bizantin, gjë që përbën një raritet kulturor e besimor edhe për vetë Italinë. Natyrisht të dhënat për kishat më të rëndësishme arbëreshe dhe plotësimi i tyre edhe me fotografi, në mjaft raste, krijojnë një perceptim më të plotë për jetën fetare, për këtë dimension të rëndësishëm të mbijetesës së arbëreshëve, ndonëse ka pasur edhe komunitete arbëreshë që, në rrjedhën historike, e kanë ndryshuar ritin e tyre të besimit, duke iu ekspozuar më shumë mundësisë së asimilimit kombëtar.

Monografia përmban edhe shumë të dhëna të tjera me interes të veçantë, sikundër është një regjistër i plotë i vendbanimeve arbëreshe në Itali, të dhëna mbi emigracionin, mbi jetën dhe strukturën e organizuar fetare etj.

Kjo vepër që po e prezantojmë sot është rrjedhojë e një pune të gjatë me burime të shkruara, me literaturë dhe me vëzhgime në terrenin arbëresh, por gjithashtu është edhe një bazë e mirë e të dhënave bibliografike dhe uebografike, një ndihmesë në planin referencial për kërkime të mëtejme në këtë fushë.

Në përfundim të kësaj fjale, dua ta përgëzoj autorin Fatmir Toçi për punën e madhe në fushën e studimeve arbëreshe, për shqyrtimet shteruese e për përfundimet e argumentuara. Kjo monografi, pa asnjë dyshim, është produkt i dashurisë, i pasionit gati misionar, por edhe i qasjes objektive shkencore që aq shumë i mungon jetës sonë.

Prishtinë, 21.4.2022



Tregimet, novelat dhe romani i parë i Fatos Kongolit (1972-1990) nuk kanë ngjallur ndonjë interes të veçantë. Vet shkrimtari dhe krijimtaria e tij, sikurse dhe sivëllezër të tjerë letrarë, përshkoheshin nga dy kundërshti të mëdha. Me bindje dhe pa bindje, e pranonte realitetin, përshtatej me të, madje, edhe kur filloi të mendonte ndryshe. Krijimtaria, po ashtu, përftohej e përshtatur në kontekstin ideologjik, brenda kërkesave të redaksisë dhe pëlqyeshmërisë së lexuesit, ndërsa, autori ishte i pakënaqur. Gjetja e origjinalizmit, shprehje e dhuntive dhe e ndjeshmërive vetjake, ka qenë një kërkim i vazhdueshëm në vetvete, në ecurinë e formimit e të horizontit kulturor, sidomos nëpërmjet leximit, në frëngjisht, të një vargu romancierësh të njohur botërorë. Prej tyre u ndërgjegjësua, se shkruante, siç nuk duhej të shkruante. Letërsia e realizmit socialist, me “velin” e saj “lumturues”, fshehte vrazhdësinë, dramën tragjike të realitetit politik, të cilat i përjetoi tronditshëm me ndodhitë vetjake, familjare e të kolegëve. Megjithatë, nën trysinë e rrezikut të ndëshkimit, që rrinte ngrehur mbi kryet e secilit, vazhdoi të shkruante “i përshtatur” me kërkesat e dogmës.

Fiksion letrar dhe autobiografik

Fiksioni i tij letrar shpesh këmbëhet me fiksinin autobiografik. Heronj rrëfimtari, personazhe bartin tipare e bëma të autorit, të kolegëve e të të njohurve. Ngjarje e ndodhi, mjedise jetese e pune, marrdhënie me kolegë, me të atin janë shndërruar në ngjarje, ndodhi, mjedise e personazhe letrarë me kufinj vështirë të përcaktueshëm, në se, zanafilla e tyre është e njëmendët, apo, subjektive, fikionale, pa qenë copëza autobiografie. *Iluzione në sirtar*, pothuajse roman për veten është fiksin autobiografik i mirëfilltë.

Tipare të karakterit vetjak, që janë edhe tipare të përgjithshme te njerëz të caktuar: drojtja për t'u shprehur plotësisht, moskundërshtimi, gjetja e një «pajtimi» edhe me ata që nuk ia pranon vetëdija e bindja, zbrapsja prej përballjes, u janë përngjitur personazheve. Frika, ankthi nga mbikqyrja, mania e persekutimit, thirrja në hetuesi e në gjyq, kërcënimet, përndjekjet, traumat, që ka përjetuar në jetën dramatike, pija e tepruar, dehjet e skajshme janë bartur te rrëfimtari autor, jo rrallë alter ego i Fatos Kongolit. Dyzimi i tyre, një konstante dalluese, që e ka burimin, së pari, te trysnitë e rënda shoqërore, nuk është pa lidhje me kundërshtitë e tij të brendshme. Dyzimi vjen edhe prej zhvillimit të natyrshëm të qenies njerëzore prej fëmijërisë në pjekuri; prej shtysave psikomendore dhe instikëve të kundërta, të prirura drejt përsosjes a degjenerimit, virtutit a vesit, moralit a imoralizmit, të vetëdijshmes e të pavetëdijshmes.

Edhe disa gjendje përcmuese, pasojë e shkeljes shoqërore mbi personalitetin dhe dinjitetin njerëzor, të ndërjor, për më keq, «mi gjirizi», të cilat ndërmendin heronj të Dostojevskit, Franz Kafka-s dhe shkrimtarëve të tjerë modernë e pasmodernë të shekullit XX, janë të bartura prej biografisë psiko-shpirtërore vetjake. Jo rastësisht, heronjtë, shkrimtarë e gazetarë, që kanë studiuar për gjuhë e letërsi shqipe, ose, për gjuhë frënge, vërtiten, pikërisht, në mjedise shkrimtarësh, gazeta e shtëpi botuese me të dhëna konkrete, ku ka punuar e jetuar autori. Letërsia për të është edhe një lloj i tillë i njëjtësimi «autentik» të vetvetes, herë zanafillë, herë platformë e përhershme realiste dhe psikanaliste.

Letërsia e dhimbjes njerëzore

Intuitivisht, me kohë, kishte kuptuar, se, qe i prirur ndaj një lloj letërsie tjetër,

– Proza romanore e Fatos Kongolit–

REALIZËM PSIKOLOGJIK NË STRUKTURA MODERNE E MODERNISTE

nga Bashkim Kuçuku

të dhimbjes njerëzore, panhumane, e ndjeshme ndaj vuajtjeve, tej kategorizimeve shoqërore. Gjeshja e parapëlqyer e kësaj lloj letërsie, ishte vepra e Fjodor Dostojevskit. Edhe vet Fatos Kongoli vuante, i lënduar nga pamundësia për ta paraqitur në krijimtari atë, që shihte në përditshmeri.¹ Fatos Kongoli *Iluzione në sirtar*, pothuajse roman- për vetveten, *Toena*, 2010, faqe 75-76. “*Kjo dhimbje*, ka pohuar në rrëfimet e tij autobiografike, e pranishme kudo në realitetin tonë, ishte e përjashtuara e madhe e letërsisë tonë, të merreshe me të, e pakta nuk do të botoheshe kurrë, pa shtuar se mund ta pësoje keq...” Një gjendje e njohur, me kahe të kundërt, e shkrimtarit nën censurë. Dhuntitë, ndjeshmëria, vetëdija e drejtonin gjetkë, kurse, qëllimi pragmatist në të kundërt. Shkruante për të tjerët, në mospajtim veten.

Në rrethanat e lirisë së të shprehurit (1991), në qenien e tij, nuk pati ndonjë shndërrim rrënjësor. Ndryshimi i madh cilësor është në romane, te të cilët arriti të mishërojë atë, që, mendonte dhe ishte i prirur- ndjeshmërinë e shpirtit njerëzor, dhimbjet e vuajtjet e tij, pa përlogaritje të tipareve pozitive e negative, në kontekstin e shoqërisë shqiptare, të djeshme dhe të sotme. Vuajtjet vijnë prej gjendjes dhe rrethanave shoqërore, familjare,

1 *Iluzione në sirtar*, pothuajse roman- për vetveten, *Toena*, 2010, faqe 166-167.

vetjake: padrejtësisë, diferencimit politik, përndjekjes e nëpërkëmbjes shoqërore, mjerimit ekonomik, autoritetit të vrazhdë atëror, krimin a mëkatit, në trajtën e imoralizmit të skajshëm, etj. Këto janë dhe baza kryesore e realizmit psikologjik. Shkaktarët janë shpërfillës ndaj bëmave të veta. Ose, i pranojnë si diçka të domosdoshme për jetën e tyre, pa brejtje të ndërgjegjes, ose, i fshehin me cinizëm për t'iu shmangur ndëshkimit.

Ndonëse ka kaluar shekulli, një përgjithësim i Zigmund Freud-it për romanin modern psikologjik të atëhershëm, hedh dritë, në thellësi të marrdhënieve, edhe mes shkrimtarit Fatos Kongoli dhe personazheve të tij. «Në përgjithësi, natyra e veçantë e romanit psikologjik, ka shkruar Sigmund Freud-i, *i detyrohet sigurisht tendencës së shkrimtarit modern për të copëzuar Unin e tij nëpërmjet vetëvëzhgimit, në shumë Une të pjesshëm dhe, rrjedhimisht, për të personifikuar në heronj të shumtë rrymat në konflikt të jetës së vet të brendshme.*»² Sigmund Freud *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, *Ditura*, 2000, faqe 23-24. Këtë marrdhënie të veçantë e pranon edhe Fatos Kongoli. «*Erdhi koha*, shkruan ai, *kur mësohem ta pranoj dhe vetvetiu ta shfaq dyzimin e vetvetes. Më vonë, në librat e periudhës së dytë të krijimtarisë sime, ky dyzim do të vijë si tipar i disa personazheve,*

2 *Iluzione në sirtar*, faqe 158.



veçanërisht i personazhit kryesor të romanit *Kufoma*».


Historitë rrëfyese janë shëmbëllime prej përditshmërisë bashkëkohore, me problematikë intime e familjare, të mirëpërcaktuara, në kohë dhe në hapësirë, të cilat lëvizin në një rreth të ngushtë ngjarjesh e ndodhish, në mjedise intelektualësh. Biografitë e heronjve janë të përqendruara në kulmin e konfliktit me veten a mjedisin, që është dhe kulmi i krizës së identitetit dhe i personalitetit të tyre.

Ndërtekstorësi e mbyllur në tërësinë e vet, me hapje në letërsi të tjera

Proza e tij është një ndërtekstorësi/ intertekstualitet, një tërësi e mëvehtësishtme, e përmblytur, me vazhdimësi kohore dhe ndërlidhje të brendshme nëpërmjet një varguri përbërësish, përmbytësorë e poetikë. Personazhe dhe mjedise të njëjtë, të njëmendët e të panjëmendët, fikcionalë, bërthama idesh e simbole shfaqen nga njëri roman te tjetri disa prej të cilëve nga bërthama zhvillohen në makrobërthama e makrosimbole të veprave pasardhëse, të shenjuar, që në tituj.

I humburi, *Kufoma*, *Dragoi i fildishtë*, *Ëndrra e Damokleut* autori i ka përfshirë në tetralogjinë *Burgjet e kujtesës*, me referencë kohore periudhën e totalitarizmit, kur mendimet e lira mbaheshin të mbyllura, në “burgjet” e ndërgjegjes vetjake, ngjashëm me individin, që ishte në “burgun” e censurës. I çliruar prej “ndalimit”, nga kujtesa e të shkuarës, ai krijoi një tablo të gjerë të atij sistemi shoqëror, në qendër të së cilës është shëmbëlltyra, me disa profile, e njeriut nën trysni të vazhdueshme për ta tkurrur e tjetërsuar në standardin ideologjik. Në kuptimin e ngushtë, të referencës kohore, nga “burgjet e kujtesës” janë të përfutur vetëm: *I humburi* dhe *Kufoma*, historitë e rrëfyera të të cilëve fillojnë e përmbillen brenda kujtesës për të shkuarën. Mirëpo, njëmendësisht, në konceptin e kësaj reference kohore, janë edhe romanet: *Lëkura e qenit*, *Jetë në një kuti shkrepësesh*. Ngjarjet e tyre, që fillojnë e zhvillohen në të tanishmen, kthehen e rikthehen tek e shkuara e kujtesës, ku e kanë zanafillën. Jashtë kësaj tërësie mbetet *Te porta e Shën Pjetrit*, me kohësi në të tanishmen, pa retrospeksion në të shkuarën e djeshme, më të largët.

Metafora *burgu i kujtesës* ndrym objektin kryesor, dallues të krejt kryesë së tij. Ajo përmban kujtesën vepruese dhe jo vepruese, të ndaluar prej mjedisit, por dhe të fjetur te shkrimtari dhe vetja, të cilën e ka parasysh për shëmbëlltyrën e personazheve. Përmban dhe të pavetëdijshmen. E plotësuar edhe nga harresa/amnezia traumatike, nuk është thjesht në kuptimin e zakonshëm të përditshmërisë, as thjesht nocion filozofik e letrar i ngrirë. Prej saj kanë dalë bërthamat e romaneve, strukturat, përftesat zotëruese të retrospeksionit dhe introspeksionit, vijimësia nga njëri tek tjetri. Aty nis e vrollon dinamika e tyre. Kahu i ecurisë së historive të rrëfyera më tepër është prapaktim në



kohë. Kujtesa, e shkuara dhe e sotmja, kuptimi dhe vijmësia e pandashme mes tyre janë burimi i përligjur i përsiatjeve të shpeshta psikologjiko-filozofike të heronjve dhe i rrëfimitarit- autor për marrdhëniet e qenies njerëzore me veten dhe të tjerët, me ndërgjegjen dhe moralin, përgjegjshmëritë dhe papërgjegjshmëritë. Në të është qeniesia njerëzore.

Ndërtekstorësia është endur edhe me përbërës konkretë: emra e funksione personazhesh, mendime e shprehje të theksuara, mjedise, institucione të caktuara, emra fikcionalë qytetesh dhe objektesh publikë për të krijuar shëmbëlltyrën e një bote të njësuar, ngjashëm me botën e njëmendët.

Prej tërësisë së mëvehtësishme kongoliane, ndërtekstorësia shtrihet më tej, e lidhur me letërsi të tjera europiane, sidomos nëpërmjet bërthamave përbajtësore, të ndikuara a të «huazuara» prej tyre, të përshtatura në originalizmin e vet. Më të shumta ato janë me prozën e Fjodor Dostojevskit, ndër të parat, që i priu modernizmit të shekullit XX. Romanet e tij me *Krim dhe ndëshkim*, p.sh., krahas bërthamave të ideve, kanë të përbashkëta fjalë-çelësa e figura-çelësa, që janë sa të fushës së njëjtë tematike, aq edhe të subjektivizimit botëkuptimor e qëllimit të dy autorëve.

Dhimbje dhe vuajtje njerëzore janë fjalët-figura përcaktuese dhe më dalluese të kësaj lloj letërsie humane. Fjalë-figura të tjera: *krim dhe ndëshkim*, *mëkat*, *shlyerje dhe mosshlyerje e krimit/ mëkatit*, *pendesë, mospendesë, fajtor, kompleksi i fajit, vrasje, vetvrasje, cinizëm* ndaj viktimës, *fshehje e krimit, kllapi, jerm, ëndërr-kllapi, vegime, shajni, halucinacione, neveri, amnezi, hije, fantazma, heroi morr, krimb* zbulojnë, në kontekstet përkatëse, shkaqet e dhimbjes e të vuajtjes, gjendjet e qëndrimet, luhatjet e vendimet, mendimet e bëmat. Dihotomia e famshme dostojevskiane *krim dhe ndëshkim*, së cilës i është bashkëngjitur edhe mëkati, përshkon, thuhajse, gjithë romanet e tij, në disa krejt strukturën e në disa të tjerë pjesë të caktuara. Por në brendi është e thyer, është ndryshe. Brerja e ndërgjegjes, pendesa, shlyerja e mëkatit dhe e krimit me anë të veprimeve humane te fajtorët e njëmendët e të mëdhenj është e rrallë, sikurse është i rrallë edhe ndëshkimi ligjor e moral i tyre. Harku i ndëshkimit për ta, zakonisht, nuk shkrehet, mishërim i mosfunksionimit të tyre në shoqërinë bashkëkohore shqiptare.

Për nga objekti- krimi i vrasjes së dikujt, dhe subjekti veprues- krimineli, pavarësisht ndryshimeve thelbësore mes qëllimeve, qëndrimeve e zgjidhjeve, më afër, në strukturën e përgjithshme, dhe ndonjë ide (ndikimi i banesës tepër të vogël në rëndimin psikologjik), me *Krim dhe ndëshkim* është *Jetë në një kuti shkrepësesh*. Një ndërtekstorësi e tillë, provon më së miri atë që ka pohuar teoria prej një shekulli, se veprat, sado origjinale, po ashtu, dhe letërsitë e gjuhëve të ndryshme, nuk janë të veçuara e të mbyllura. Ato janë të lidhura, sepse ndërpusin/integrojnë përbërës nga veprat e mëparshme. Dhe kjo është një nga ligjshmëritë e letërsisë.

Larmi strukturash: realiste, frojdiste, mitike e legjendare

Historitë rrëfyese të romaneve janë prej përditshmërisë bashkëkohore, me problematikë intime e familjare, në kontekste konfliktesh shoqërore, të mirëpërcaktuara në referencën e tyre kohore-hapësinore, duke përfshirë një rreth të ngushtë ngjarjesh e ndodhish, në mjedise intelektualësh me shkrimtarë, gazetarë e arësimitarë. Njëtrajtshmëria e tyre me diagramë kompozicionale realiste psikologjike, zbutet nga trajta rrëfimore e

struktura romanore të larmishme. Trajtat rrëfimore këmbehen vazhdimisht nga njëra njësi kompozicionale te tjetra, nga e tanishmja tek e shkuara. Rrëfimi zotëruet i vetës së parë, subjektiv, monolog, monolog i brendshëm dhe i dialogizuar, këmbehet me të vetës së tretë, pa vetor, asnjans, «objektiv», duke shpërfaqur, në kënde të ndryshme, botën e brendshme. Prej llojit realist psikologjik kalon në llojin psikanalitik, nga poetizues në negativizues hiperbolik, nga sentimentalist në ironik e retorik, aty-këtu, të ngarkuar me emfazë, me gjuhë të çlirët, pa tabu letrare a etike, pse jo, dhe natyraliste, në fushën erotike seksuale. Krahasi, me ndërprerje të shkurtra të tij, ndërputet përshkrimi i mjaftueshëm i hapësirës së jashtme, të rrethanave dhe të mjedisit, me hollësi dekorative, metonimike e metaforike.

Rrënjët e të keqes kërkohen sa më përpara në kohë me anë të retrospeksionit. Përjetimi i vazhdueshëm i të shkuarës është veçori psikologjike e heronjve të tij. Duke qenë me të tanishme të vradë dhe pa të ardhme, ata e jetojnë edhe të sotmen përmes të shkuarës. Koha, kryesisht, tërhiqet mbrapa, sa mund të cilësohet si prozë e prapaktimit, retrospeksionit me të cilin del prej shtratit realist dhe vijon në struktura të tjera, me përbërës të modernizmit.

Struktura psikologjike

Përparësi, për të cilin edhe shquhet proza e tij, ka introspeksioni, i thënë më qartë, retrospeksioni vertikal, në thellësitë e vetëdijes dhe të pavetëdijes, prej fëmijërisë, ose, pikërisht ku është zanafilla e problemit, e goditjes për të paraqitur sa më gjerësisht

pasoja e saj. Me përshkrime të përkora psikologjike shpërfaqen gjendje njerëzore nga më të larmishmet dhe të skajshme: normale, euforike, të kënaqësisë prej seksit, dëshpërim nga humbja e kuptimit dhe e dëshirës për të jetuar, dehje me pije alkoolike për kënaqësi, për të përhumur dëshpërimin, gjendje ankthi dhe makthi, onirike, vegime, shajni, kllapi, halucinacione. Zbulimi i botës njerëzore, në rrafsh të tilla, të mbivendosur e të nënvendosur, e radhit Fatos Kongolin ndër mjeshtrit e prozës shqipe, psikologjike dhe psikanalitike.

Struktura psikologjike realiste, nga pasoja te shkaku, dhe, e kundërta, nga shkaku te pasoja, me kompozicion të rregullt, është konstante e përhershme, makrostruktura e përgjithshme në të cilën mbarështrohen edhe strukturat: moderne e moderniste, frojdiste, mitike e legjendare.

Struktura frojdiste

Kompleksi i Edipit, herë i të atit, autoritar «imperial», imponues, herë i nënës së adhuruar, me shëmbëlltyrën e së cilës vlerësohet çdo femër, kompleksi obsesion i seksit, tërheqja e përhershme ndaj tij në të cilin fshehet kuptimi i jetës dhe gjendet kënaqësia e vetme, kompleksi i fajit të gabimit e të mëkatit, i vuajtjes dhe pendesës, që përshkojnë historitë rrëfyese të heronjve, sikurse dyzimi e tjetërsimi, përftojnë mikrostruktura, në disa raste edhe makrostruktura, frojdiste. Me anë të analizave të thella psikologjike, gjendjeve emocionale nga më të ndryshmet, sidomos përmes gjendjeve të ankthshme, derpresive, ëndrrave-kllapi, ëndrrave erotike çliruese, halucinacioneve, shajnive e vegimeve, hijeve e fantazmave, përhumjes dhe amnezisë

ndërkalohet nga e vetëdijshmja tek e pavetëdijshmja dhe anasjellas.

Struktura mitike e legjendare

Biografitë e heronjve përshkohen, tërësisht (*Dragoi i fildishtë*, *Ëndrra e Damokleut*), ose, pjesërisht (*Kufoma*, *Te porta e Shën Pjetrit*), edhe në struktura mitike, legjendare gojdhanoze, sisteme simbolike mitike, në histori arketipike, të përsëritura në vepra të shkrimtarëve të mëdhenj europianë, të kohëve të mëparshme nëpërmjet të cilave mbivendosen domethënie të ndryshme dhe zgjerohet mjaft horizonti i pritjes. Ndërtekstorësia i lidh e i ndërput në cilket e letërsive të tjera. Strukturat dhe simbolet mitike e legjendare janë rikuptimësuar:

Njëjtësimi me *Kainin* (*Kufoma*) vjen si pasojë e vetëfajësimit të tepruar të heroit për vëllain, që dënohet, ndonjëse ndaj tij nuk ka pasur faj.

Shpata e Damokleut është shndërruar në *Shpata e Mëkateve* dhe *Ëndrra e Damokleut*, me domethien e të vërtetës së përmbysur dhe të kalimit të fajit mbi tjetrin. (*Ëndrra e Damokleut*).

Guri i Sizifit (*Te porta e Shën Pjetrit*), gjedhja sizifiane e ekzistencës mishëron mundimin e madh prej drojës, për të shqiptuar të fshehtëm më të thellë, në këtë rast, dashurinë tepër pasionante.


Legjenda për Aleksandrin e Madh të lashtësisë, që i kërkon dorën e të bijës mbretit të Lindjes të mundur prej tij, është në kontrast me heroin bashkëkohor në Kinën e censurës, që nuk i a shtrin askush dorën (*Dragoi i fildishtë*).

Simbolika e re *dragoi i fildishtë*, në përputhje edhe me tematikën dhe brendinë, është ndër të paktat e këtij lloji në letërsinë shqipe me prejardhje nga mitologjia dhe kultura kineze. Prej zbërthimit të figurave saj bija, në pika të ndryshme të ligjëritimit përsijatës, çlirohen me doza të kursyera domethëniet e miteve, të ndryra në koracën e mbyllur të traditës historike dhe të censurës.

Mjedisi nuk i pranon të huajt në brendësi të vet. Heroi, student shqiptar, i ndodhur mes kulturës së lashtë e të pasur, gati, përrallore, nuk e gjen askund çelësin për të hyrë, sadopak, në të. Në monologun e tij, në shajni e ëndërra, ndeshet si në mite, me statuetën e dragoit të gdhendur në fildish për ta detyruar të nxjerrë thesarin e fshehur, t'i shtrijë dorën e pranimit të miqësisë, analogji edhe me botën shqiptare të censuruar të asaj periudhe. Ankthi i përhershëm i vjen nga pamundësia e komunikimit dhe e zbulimit të fshehtësive qeniesore, njerëzore dhe erotike. Edhe vajza, thesari e perla, që kërkonte mes thesareve të mëdha kineze, kur i hap portën e dashurisë, nuk i hap zemrën. Pas ndonjë veprimi erotik pranues, me dhimbjen në fytyrë për humbjen e përjetshme, me fjalë shqipton vetëm pamundësinë e kurorëzimit.

Figura të tjera, të mitologjisë shqiptare: hije, lugat, xhind, Shpirti i Keq, si dhe ciklopi, përvijojnë mikrostruktura dhe sisteme mikrostrukturash, që përcjellin dinamizmin mendimor rrëfimitar në makrostrukturat e përgjithshme.

Me originalizmin, rrjedhshmërinë emocionalizuese të rrëfimit në përngjasim me ligjërim e përditshmërisë, të ngritur në rrafshin psikologjik e psikanalitik, shoqëror e moral, diku filozofik, estetik e letrar, romanet e Fatos Kongolit, ndër më të lexueshmit në këto tridhjetë vjet, janë mirëpritur edhe nga lexues në gjuhë të tjera. Romane të tij janë botuar në 11 gjuhë të tjera: frëngjisht, italisht, spanjisht, gjermanisht, greqisht, anglisht, polonisht, sllovakisht, serbisht, bullgarisht, esperanto, disa dhe me ribotim, shoqëruar me kritika vlerësuese.



PENGU I KOMPENSUAR I NJË PROJEKTI TË PAREALIZUAR

Shaip BEQIRI



Në krye të kësaj kaptine me titull *Ismail Kadare*, një peng imi krijues më shtrëngon të bëj një parantezë të zgjeruar, e cila më është përvjedhur dhe ka mbetur brenda meje qe plot dyzet vjetë. Fjala është për një shpjegim aspak të lehtë të një udhëkryqi jetësor e krijues, tek i cili u gjenda në krye të udhëtimit tim të deriatyshëm. Ka ndodhur në pranverën e hershme të vjetit '82, pak para se të përfundonte semestri i fundit i studimeve postdiplomikë, siç quheshin atëherë, koha kur duhej bërë përcaktimi i një teme studimore për mbarimin e magjistraturës. Temën duhej caktuar vetë në marrëveshje me mentorin, duke e paraqitur me shkrim dhe të shoqëruar me një arsyetim themelor për qëllimin dhe përmbajtjen kryesore të saj.

Mentorin e njihja jo vetëm si mësimdhënës timin të mëparshëm dhe udhëheqës të Shkallës së Tretë të Studimeve që kisha ndjekur së fundmi, por edhe si njërin nga kolegët e respektuar jo aq të afërt dhe sidomos si bashkëbisedues të shpeshtë për çështje të ndryshme letrare, kulturore e shkencore me anë bisedash e intervistash me të për redaksitë ku punoja.

Për të mos e zgjatur, duhet të them se atëherë synoja të mbaroja shkallat e studimit në një udhë të natyrshme, duke e përmbyllur atë punë me një studim për veprën letrare të Ismail Kadaresë, të vështruar e të hulumtuar në disa aspekte krejtësisht të veçantë. Një shkas fillestar të kësaj ideje më kishin dhënë dy punime që kisha paraqitur në atelienë e punës seminarike e të diplomës, të bëra më parë si student. Për më tej më udhëhiqte synimi të bëja diçka krejtësisht ndryshe, duke e vështruar në tërësinë e saj veprën letrare të shkrimtarit të shquar, me përqendrim tek prosedeu krijues i tij. Formulimi ishte i thjeshtë dhe i qartë: "Transformimi ndërgjinor e ndërzhannor

i temave dhe motiveve në veprën letrare të Ismail Kadaresë". Me një fjalë, doja të përvijoj hulumtimin e kalimit të formave të vogla krijuese në ato më të mëdha, ose lëvizjen e motiveve dhe të temave të poezisë tek proza etj. Pra doja të bëja një prerje të profilizuar duke i vështruar e analizuar nuancat jo vetëm tematike-motivore, por sidomos ato stilistike e gjuhësore.

Para mentorit nuk kisha ndonjë drojë e as ngurrim, lëre më çfarëdo mëdyshjeje. Në ambientin e njohur të zyrës së tij plot orendi e shkëlqim, ku ai qëndronte ndanë tryezës së mbushur deng me libra, prore ndihesha i patrazuar. Edhe ai më shikonte dhe më dëgjonte në qetësi. Përnjëherë m'u kujtua fytyra e tij e mërdhezur e plot hutim e një vjeti më parë, kur kisha trokitur në të njëjtën derë me tjetër shkas. Ishte mesi i prillit '81. E kisha gjetur fikall vetëm. Zjarri ende nuk ishte shuar në Prishtinë dhe në tërë Kosovën, kurse tymin e bartnin tutje mjegullat e erërat. Të dukej se gjithçka do të pëlciste midis asaj qetësie vrastare. Ankthi e terrori pllakosnin mbi njerëzit dhe çdo gjë të gjallë e të vdekur. Ai më kishte parë symadhuar. Unë shpejt qeshë përmendur. Doja ta rrëkëlleja habinë e tij. Në atë përpjekje të mekur, mezi kisha njomur buzët sa t'u çelja udhë fjalëve të zhveshura nga çdo kuptim i natyrshëm. Edhe ato i kishte mvëshur klima e rëndë përjashta nesh, sikur rroposeshin përbrenda vetes. Nxitimthi i kisha thënë: kam ardhur të bëj një intervistë me Ty! I pati rënë një prush fytyrës Profesorit. Nuk kisha pritur të më bënte asnjë pyetje, sepse pyetjet i kisha bërë vetë! Ia lashë në dorë fletën e letrës me pyetjet, ashtu siç donte t'i bënte ai të gjitha intervistat atëherë dhe u ngrita të ikja. Në vend se të përshëndeteshim, për një çast mbetëm të athur të dytë. Mezi arrita t'i thosha se mund të vinte kur të donte dhe do të flisnim për çfarë të donte.

Kjo pamje më kaloi në mendje si insert i

një filmi tek i cili nuk kap dot më shumë se disa sekonda të vetme. Kur e këputa shiritin e paranjëvjeshëm, i cili mbeti pezull në hapësirën midis ne të dyve, nëpër format e valëzuara të atij shiriti pashë fytyrën relievore të Mentorit tim që po bëhej gati të më jepte një përgjigje me seriozitetin e vet me kumbim solemn: - Ti je një kandidat shumë serioz, prandaj do të marrësh një temë shumë më serioze: "Gjeneza e simboleve në poezinë shqipe".

Mulliri i trurit tim zuri të bluante drithin që sapo i vihej atje ku unë prej kohësh mbaja drithin e arës sime! Befas u ndal gjithçka. U këput diçka e madhe në çast. Nuk më vinte dot një fjalë e vetme të thosha çfarëdo qoftë. Ai e lexoi shpejt situatën e re. Hutimi i tij i dikurshëm, në një trajtë të përcudnuar, po kalonte i shumëfishuar tek unë. Tjetrit nuk kishte si t'i shkonte mendja se mund të qe një mospajtim, larg qoftë refuzim! Bëri goditjen tjetër me të njëjtin mjet të topitur: - Ose, për shembull, "Natyra në poezinë shqipe".

Më futi kaq papritur në bërakën e një situatë ku nuk dija si të sillesha, lëre më të më shkonte mendja se mund të gjendej ndonjë shtegdalje. Ndonëse kisha rënë keq në këtë grackë të bukur, ende vazhdoja të mos ia thosha as vetes këtë gjë, sikur të më pëlqente vazhdimi i të besuarit në iluzionin që s'e kisha ushqyer kurrë! Me zë të ngjirur mezi arrita të mërmëritja diçka të domosdoshme. Çështjen kryesore ia shtrova në formë të pyetjes: çfarë do të ishte rezultati konkret hulumtues i *evidentimit të simboleve* dhe gjenezës së tyre në poezinë shqipe? Njësoj edhe i natyrës. Nuk e priti reagimin tim, sidomos përbuzjen që shpërfaqja për kotësinë e një pune të mundimshme me bërë *evidentim e regjistrim* në krahasim me një hulumtim të thelluar e të përimituar të një veprë shumëdimensionale letrare.

Ndërkaq njai shiriti fluturues i paranjëvjeshëm s'kishte mbetur pezull; ndoshta do të ketë rënë përdhe prapa shpinës së tij, apo ishte ngjitur në raftet që përftonin sfondin përpara syve të mi. Unë, me mullirin tashmë të ndalur të trurit tim, po frenoja me zor tërë atë që më vinte te gryka. Po përpëlitesha ta zija fijen për së mbari. M'u kujtua se ishte kohë e rëndë për të gjithë: për të, për mua dhe për të tjerët. Nuk doja që atë peshë t'ia bëja më të rëndë dikujt tjetër, aq më pak Mentorit tim! Më erdhi kthjellimi t'ia thosha me tërë çiltërsinë atë që, për fat të keq, ai nuk e meritonte. I thashë se nuk e kisha me ngut këtë punë, prandaj mund të pritja sa të donte ai, duke mos e bërë me dije askë tjetër... Do të ishte ai që do të më ftonte të paraqitesha kur ta shihte se ishte e mundshme dhe e arsyeshme ta mbroja atë tezë studimi para komisionit të udhëhequr prej tij.

Unë doja të hiqja çfarëdo përgjegjësie prej tij, por duket që kjo nuk i mjaftonte. Ishte ky çast yni që thellë në mua përftoi hendekun që s'munda ta kaloja kurrë në

jetën time. Por, për çudi, më shërbeu shumë ta bëja parim të përhershëm të marrëzisë sime bujare me i ngarkuar vetes edhe fajin e pabërë; mos me ecur kurrë pas ligësive të askujt. Nuk i thashë kurrë përse ia kisha kërkuar intervistën në prill '81, kur edhe toka digjej flakë; përse në ballinën e revistës me intervistën e kisha vënë portretin e tij sa zinte tërë faqja, ndonëse vetë unë gjendesha në shënjestrën zhbriuese si askush tjetër rrotull meje. Nuk u ligështova t'ia thosha këto pallavra. Assesi. Sepse nuk kisha bërë asgjë më shumë se të hiqja mjegullën e asaj kohe të vështirë, nëpër të cilën përflitej gjithandej se e kishin arrestuar Profesorin, i cili tash qëndronte si i mpirë duke më vështruar i nemitur. Nuk ishte ndonjë meritë fakti që një vjet më parë kisha dashur të jepja një lajm të mirë për të, një nojmë njerëzore për dikë!

Në këtë mënyrë, në heshtje të plotë e në kohë të gjatë, e lashë të vdiste natyrshëm iluzioni im i bukur krijues prej studiuesi me *epoleta e grada*. Vazhdova atje ku isha dhe ku mbeta. Gjeta mundësinë e parë të ofruar që veprës letrare të Ismail Kadaresë t'i qasem në një mënyrë tjetër, duke e vështruar atë së bashku me autorin e saj zulummadh, të cilin me kohë e bëra një bashkëbisedues të mrekullueshëm dhe përherë të gatshëm të ecnim bashkë në kohë të ndryshme me përjasje të shumanshme në çdo preokupim krijues e njerëzor.

Në ballin e kësaj kaptine kam vënë sprovat e mia të kryehershme, për t'i vazhduar ato me një bisedim të pakëputur në kapërcyell të mijëveçarëve tanë, të cilëve Kadare, bashkë me pak personalitete të tjerë, u japin ngjyrimin më të thellë të një kulture, arti e letërsie me rrënjë autentike të identitetit të përmasave më përfaqësuese të botës moderne.

Tash, kur e shoh në qetësi të plotë këtë bashkëbisedim e komunikim publik me kryemjeshtrin shqiptar, them që kompensimi i atij pengu ka qenë një shtysë kreative të bëj në një mënyrë tjetër tërë atë që ndoshta nuk do t'ia dilja dot ashtu siç e kisha menduar në atë vrullin tim të parë *juvenilian*. Përkrye të gjithave, ndonëse nuk m'u dha mundësia e sprovimit nga Mentorin i shumë të tjerëve, një gjë me vlerë të madhe e mësova që e mësova edhe prej atij Mentori të gjithkujt: se mëria dhe përbuzja janë hidrat që pjellin të gjitha të këqijat e ligësitë e botës njerëzore sot e gjithmonë.

Në kundrimin tim të paskëtajmë, në tërë dyzet vjetët që kanë rrjedhur, hutimi i parë i tjetrit, që kishte kaluar tek unë pa vonuar shumë, duke u shpërndërruar kryeneçësisht në një përendje pa fund, atë shirit hutese që ndenji pezull dikur, me kohë e ka ngurosur në një hije të përhershme. Dhe ajo hije e ngrirë, ajo frymë pa shpirt, ka gjëllirë vetëm duke përshkardhur gjithë që është ndodhur në atë kolonë pa mbarim të mjerimit me maja të larta...



Tani jam në moshën e duhur për t'i parë gjërat si duhet. Edhe Arianën, fqinjën e dikurshme e shoh në këtë dritë. Vinte çdo mbrëmje në shtëpinë tonë për të ngushëlluar, me një energji që kurrkush s'e ka pasur. Rrinte me orë të tëra dhe, të mbledhur rreth dimrit, në odën e madhe ku halli i i patregueshëm ishte shtruar këmbëkryq. Im bir e kishte humbur jetën në një aksident rrugor, duke u gdhirë dy tetor, atëherë kur vjeshta sa po fillonte të ndihej. Shumë njerëz vinin dhe neve shumë pak kohë na mbetej që të ishim vetëm. Vërtet që fjala e vjetër, se në të tilla raste, njerëzit të mbajnë mendjen, është matematikisht e saktë dhe artistikisht e bukur. Një prej atyre që ne na mbajti mendjen ishte edhe Ariana, fqinja e bukur, që kishte dy djem, si yje të dy, emigruar edhe ata në Itali, por që në shtëpinë e saj jetonte e vetme, pasi që ndarë me bashkëshortin, një ish-ushtarak në pension para kohe, që kish krijuar familje të re. Ariana jo vetëm ishte e bukur, një bukuri e përsosur, e rrallë: sy të shkruar ngjyrë të thellë deti, fytyrë ovale, hunda e drejtë që nuk këputej kund dhe balli i lartë e i mermertë, vetullat e harkuara ëmbël, pylli i qerpikëve dhe flokët korb të zinj e aq të dendur që i vareshin gjer në bel. Trupi i saj i gjatë binte në sy menjëherë, i mbajtur bukur dhe i veshur me një finesë vërtet të hijshme. Çdo gjë e saj mbetej e përsosur. Të dy djemtë e saj që jetonin larg, të dy muzikantë dhe qyteti ynë i njihje mirë. Edhe ata i ngjanin si dy pika uji së ëmës, edhe nga trupi, edhe nga fytyra, ndonëse kishin një pamje mjaft mashkullore, tërheqëse dhe që vazjat e bukura betoheshin e linin kokën për ta.

Po. Ariana, fqinja jonë, me portat përballë, në një rrugicë që rrihej dendur nga njerëzit që ngjiteshin për në Kala dhe jo vetëm nga banorët e lagjes, kishte gjetur çelësin e ngushëllimit, pasi zotëronte bukur fjalën e ngrohtë, frymëzonte si të thuash një frymë tërë energji prej të marri, siç e quante edhe vetë. Ajo kish bërë të saj një zakon të çuditshëm: dilte dhe mbledhte karafila të kuq në shtëpitë e rrugicës, të lagjes dhe pastaj të qytetit. I ruante të freskët në vazo të gjata qelqi me ujë dhe aspirina për të rrojtur sa më gjatë. Dhe një herë në tri ditë do shkonte në varrezë për të çuar karafilat e freskët në varrezë. Nuk e pyeta kurrë pse e bënte këtë, por, më duket e kishte fiksuar fort në mendje se kështu ajo edhe mbronte të bijtë. Në varrezë, siç më thoshte nën zë një nga banoret e zeshkëta mbi kapelën e lagjes sonë, ajo lutej fort, me zë, një ligjërim i rrallë, as vajtim dhe as këngë e trilluar në çast, duke shqiptuar bukur e pa një të metë të vockël çdo fjalë, po me atë pasion që edhe tregonte e fliste mbrëmjeve apo pasditëve në odën tonë të madhe. Aty zjarri brambullinte fort, po edhe biseda shkonte në përpjesëtim me zjarrin. Ariana ishte vënë në qendër të ciklonit. Kishte fituar një autoritet të padiskutueshëm. Fshehtas saj diskutonin për të, sepse fjala e mirë për tjetrin ka një moral të përsosur, ndien turp dhe e kthen kokën pas, skuqet e tëra dhe nuk do që të përplasat ballas me syrin. Rri si e fshehtë, por thuhet me pasion dhe krijon vlerë të tjetërfartë.

Aty nga ora dhjetë e një të shtune, vjen një fqinjë tjetër nga Athina. Kishte marrë një qeskë të madhe letre mbushur plot dhe e vuri në tryezën anësore të odës. Im atë, që aso kohe rronte, mbështetur mbi dorakun e gdhendur prej dorës së tij, shikonte zjarrin dhe shumicën e kohës mendohej. Fqinja e sapo ardhur nga Athina u takua me tim atë dhe e puthi pastaj në dorë dhe në dy faqet. Ime më kishte mbyllur sytë tre vjet më parë dhe tim eti i qe ulur koka fare. Edhe këtë që ngjau donte. Gjithë ai trup dhe kockë e fortë, tetëdhjetë e pesë vjeçare, i lartë si lis me dega, që rrëgjuar krejt dhe nuk binte më në sy. Belbëzonte vazhdimisht fjalë të pakuptueshme dhe mendohej të qëndronte në lartësinë e të zotit të shtëpisë. E pa gruan e sapo ardhur dhe sikur e kuptoi ç'kishte sjellë, e nuhati që ishte një dhuratë tjetër soj. Qeshi pak lehtë, duke lëvizur paksa mustaqen e hollë me një hijeshi të rrallë, kapë gjithçka me sy e me



FQINJA E DIKURSHME

Tregim nga Xhevair Lleshi

hundë dhe u gjallërua i tëri.

- Zonja Teftë na ke nderuar shumë me këto që ke sjellë. More vesh nuse, - i tha sime shoqeje, - Tefta ka sjellë fara karafili! Se ju i mbaruat të gjithë karafilat e qytetit! Na ke nderuar shumë zonja Tefta! Faleminderit! Na i bëj hallall mundimin.

Fqinja, domethënë Tefta, befaz u zverdh, përvijoi buzëqeshjen që iu shua menjëherë, por e zuri shpejt fillin. Dhe tregoi sesi e bija i qe lutur që të gjente fara karafili degëgjatë, të kuq, vetëm të kuq, për t'i sjellë si dhuratë kur të vinte para Krishtlindjeve për në shtëpinë tonë dhe sidomos për të shëruar Arianën. Ja kaq e thjeshtë paskej qenë. E hapi letrën dhe na u lut që farat t'i mbillnim tani në buzë të dimrit, por më mirë në buzë të pranverës, se ata filizat e rinj, edhe tani po t'i mbillje, atëherë do ta merrnin zhvillimin...

Ariana, ditën tjetër, nuk vonoi asgjë, i përmbysi vazot e shtëpisë sonë, mbi terracën e madhe të katit të tretë, madje mori edhe plot vazo të tjera të gjata e të thella, i mbushi me dhë të freskët, gjeti humus pylli dhe e përzjeu me një dashuri të skajshme, e prushëruar nga zjarri i pasionit të menjëhershëm dhe dy ditë u mor me rregullimin e vazove në të gjithë rrugicën tonë. Ne, mbrëmjeve, veç të tjerave dhe hallit që na mbante mbërthyer, mezi prisnim të bisedonim edhe për karafilat. Shtëpia jonë, për shkak se nëna ime mbahej si zonjë e karafilave, njihje si e tillë. Unë e besoj se edhe atje ku ishte ajo duhej ta kishte marrë vesh atë që po ndodhte dhe isha i bindur se fërgëllonte nga dëshira për t'i parë...

Ditët kalonin shpejt. Iku dhjetori, iku dhe janari dhe ditët e para të shkurtit mbinë kudo. Tefta këshillonte nga Athina, nëpërmjet telefonit, sesi duheshin ujtur, si duhet të mbroheshin nga era. E gjithë rrugica jonë tundej nga biseda për karafilat. Prisnim me ankth ç'do të ndodhte. Më e shqetësuar ishte Ariana. Në fund të majit ishin rritur goxha dhe po bulonin gonxhet e para. Oh ç'mrekulli do të ishte. Shtëpia jonë fërgëllonte nga njerëzit dhe nga dëshira për t'i parë një ditë e më parë si do të dukeshin, a do ta kishin ruajtur ngjyrën. Dhe nuk vonoi të vinte dita. Nga fundi i qershorit, karafilat e kuq kishin lulëzuar degët me karafila, jo të gjithë njëherësh natyrisht. Gonxhe të tjera kishin buisur, të tjera bëheshin gati, duar-duar. Të ngjiteshe në terracë mbetesh pa frymë. Shpërthimi i tyre dukej i rrallë, një mrekulli i paparë. Ariana shkonte

shtëpi më shtëpi, ujiste karafilat, këpuste dytri degë dhe i ruante më vete sipas zakonit të vjetër, për t'i mbrojtur aty, plot finesë, pasion dhe dashuri të pa treguar. Karafilat na kthyen buzëqeshjen. Edhe në varrezë, sheshin e mermertë të tim biri e kishte mbushur me vazo plot karafila të kuq. Ishte gati ta bënte këtë për gjithë varrezën. Qe bërë e njohur, përveç fjalëve që përhapeshin me shpejtësi rrufeje, edhe prej vizitorëve të varrezës, të atyre që e ruanin si të shenjtë këtë ritual njerëzor...

E gjeta të menduar Arianën. Madje i dridheshin duart. Fytyra i dukej e lodhur dhe vura re se kishte rënë pak. Gishtërinjtë e saj të gjatë e të mbajtur bukur, si çdo pejzë e trupit të saj elegant e të përsosur, që do të kishte qenë me siguri një modele e rrallë, ndonëse po kapërcente vijën kritike kur femrat nisin tatëpjetën e rrokopujshme, po kryqëzoheshin me nervozizëm dhe dukej e përqendruar. Shpesh herë e gjeja duke qeshur, duke treguar diçka, apo në të tjera situata të ngjashme, madje edhe duke kënduar lehtë ca melodi të viteve tona, që të rrëmbenin, por në këtë gjendje jo, kurrë. Atë njeri edhe këngët e bënin të derdhte lot dhe lotët i kishin hije. E rrallë. Po ç'kishte Ariana? Vonë, po e zbulova. I kish dalë viza për të shkuar në Itali. Dhe seç ndjente një kënaqësi të fshehtë, i bëhej se kjo ishte vërtet diçka e mirë. Do të shikonte djemtë. Por halli i saj ishte sesi do të ndahej nga ne, si do të na linte vetëm. Kushdo tjetër do të dukej se po e bënte nga halli, apo për t'u dukur. Edhe im atë e këshilloi të shkonte një orë e më parë te djemtë. E dinte Ariana që na kishte falur kaq shumë gëzim dhe dashuri? Ndoshta nuk i kishte vajtur kurrë mendja te kjo gjë. Ajo dinte vetëm të buzëqeshte me vete dhe unë mendoja se ajo me siguri merrte urime prej një bote të padukshme. E pashë pak më vonë si u ngrit dhe puthi një nga karafilat e ruajtur në vazot e gjatë të tryezës. Dhe filloi një ligjërim të saj plot dashuri për karafilat. U patakua nga fjalët e zgjedhura, rrethuar me heshtje dhe me sinqeritetin e tmerrshëm që na rrethonte. Gishtërinjtë e saj dridheshin prej tronditjes dhe emocionit. Ndjenjë e madhe. Sytë e mrekullueshëm të saj na rrethonin me magji.

Ndjeva portën që trokiti fort, ndonëse porta jonë kurrë nuk mbyllej. Pashë nga dritarja se rrugica ishte mbushur me njerëz. Dhe zbrita me vrap.

- Ç'ka ndodhur?

- Kemi ardhur këtu se s'dimë ku të

përplasemi, - tha Ylli, kryetari i Bashkisë, mjaft i shqetësuar. - Edhe këshillohemi. Aty është Ariana?

- Këtu.

- O Zot! - tha ai i tmerruar. - Nesër do ta nisim për në Itali. Po, po, do ta nisim, belbëzoi kryetari. Do ta nisim. Po baba lart është?

- Po.

- Epo, ngjitemi, ç'presim. Do ta takojmë pak, na ka marrë malli, - shtoi duke rrokullisur fjalët me të shpejtë.

U ngjitëm. E tërhoqa Yllin paksa mënjane.

- Ç'ka ndodhur, vëlla?

- Eh! E tmerrshme, miku im. Janë vrrarë të dy djemtë e Arianës! - belbëzoi duke shqyer gojën dhe rrëzoi fjalët me një drithërimë të llahtarshme.

- Pse? Pse? Pse *asaj*? O Zot i madh! Çfarë gjëme! Si do t'ia themi? Si? Si do t'ma nxërë goja? Se që duhet ta vëmë në dijeni kjo s'diskutohet. I tërë qyteti zien. Ka që në mëngjes. Vetëm këtu s'paskan mbërritur lajmet. E ka dhënë edhe televizioni, radiot, shqiptare dhe italiane... S'di. Më janë tharë fjalët dhe po më digjet shpirti... Si? Do Zoti dhe na ndihmon *baba*...

Natyrisht që mbeta pa frymë. Në tym, i shkova krahu Yllit dhe vijuam në odë. Lule xane të gjithë. Ariana, vura re, ishte në këmbë dhe po dridhej.

- *Baba!* - thirri fort. - *Baba!* Këta burra kanë ardhur për mua. Ja, tani ma tha dikush, një zë në vesh, më belbëzoi. O Zot i madh! Mos! Mos! Mbaje dorën! Jo, Ylli, kryetar. Mos e thuaj, e kuptova, e ndjeva, ma tha dikush në vesh, më dogji një zjarr që unë e shoh, e ndiej, e kam parë, e kam ditur me kohë, më përvëlloi, më ndihmoni... Dhe ra, u fik, shembur në tokë.

Niki, ime shoqe, e tmerruar, u derdh sipër saj, i hodhi ujë, gjeti amoniakun që mbante në xhepin e brendshëm të fundit, i hodhi dy-tri pika, u shemb, u çor, u gris.

- Korba! Korba! Ariana, shpirt, dritë, jetë! Ç'na bëre, motër! E bukura, zemra, halli, drita jonë! Ç'ka ndodhur more burra që rrii kështu? A ka ndonjë mjek këtu? A ka njerëz që ta mbajnë pak këtë zemër të madhe? Si? Si? Si?...

Me gjithë përpjekjet e mia, mundin dhe dëshirën për të bërë diçka të pamundur, të mirë, s'po e gjeja dot. Vura re tim atë, në këmbë që kishte vënë duart në kokë dhe shtrëngonte fort kapelën, sikur ta kishte fajin ajo. Qe mekur. Pali, një nga mjekët që shoqëronte kryetarin dhe turmën e sapo ardhur, po merrej me Arianën që ende s'qe përmendur. E gjithë oda e madhe ishte përmblytur nga pëshpërimat, fjalët e kobshme, llahtari dhe nga të pathënat, mendimet që vraponin me shpejtësi të kobshme. Kishte ndodhur e padëgjua, në ngjyra aq të forta e plot zi të madhërishtëm që bënte majë kudo që të futej, që s'mund të tregohet. Nuk arrija dot të depërtoja në shpirtin dhe zemrën e secilit, por i ndieja afër të gjithë. "O Zot! Djemtë e saj! Ariana! Si e kuptoi menjëherë? Dhe m'u kujtua im bir, ëndrra e tij e Vdekjes, që ashtu si e pa, ashtu e jetoi e i ndodhi. *Njeriut i dëfthehet!* Nuk e ka sjellë kot gjer kësaj dite, i pari! Është syri i tij shpirtëror që di ta përcjellë kumtin. Dhembshuria prekëse është aty, e lodhur, e rrëgjuar, e fisnikëruar, e këputur por e shoqëruar me një forcë të jashtëzakonshme. Ia dha drurit - u tha! Ia dha gurit - u copëtua! Ia dha njeriut - e duroi! Janë tri fjali pikante. Arrin njeriu ta pikasë të keqen e tij, arrin ta rishpikë edhe jetën, arrin të heqë edhe kalbëzimin shpirtëror dhe të futet në një botë tjetër. Befas Ariana dhe Niki u ngritën të dyja. Gruaja e bukur, e përsosur, eci dy hapa e mbajtur nga ime shoqe dhe iu afrua Yllit me hapin që nuk e mbante dot.

- Ylli, ma thuaj siç e do nderi i kësaj ode!

Dhe Ylli ia tha gjëmën. Një klithmë çau shtëpinë time, një bubullimë është pak të thuash! Thika e vetëtimtë e saj çau qiellin dhe zemrat. Karafilat e kuq të lagjes, kudo, sikur i pashë, kishin ulur kokën. M'u bë se erdhi im bir, u hodh në krahët e të dy nënave dhe po u fshinte lotët...

Brisku i berberit

Duke zhytur furçën e rrojës thellë, ai filloi të përgatisë shkumën aromemirë të rrojës. Shkumën që rrafshon gjer në rrëzë të mishit qimet që harbohen cipës së fytyrave tona. Shkumën që i paraprin briskut që shpërfaq hapësirën e të sipërfaqshmes që i paraprin pamjes së qashtë të mishit në fytyrën tonë.

E kryente këtë veprim me krahun e vet hollak si shkop violine të qarkuar subjektivisht me delikatesë rreth objektit. Një tas alumini në formë opake. E kryente veprimin si të ishte duke ekzekutuar muzikë. Muzikë të prodhuar nga një shkop violine. Fijet e të cilit ishin shkëputur nga krifat e qafës të kushedi se kujt kali, po aq të hasdisur në Rëniën e tij, thellë drejt zhytjes së furçës me qime të gjata edhe ato të mara prej jeleve të Rëniës të një tjetër kali, ndoshta vëllait të atij që pati qenë më me fat pasi kishte lënë një pjesë të vetvetes në një shkop violine të fatëzuar për të prodhuar muzikë dhe jo në qimet e një furçe përjetësisht të fatëzuar për të prodhuar dhe shpërhapur mbi fytyrën e njeriut veç shkumë-rrojën e berberit.

Nga qafa e kafshës drejt tasit me shkumë, berberi qarkonte shkumën si të ishte duke rrahur një të bardhë vezësh, produkt me të cilin filloi të mbushë me furçë më tej hapësirën e fytyrës dhe gushës time. Një dorë e lehtë - pupël - përhapje mbi faqe dhe zbriste nën gushë. Nuk do ta besoja se pikërisht ishte një dorë njeriu ajo që e kishte përhapur aq lehtë shkumën e bardhë mbi çdo pore në veçanti. Tepër delikate. Si tingull violine. Si era që lehtësisht shkund nga pema dhe shoqëron Rëniën e gjethes mbi tokë. Si era që shpërndan pjalmën e luleve. Nga veshët gjer tek mustaqet mbi buzë. Si një Maskë e bardhë përtej së cilës dy sy të habitur ia kishin ngulur sytë - syve të pasqyrës që pasqyronin vështrimin drejt syve të mi. Ky lloj kryqëzimi ku sytë vështroheshin mes-veti, ku sytë miqësoheshin me njëri-tjetrin, duke pasqyruar vetveten tek njëri-tjetri, sy-ndër-sy, nuk zgjati shumë. Diçka e shndritshme vizgëlliu në një fraksion fragmenti mu në zonën e ndërthurjes së vështrimeve. Berberi prej një pakete nxori një brisk «Astra». E ndau më dysh. Njërin nga anët e mprehta e fiksoi në mekanizmin e rrojës. E hapi dhe e shtriu përsëri plot elegancë krahun e vet sipër kokës time. Me briskun mbi krye, muzika filloi të shpërhapje në trajta të një gërvime *non tropo allegro*. Kontakti i acartë i briskut filloi të priste hollë-hollë qimet e dendura pranë veshëve që përgjonin zhurmën metalike mbi sipërfaqen mishtore.

Qimet thellë-thellë, në pasqyrë nuk përfaqësonin gjë tjetër veçse faunën e pasqyrave. Atë gjelbërim të paanë të barit të pashkelur ndër fusha që pritet të batohet nga thundra kuajsh të kalorësve të padukshëm, ata që i quajmë Barbarë, të cilët kurrë nuk mbërritën gjer këndeje, në territorin tonë, në pjesën e këndejeve të pasqyrës. Në këtë berberhane qimet e mbuluara nga shkuma përngjajnë si fauna brenda pasqyrës e mbuluar nga dëborë. Një pah i papritur pudrërije në rrugëtimin e vështrimit tim që ngulmon kokëfortësish të kapërcejë kufirin e pasqyrës. Atë kufi përtej të cilit dëgjoheshin vringëllima armësh. Atë horizont prej ku pritej me ngulm t'ja mbërrinin Barbarët. Atë botë që mbante të ngujuar një tjetër botë, pothuajse të njëllajtë dhe fare të ndryshme nga kjo e jona. Harmonia mesa dukej kishte kohë që ishte prishur. Kufiri mesa po kuptohej kishte shkuar që ishte vendosur. Dhe asgjë nuk po ndodhte. Asgjë nuk po ndodh. A thua se me doemos duhej të ndodhte diçka përsipër asaj bore të përtejme që vazhdonte kokëfortësish të qëndronte e pa shkelur. Dikur ndoshta nuk ka pasur kufij.

DY TREGIME NGA FLURANS ILIA



Ne këndeje dhe ata andej, ishim një e vetme e përkryer. Shumë kohë më parë, ata që i kanë përjetuar ato kohëra, nuk e kanë pasur edhe aq të vështirë të përshkonin pasqyrat. Sot, copa e xhamtë është kufiri. Kufi të cilin po të tentosh ta kapërcesh, i gjithë imazhi dhe një botë e tërë pas tij, do të thërrohet dhimbshëm duke fshirë gjithëshka nga thembra jote e kujtesës.

- *Plako qeke mjeshtë, nuk tu nika fare dora mor' burrë i dheut.*

- *Faleminers, tu rritë nera.*

- *Nga je ?*

- *Prej veriut.*

- *Ke kohë që ke ardh n' Tironë ?*

- *Kam ardh dy-tre vitet e para t' fillim-shekullit.*

- *E paske mësu mirë zanatin.*

- *Vetëm këtë punë din t' baj prej kur kam ardh dhe jetoj ktu.*

- *Pse nuk ke punu noj punë tjetër ?*

- *Jo.*

- *Po çka ke bo në fshatin ku ke qenë ?*

- *Nuk kam punu.*

- *Si nuk ke punu, po ti je alamet djali mor vllai im, dhe qeke mjeshtë.*

- *Nuk kam punu.*

- *Mirë mër mirë, e mora vesh që s'ke punu, po çka ke bo ?*

- *Kam kenë i ngujum.* - tha, dhe me një pecetë të lagur me ujë të ngrohtë ma mbështolli lehtësisht pa u ndier fytyrën e porsa zhveshur nga qimet.

Kontakti i mishit tim me ujin ishte jo dhe aq mosbesues, përkundrazi seç mbartte një frymë paqtimi, megjithëse brisku dorëlehtë i berberit ta përcëllonte paksa cipën e fytyrës. Mora frymë thellë. Ndeza një cigare të hollë "leggera". I dhashë edhe atij një. Bëra pagesën ndërsa prej hunde më gufonte përjashta gjoksit tymi i hidhur i duhanit të atij mëngjesi të një dite të re. Më tej u lëshova jashtë porte drejt e në xhunglën

e Unazës së Tiranës, për tu përzier me lumin e njerëzve drejt rrugëve që rridhnin bardhësisht si rruga e qumështit, ku mund të pikasje me sy të lirë lloj-lloj figurinash, ndërmjet fytyrave të së cilëve edhe atë më simpatikun, njëbrirëshin, që shfaqet dhe zhduket papritur mes nesh, i avullt pas xhamave të ndonjë dritareje të vogël, ashtu si një rekuem, në fundin e një rrugëtimi rrethor që, përfundimisht ndoshta, mundet të jetë edhe pika e fillimit.

Telefoni i prishur

Çiko ja tek po ta them se një nga pejsazhet më mbreslënës të udhëtimeve të mia në Amerikë ka pas qenë hyrja atë natë dhjetori në Çikago kur isha njëzet e nëntë vjeç.

Ti nuk kishe lindur ende.

Binte borë dhe ishte pragu i ndërrimit të viteve. Jo një prag i zakonitë ndërrimit të viteve, njëherazi edhe pragu i ndërrimit të shekujve Çiko dhe isha shumë hi. Hi jo si në kuptimin e hirit në shqip. Por hi në kuptimin anglisht, dmth lart, shumë lart në atë farë niveli si sythi që lëkundet nën puhizën e erës kufijve të shteteve dhe krahinave. Ti do pyesësh cili është ndryshimi këtu dhe në Çikago? Ja tek po ta them Çiko se ti ke lindur në shekullin e kollajllëqeve të teknologjisë ku bota është bërë një fshat i madh global. Nërkohe që në vendin ku u linda unë jo çdo njeri kishte telefon në shtëpi. Shumica e telefonave përgjoheshin nga shteti. Ata që kishin telefon duhej ta rrotullonin me gishta shifrën ekzakte në receptor që të krijonin universin e numrit përkatës.

Kur mbusha tetë vjeç në moshën që

je ti tani, luanim me një lojë që e quanim "telefoni i prishur". Ule atë drejç celulari dhe më dëgjo dy minuta. Çiko më dëgjon? Në atë kohë në botën e jashtë kufijve tanë celulari ishte si një bebe i porsangritur në këmbë.

Një kat poshtë nesh jetonte një vajzë e paralizuar, ndoshta pesë vjeç në atë kohë, e thërrisim Çika. Paraditeve ishte e vetme në shtëpi sepse prindërit e saj ish studentë të viteve tetëdhjetë të arratisur nga Jugosllavia pas protestave në Prishtinë, ishin të detyruar të shkonin në punë në Kombinat.

Sapo kthehesha nga shkolla një gjysmë ore çdo ditë i dedikohesha Çikës për të cilën më vinte keq dhe e doja me gjithë shpirt si motër. Kisha shpikur një si tip telefoni i cili ishte i përbërë nga dy kuti shkrepsje të lidhura ndërmjet tyre me spango të cilën e lëshoja poshtë ballkonit drejt e te karroca paralitike ku priste e ngujuar Çika. Nuk shiheshim por dëgjonim fjalët e njëri-tjetrit me zë të ulët si të ishte një ritual kungimi i përditshëm. Si dikur kur dëgjonim në fshehtësi Radio Prishtinën. E ke parasysht si zëri i psalmit në liturgjinë e këndimit të librit. Apo mërmërimat e shtruar të syreve muslimane. Ja, pak a shumë ashtu. Por ti nuk ke se si ta dish Çiko. Ti je i lindur në epokën e Dua Lipës, Rita Orës, Bebe Rexhës, brezit shpirtshpërthyes të pas luftës.

U bë kohë që nuk kam hyrë në tempullin e poezisë të ndez një qiri, Çiko.

Po vdes nga dëshira për pak klasicizëm të kulluar. Se ky koncepti i klasicës dhe modernes është ca i koklavitur Çiko djali. Vështirë të përcaktohet me saktësi se ku mbaron njëri dhe fillon tjetri. Ti do thuash përse, çfarë do ndryshoj në jetën tonë qiriri apo poezia? Nuk është e thënë që çdo gjë patjetër duhet të ndryshojë. Qiriri veç tretet duke bërë dritë dihet kjo. Por nuk ke se çfarë e do qiririn kur teknologjia e sotme ka mbërritur te ndriçimi LED, i cili ndriçon më shumë dhe shpenzon shumë më pak, në këtë pikë jam dakord me ty Çiko.

Mjetet ndryshojnë por njerëzit janë po ata. Poezia ngelet po ajo. Si maturimi i verës nëpër kështjella. Apo i *whiskeyt* nëpër kade të ndërtuar në dru qershie. Meqë ra llaf Çiko, më hidh një pikë *Jack Daniel's* të lutem po qe se nuk e ke problem? Si? Ku janë gotat? Nuk ka nevojë ja ma hidh këtu në filxhanin e kafesë. E di. E di që është ende mëngjes. Ti e di që unë nuk pi në mëngjes por paskam nevojë të flasim sot.

Në vend të karrocave me kuaj dikur njerëzit udhëtojnë me makina sot. Në vend të pasqyrave shihen në celularë. Më e bukura e bisedave me *video chat* është se paralelisht me imazhin e bashkëbiseduesit në një katrorë të vogël te cepi i ekranit të celularit na shfaqet fytyra jonë e vetmja gjë që na intereson gjatë krejt bisedës. Mënyra se si dukemi të krehur, të pa krehur, me tualet apo pa të, stres më vete. Aman ka qyfyre po të them, me veshje serioze nga mezi e lartë a me pizhama nga mezi e poshtë, si puna e aizbergut me një llaf.

Në kohën e fëmijërisë kishim veç dy kuti të boshatisura shkrepsje që komunikonin me një kordon spangoje.

Është mahnitëse njësoj si thua ti kur humbet në lojërat e tua elektronike, se si filli i spangos e tejzon zërin Çiko. Është fantastike po të them. Do ta provosh të komunikojmë? Si? Nuk je i interesuar ta dish? Po mirë të paktën më dëgjo. Ma jep pak çakmakun. Paff. Tymnajë nanuritëse si gjumi i shpejtë i pasdites ajo ndjesia e dikurshme e shkrepsjeve të drurit. Ja një sekondë... O tymnajë e Andromedës kush ja pa hajrin nikotines? Si? Poo, e ku ka si rituali i ndezjes së shkrepsës. Edhe duhani shijon më mirë.

Që thua ti Çiko meqë nuk po më thua asgjë, më pyeste Çika çdo ditë se si kaloja në shkollë asokohe? Kush ishin të rejtat e ditës? Çfarë kishim bërë si orë mësimi në lëndën e historisë? I interesonte shumë historia, veçanërisht Historia e Shqipërisë. Dhe unë

nisja t'i interpretoja plot nota dramatike me një lloj diksioni radiofonik se si kishte qenë historia ime e asaj dite. E çdo dite të vetme në veçanti. Ngjyresave të intonacionit dhe leksikut të fjalëve u shtoheshin pasthirrat e habitës të një kati më poshtë. Pastaj e qeshura me gjithë shpirt i bashkangjitesh humorit tim të zi si komedian i cili më bën të qesh me veten time për nga forma se si i kundërvihet personazhit dramatik brenda meje. E di. E di se jam një tragjikomik i pashmangshëm Çiko.

Kur historia e ditës ishte e thurrur ashtu si duhej dhe shkante natyrshëm drejt fjalisë së fundit gjithmonë pas kësaj ndieja atë boshllëkun që të krijohet në fund të stomakut, një përzierje ankthi dhe malli, një peshë lehtësisht e varur nga zëri në fill të spangos. Gjersa tridhjetëminutëshi i argëtimit mbaronte dhe i mblidhja mjetet e komunikimit. Në duar pas atij çasti mbaja si premtim për ditën në vijim parmakun e ballkonit të një kati më poshtë. Shikoja dorën e saj që zgjatej nga parmakët dhe kaq. Si në një tregim radiofonik koha nuk mjafton asnjëherë për t'u përhumbur pas zërit. E njëjta ndjesi kur dëgjon brenda teje zërin e Krijuesit pak rëndësi ka forma e religjionit thelbi është po ai.

Vite më vonë, po të flas tani për udhëtimin në Çikago në vigjilje të vitit 2000 Çiko, u kujtova për Çikën. Më erdhi në mendje se si aq papritur Sigurimi i Shtetit diku aty nga fundi i viteve tetëdhjetë i kishte lëvizur përgjatë natës komshijtë tanë dhe se i kishin shpënë në një vend më të sigurt dhe të fshehtë sepse ndiqeshin nga UDB-ja. Kështu u hap fjala aso kohe por e vërteta nuk u mor vesh asnjëherë. Ti do pyesësh se kush drejtin është UDB-ja? Shërbimet sekrete të ish Jugosllavisë, Çiko. E pra, që të mos bëhet tema tërkuzë si të gjitha muhabetet me UDB, atë natë në Çikago u takuam për herë të parë pas njëzet vitesh me prindërit e Çikës që kishin fituar strehim politik në Amerikë. Ata më thanë se Çika kishte humbur betejën me jetën dhe kishte përqaftuar vdekjen diku nga fundi i viteve nëntëdhjetë, por asnjëherë nuk kishte rreshtur të pyeste se ku gjendej tashmë djali nga Shqipëria me telefonin prej shkrepseje?

Kujtuam ato vite aq të pafajshme por edhe aq të bukura kur ishim komshinj në Tiranë. Ata kishin tashmë një vajzë tjetër të cilën e quanin Valbona dhe që është e lindur në Amerikë njësoj si ti Çiko. Dhe habia më e madhe e imja e asaj nate në Çikagon, Çikojë im i dashur, ishte se për të parën herë pas njëzet viteve mora vesh emrin e vërtet të Çikës e cila quhej Drilona. E shikon sa emër i bukur? U kënaqa pa masë me ta atë natë. Pimë edhe raki, Çiko. Ti e di se çështje raki apo jo? Nuk e ke provuar asnjëherë? Oh, nuk ke mbushur moshën. Po, ke të drejtë. Çdo gjë kërkon moshën e saj. Sipas vendit bëhet edhe kuvendi. Si puna e lodrave të fëmijërisë është edhe gjuha. Kjo e jotja sot quhet gjuhë elektronike. Vazhdo Çiko, vazhdo se po të bezdis me këto rrëfenjat e mia me të cilat vetëm kur të rritesh ose do t'i kuptosh si duhet, ose ndoshta do qeshësh me to. Fundja është e drejta jote të qeshësh edhe me titullin e këtij rrëfimi. Ose ndoshta do ta kërkosh në Google? Motori yt i vetëm i kërkimit. Dhe të siguroj se nuk ke për ta gjetur. Si? Oh, përse më përket mua i dashur Çiko, ja tek po ta them se ngelem algoritëm i tjetërllotjës, nuk zhbëhem dot kollaj prej habitatit tim natyror. Mendohem të përshtatem dhe funksionoj me një forcë të ndryshme kërkimi përmes hartës së kujtesës, veç sa për t'i dhënë kuptim këtyre thërimeve të hapërndara mbi mbulesën e bardhë, vështrori me kujdes Çiko? Shiko. Nuk ka gjë më fisnike në këtë botë se sa thërimitet e bukës në një tryezë, sinqerisht, për këtë bukë që po hamë.

Montréal, Shkurt 2022

ÇMIMI "LUMO SKËNDO" PËR VEPRËN MË TË MIRË TË VITIT 2021

Nga Uran Butka

Juria e çmimit "Lumo Skëndo", e përbërë nga Prof. Dr. Dhurata Shehri, Z. Piro Misha, drejtor i Bibliotekës Kombëtare, Prof. asoc. Dr. Belina Budini, Dr. Dorian Koçi dhe Uran Butka, punoi me intensitet e përgjegjësi për mëse 7 muaj, qysh nga data e krijimit të këtij çmimi nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, për të arritur në vlerësimin e përzgjedhjen e librit më të mirë ndër botimet e vitit 2021 në fushën e publicistikës, eseistikës dhe atë studimore.

Mendoj se ky çmim është i rëndësishëm, sepse, së pari mban emrin e Lumo Skëndos, këtij kollosi të kulturës shqiptare, botimin e veprës së tij të plotë prej 12 vëllimesh po e bën suksesshëm Instituti i Studimeve "Lumo Skëndo", me mbështetjen financiare të deputetit Agron Shehaj, dhe së dyti, sepse nxit, stimulon dhe vlerëson botimet më të spikatura shqiptare në këto fusha.

Juria procedoi sipas rregullores së Qendrës Kombëtare të Librit, legjisllacionit shqiptar dhe shqyrtimit me profesionizëm të lëndës shkrimore: nga gjithë botimet e vitit 2021, vlerësoi dhe përzgjedhi fillimisht 50 librat më të suksesshëm, mandej prej tyre 17, dhe më në fund 5 finalistët: Libri "Të lirë" i autores Lea Ypi një botim befasues; "Arbëreshët" e autorit Fatmir Toçi- një botim i mirëfilltë shkencor; "Jetë burgu" i Fatos Lubonjës, një rrëfim ndryshe, i jetës së burgut, ku nuk flet fare për vuajtjen e tij; "Posteri shqiptar" nga Rubens Shima, botim i veçantë figurativ i posterave nga Rilindja dhe deri në ditët tona dhe "Zbulimi i At Zef Pllumit" i autorit të mirënjohur nga Kosova Kujtim Shala, ku zbulohet mjeshtërisht At Zef Pllumi si shkrimtar, pra, e përfaqësuar gjithë hapësira kulturore shqiptare.

Theksoj se për të nxjerrë saktësisht fituesin u votua disa herë gjatë procesit dhe përfundimisht rezultoi autorja Lea Ypi me librin "Të lirë".

Lea Ypi, profesoreshë e Teorisë Politike

në London School of Economics, teoricene, studiuese, shkrimtare, me disa vepra të botuara në anglisht, por që ka zbritur edhe në atdheun e saj me librin e suksesshëm "Të lirë", ku na jep përpjekjen për të zbuluar të vërtetën e jetës, kuptimin e saj dhe të konceptit të lirisë me qasje të kundërta, në kohën e diktaturës komuniste mizore, mashtruese e absurde dhe të kalimit në kapitalizmin liberal, por anarkik dhe traumatik në Shqipëri (kujto vitin '97), dhënë në libër me origjinalitet, vërtetësi, sinqeritet fëmijor, humor të hidhur, rrëfim magjik, personazhe të spikatur, nëntekst dhe meditim filozofik apo politik kritik, nëpërmjet kujtimeve të mirëfillta të fëmijërisë dhe adoleshencës.

Historia e saj është edhe historia ime, historia jonë, që ne e kemi jetuar edhe periudhën e regjimit Stalinist dhe jetojmë edhe kohën e tranzicionit të vështirë demokratik. Është një histori e vërtetë, ndaj edhe një libër i vërtetë.

Një ese për lirinë.

Juria ka pasur në fokus të vlerësimit vetëm librin, jo autoren, ka vërejtuar përpjekjen njerëzore për të mos e humbur kurrë lirinë e brendshme apo për të mbijetuar dhe bërë përpara në çdo sistem apo rrethanë.

Përfundimisht vlerësimi i Jurisë është shënuar në motivacionin e çmimit "Lumo Skëndo" për veprën "Të lirë", vepër që na nderon edhe nëpër botë, tek është përkthyer në mbi 15 gjuhë.

Tani, e dashur Lea, si bashkëvuajtës, edhe sepse e njoh familjen tuaj, me babanë tuaj të nderuar Zaferin kemi qenë deputetë të PD, por edhe si koleg me ju, kam qenë pedagog dhe kam shkruar disa libra, ndaj më lejo të polemizoj me ju dhe të shpreh shkurtazi edhe mendimin tim, jo si pjesëtar i jurisë.

Është një libër i bukur dhe i vërtetë. Jam me ju si për kritikën ndaj sistemit totalitar komunist, qoftë edhe ndaj rendit kapitalist liberal. Edhe unë kam qenë dhe

jam kritik ndoshta më i thukët se ju për të dy sistemet pra, edhe për periudhën e tranzicionit në Shqipëri, me përpjekjen time për një shtet ligjor demokratik në mirësim e evolucion të vazhdueshëm, si një konservator që jam. Jo për revolucion e luftë klasash, por për bashkëpunim dhe respektim të lirisë e të drejtave njerëzore e kombëtare.

Në të dy sistemet politike liria tradhtohet, thoni ju, cunohet nga strukturat shtetërore, por edhe nga ato shoqërore. E saktë. Intelektuali i vërtetë duhet të jetë kritik, por edhe vizionar. Mendoj se tek epilogu i librit, duke qenë pjesë integrale e veprës, ose duhej të kishte rrjedhur edhe atje rrëfimi natyrshëm, i distancuar nga autorja, ose rrëfimi të mbaronte kur Lea adoleshente të largohej nga Shqipëria për në Perëndim. Mendoj se këtu duhej të mbaronte libri. Sepse idhujtaria, dilemat e përsiatjet politike dhe ideologjike të Leas së sotme për konceptin e lirisë, në kapitalizëm dhe socializëm, mendoj se e cënojnë spontanitetin e veprës dhe e mjugullojnë vizionin, - utopik të autores, sic thotë edhe kryezonja Leman, gjyshja e Leas, vision që bie ndesh me frymën, kontekstin dhe vërtetësinë e librit, pa dashur që unë të bëj kritikën e ideve të saj, që është e drejta e saj dhe e çdo autori.

E mbyll me fjalët e Leas: "E shkrova këtë histori për të shpjeguar, për t'u pajtuar, për të vazhduar betejën".

Mirëkuptohem. Suksese në betejën tuaj të ardhshme! Në gjurmët e Mid'hat Frashërit, idetë dhe veprat e të cilit u kanë qëndruar shekujve.

Me këtë rast, ju dhuroj albumin "Mid'hat Abdyl Frashëri", botim i Institutit të Studimeve Historike "Lumo Skëndo", një album ndryshe, sepse fotot e zgjedhura për Frashërlinjtë dhe Mid'hat Frashërin, pjesa më e madhe e panjohur, ilustrohen me tekst nga veprat e Mid'hat Frashërit, pra nga vetë Mid'hat Frashëri.



HIJE PA TRUPA

Kanë veshur xhaketen e dëshpërimit
dhe me vetësigurinë e të verbërve
vizatojnë portretin e tyre nëpër rrugë.
Vetë dielli si somnambul
mbahet fort pas krahut të tyre.
Nuk i lag shiu,
nuk i rreh era,
nuk i ngrin acari,
nuk i zhurit vapa.
Bëjnë sikur dinë të heshtin
që të mos i vrasë fjala.

KUSH E VAJTON ERËN

Kur vdes një gjethe,
gjethet e mbetura nuk vishen në të zeza,
siç ndodh rëndom me njerëzit,
nuk ka arkivol, as kortezh në përcjellje,
nuk ka drejtqëndrime ndanë rrugëve
dhe as grushte me dhë të shkrifët në ndarje.
Kur vdes një gjethe,
udhëton e vetme edhe pas vdekjes,
shkon drejt varrit me vezullimin që venitet,
pa ditur në do të ketë varr,
prehet në trotuarin e parë që gjen,
e zë gjumi, gjersa e zgjon ndonjë fshesar
dhe me lopatë e mbledh,
e hedh në grumbullin e madh
mes gjethesh të tjera të vdekura,
për t'i groposur shkujdesshëm
në një varr të përbashkët.
Kur vdes një gjethe,
gjethet e mbetura nuk vënë kujën,
po dridhen të shituara në heshtje,
çuçurisin tok në pikëllim të verbër.
Era e vjeshtës është vajtorja e saj e vetme.
Në këngën e erës nuk ka hipokrizi,
as shtirje, ka vetëm talent.
Ajo i avitet pa drojë mbretërisë së vdekjes
e pa solemnitete silllet degë më degë,
për të qarë gjer dhe gjethen e fundit.
Pastaj, si një qyqe e ngjirur,
tërhiqet e mekur dhe pa fuqi,
pa ruajtur asnjë fill të hollë zëri,
si fishekun e fundit,
për të vajtuar vdekjen e vet.

ZOGJTË NË PARK

Mbase zogjtë në park nuk mendohen si
unë.

Zogjtë në park çuçurisin hareshëm,
nuk meditojnë para filxhanit të kafesë.
Zogjtë në park recitojnë pa prerë,
kërcejnë mbi dy këmbë, nuk mbajnë kufje
në vesh.

Zogjtë në park shihen në pasqyrën e
liqenit,
pa salltanete në veshje, pa dëshirë për
selfie.

Zogjtë në park nuk ngushëllojnë për dikë
që mungon,
për ceremoninë e varrimit nuk pyesin në
telefon.

Zogjtë në park nuk e rrëfejnë dëshpërimit,
nuk ndezin cigare për të nxjerrë
hidhërimin.

Zogjtë në park puthen, pa drojë e pa
stepje,
besojnë te dashuria, nuk besojnë në
urrejtje.

Zogjtë në park nuk i ndërlikojnë gjërat e
thjeshta,
mendimi i tyre nuk shkon gjer te vdekja.
Zogjtë në park duken të lumtur, të hutuar
aspak,
mendimet atyre u duken pus i thellë me
kapak.

Zogjtë në park nuk mendojnë as për mua,
për mua që veten kap duke menduar për
ta.

Zogjtë në park nuk magjepsen në
meditime,

dita për ta ka gjëra më të rëndësishme

**SHPJEGIM PËR
ORËT***Poezi nga Jani Malo*

sesa mendimet që trazojnë mendjen time:
pse koha e shkuar është e pakthyeshme,
pse koha e sotme është e pajtueshme,
pse koha e ardhshme është e
paparashikueshme.

Mbase unë nuk mendohem si zogjtë në
park.

VIZATIM

Det i qetë, pa rrudha,
si tru i shpëlarë kujtimesh.

E vetme si vajzë që nuk di not,
me dridhje të purpurta turpi
në ujë pllauritet hëna.

Pastaj befas e puth një peshk.

GUASKAT

Kishin jetë, po nuk kishin lavdi dikur në
thellësi.

Kanë lavdi, po nuk kanë jetë tani në
sipërfaqe.

DIMËR

Ajo po vonohet ca si shumë,
mbase numëron
rrudhat para pasqyrës.

Ai e pret në rrugë
dhe harrohet duke soditur pemët e
zhveshura
që bëjnë *selfie* në pellgje ujërash.

NATA NË ZVËRNEC

Dielli i pari
mbështeti kokën në përkresë të valëve
dhe fjeti.

Pas tij fjeti dhe gjoli.
Pashë pulëbardhat kur e përkundën
dhe ninullën ia kënduan në kor.

Të fundit qiparisat, si murgjit,
u mblodhën kokë më kokë në Manastir.
Fjetën edhe ata.

Vetëm bukuria
nuk vuri gjumë në sy.

E ÇMENDURA

Çdo ditë pastron këpucët, lan, nden dhe
than,
hekuros dhe vendos në kremstarë rrobat
e të birit.

Fqinjët e dinë që ajo prej kohësh jeton e
vetme,
prandaj, teksa shohin si e respekton me
përpikëri
ritualin e saj të përditshëm, e quajnë 'E
çmendura'.

Si nuk doli njëri, të paktën një njeri, të
kujtohet
t'i dërgojë haber të birit të kthehet një ditë
dhe të veshë qoftë edhe një herë të vetme
ato që 'E çmendura' nuk harron t'ia bëjë
gati çdo ditë.

NË U VONOFSH

Në u vonofsh edhe pak,
vera nga gotat mund të avullojë,
mund ta pinë pulëbardhat e të dehen
dhe ashtu të dehura mund të bëjnë
marrëzi pa fund,
si për shembull, të puthen në buzë me
detin,
si për shembull, të bëjnë dashuri me
peshqit.
Në u vonofsh edhe pak,
unë gotat bosh do t'i thyej,
do t'i thyej pa arritur t'i mbushë harresa.

NË LLOGORA


Mjegullat bluhën
në mullirin e ndryshkur të pikëllimit,
pastaj pikojnë pikë-pikë
me lot monotone në faqet e pishave.
Mundesh edhe ti,
siç bëjnë Akrokeraunet me rrufetë,
të bluash aty psherëtimat?



Jani Malo

SHPJEGIM PËR ORËT

poezi



Neraida



– një grua nuk është vetëm trup, flokë, sy, duar. Gruaja është rrezatim. Ti rrezaton besim. Ti më bën të besoj...- “Kënga e Bilbilit”

Letërsia dhe arti në përgjithësi kanë mundësi të zbutin dhe të kapërcejnë të gjitha honet e errëta të jetës. Këtu mund të sjellin për krahasim një nga emrat më të shquar të kulturës njerëzore, Aristotelit, i cili rreth 24 shekuj më parë shkruante: **“I gjatë është arti, e shkurtër jeta”**. Ky perceptim, më ka shtyrë të mendoj gjithmonë që krijimi artistik është një gatim i mbujtur me lëndën e shpirtit, e ajo çka secili nga ne do dhe e beson, lidhet me pavdekshmërinë e këtij të fundit.

Për letërsinë thuhet që nuk të lejon të ecësh, por të lejon të mbushesh me frymë dhe me këtë nevojë për frymëmarrje, për refleksion, Stefan Ivanov iu ka mundësuar lexuesve një vështrim të historisë së Bullgarisë në periudhën e regjimit komunist, ku njerëzit, jetët, fatet e zakonshme, përngjajnë me jetën e shqiptarëve nën regjimin diktatorial. Nëse përshkrimet e ambienteve do të bëheshin paidentifikuar vendin e origjinës, lexuesit shqiptar do t'i dukej sikur në faqet e librit do të gjente Shqipërinë e diktaturës komuniste: i njëjti dorëzim tek njerëzit e thjeshtë, e njëjta përpulje ndaj regjimit, e njëjta klimë frike, përgjimi, të njëjtat ndërhyrje, të njëjtat privilegje për zyrtarët dhe i njëjti horizont i ngushtë shpresash dhe mundësish, ku të rrallë ishin ata që mund të ngriheshin drejt, pa u shtypur nga makineria shtetërore e kohës.

Romani ka një simbolikë të veçantë në titull: Kënga e bilbilit, që është paradoksi i kohës kur njerëzit angazhoheshin nga regjimi për t'u bërë sytë dhe veshët e pushtetit popullor, bilbilat me pagesë në shërbim të sigurimit të shtetit. Po rrëfimi nis me shtjellimin e personazheve që kanë secili një histori të veçantë, e që më pas gërshetohen në subjektin e veprës, duke dhënë e marrë me njëri tjetrin.

Tabloja e jetës bullgare, me fatet njerëzore të përshkruara në libër, tregon se rënia në barbari, në yshtjen nga rrëgjimi, është mjaft e lehtë, një rrezik kundër të cilit nuk ka ilaç përfundimtar. Atje ku cunohet liria e njeriut dhe ku shteti kërkon të infiltrojë mekanizmat e vet të kontrollit, mund të funksionojë vetëm jeta e dhunshme dhe policore – edhe kur diktatura bie, është e vështirë të hidhen rrënjët e ndryshimit, për sa kohë njerëzit, metodat e zakonet e saj bëhen pasues të ndryshimit të ri.

Dhe cila është “Kënga e Bilbilit”, detyra e tij? Të mbledhë informacion, të nxisë revoltë dhe trazira, e pastaj t'i shesë në duart e sigurimit të shtetit bashkëpunëtorët, sepse e tillë është makineria doktrinale: një përbindësh totalitar, unik, e në shumë raste gjakësor, ku individit duhet të jetë kolektivitet.

Por, shtresëzimi i dytë i titullit të librit, lidhet me domethënien lirike të emërtimit “bilbil”, një zog që i këndon dashurisë e mediton rreth saj.

Pasazhe të tilla janë të rralla, e pikërisht për këtë, janë të veçanta në tekst:

“Asnjëherë nuk ke si ta dish cfarë të pret, - u mundua të fitojë kohë Manoli, ndërkohë që zemra po i rrihte si e çmendur dhe ishte gati të dilte nga vendi. – një grua nuk është vetëm trup, flokë, sy, duar. Gruaja është rrezatim. Ti rrezaton besim. Ti më bën të besoj...Dhe po më pyet pse jam pranë teje? Edhe përbindeshi më i madh të ishe, edhe prostituta më e madhe, unë përsëri do të ndjehesha mirënjohës për këto momente që kam kaluar me ty...”

Mendoni pak, fjala “besim” si Graali i shenjtë, në një kohë kur mosbesimi ishte gjithçka për ata që frymonin nën diktaturë.

Ky libër iu drejtohet lexuesve të rinj, ata që nuk kanë një kujtesë të jetuar nga periudha e komunizimit dhe që gjithë sa dinë, janë fjalë të kthyer në shablone pa ndonjë rëndësi të veçantë, për një kohë të errët nga ku vështirë se mund të dallojnë gjë.

Ky lloj lexuesi, do të habitet kur të kuptojë që një pjesë e panoramës së përshkruar në libër, jo vetëm që nuk qëndron e ngërthyer tek e djeshmja e mbyllur, por është një tingull që kumbon fort mirë edhe sot, me një aktualitet që dëshmon se e djeshmja, fatkeqësisht, i ka trashëgimtarët e së keqes edhe në përditshmërinë ku jetojmë.

Së dyti, është lexuesi që ka lënë një pjesë të vetes dhe të viteve në kohën e diktaturës. Ky lloj lexuesi mund të endet më lehtë në labirintet e librit. Temat që trajton autori janë të njohura për këtë lloj lexuesi, që nga deviza që ne e dimë shumë mirë: në çdo tre vetë njëri është spiun”, deri tek ushtria me detyrim, rekrutimi nga sigurimi i shtetit, numri i mbyllur në shkolla, apartamentet si kuti shkrepe, sjelljet vagabondë që në mjaft raste nënkuptonin flokë dhe favorite të gjata, për të mbërritur tek njëtrajtësia, uniformizmi, e folura kolektive, e qeshura kolektive, histeria kolektive që ishte frymë e kohës.

Jetojmë në post diktaturë dhe jemi të prirë të jemi ende masë. Madje sot edhe më keq se dje, është vështirë të dallohet ku fillon e ku mbaron dikush, individualitetet janë të rralla e politika e zbrazët ofron të njëjtin qiell të ngushtë, të njëjtat ëndrra të lodhura, të së dikurshmes totalitare. Pa e ekstremizuar kohën e sotme, besoj se një lloj drithërime duhet ta ketë secili prej nesh, duke e ditur që shpesh herë na takon të flasim në emër të masës, të hiqemi në emër të masës, madje të bëjmë keq në emër të masës.

Për këto kategori lexuesish, “kënga e bilbilit” është një vepër e ndërthurur me linja motivesh të veçanta dhe të trajtuara me mjeshtëri. Shkrimtari kërkon të sjellë lexuesin në shtegun e hapur prej tij, ku modeli i së mirës dhe vlerat pozitive të jetës së njeriut, arrijnë të mbijetojnë edhe në kohët më të këqija. Ai komunikon me zërin që ushqehet nga pasioni dhe e vërteta, në një gërshetim të elementit historik, me zërin e shumëfishtë të cdo lexuesi, që e kthejnë leximin e romanit në një reflektim për ta kuptuar, për të mos u pajtuar me të keqen, si dhe për të jetuar me dinjitetin dhe vlerat që e lartësojnë dhe e bëjnë të çmueshme ekzistencën në botë të secilit prej nesh.

NË QIELLIN TIM BIEN YJE

poezi nga Dafjola Nepravishta

Në qiellin tim bien yje

Në qiellin tim
Çdo mbrëmje bien yje
Në jastëk ëndrrash
Tringëllojnë si monedha
Lind çdo mbrëmje
Hënë e re fosforeshente
Në qiellin e jetës sime.

Kopshti sekret

Vij gjithmonë këtu...
Kopshti i lirisë sime
Bota sa hapja e krahëve
Më mjafton drita jote
Gurët e kalldrëmit
hallkat e dëshirave të mia

Vij gjithmonë këtu ...
Këpus dorëzonjë
Më quani edhe hajdute lulesh
E pranoj..
Kapërcej mure
Mes dëshirave kacavirrem
Si jargavan
Limfa e saj mi hedh duart krahëve

Vij gjithmonë ketu...
Shndërrohem në lulekambane
Bëhem tingulli i saj
Tingull që nuk e dëgjuat kurrë
Do të vij gjithmonë këtu...

Statujë pa kokë

Cili Romeo të dashuroi i pari
E kokën e bukur ta mbajti kujtim ?
A mund te quhet dashuria robërim
Apo robërimi dashuri ?

Ti bukuroshe e çmuar pa kokë
e ftohtë, e ngurtë, trup mermer
Si në sfilatë drejt qëndron
pëlhurëbardhë, gji e gushë nxjerrë

A mos vallë dhe gjakun
Si verë të kuqe në gota ta pinë
Në arkëz ta vendosën kokën
E për trofe ngritën dollinë

Toka

Në gjirin tënd, jetë merr gjithçka
Filizave të njomë, si nënë e përkushtuar
shtatin ua rrit
Lulet e tyre, çast nusërie
si vello flokëve
I buzëqesh diellit
se borxh i ke rrezet
I buzëqesh ujit
se borxh i ke jetën
I buzëqesh rinisë
që kurora thurrit
për të dashurit
U buzëqesh kalimtarëve
e u thërret në emër
Ti të gjithë i njej
Se hijet e tyre i mban në kujtesë
nga dita që lindin
deri në harresë



Le të pyetemi si ndodh që në prag të Lzanafillës së një shtjelle të dhunës globale, të njeriut ndaj njeriut, shpërfaqet një roman si ky i Agron Tufës “Ngjizja e papërlyeme”? Mos ndoshta letërsia dhe marrëdhëniet aktuale njerëzore janë dy kahe të njerëzimit? Mos ndoshta letërsia guxon të ngreh krye edhe në këso konstelacione, apo aq më shumë mos ndoshta në të vërtetë letërsia pakontrollueshëm hapet si një zonë e shpirtërores për të gjetur një kuptim e mirëkuptim ndërnjerëzor.

Si të lexohet letërsia në kohë të luftës, posaçërisht letërsia dhe njerëzorja e një shoqërie si Rusia, derisa aktualisht ajo është armiku numër një i tërë rruzullit. Derisa shoqëria ruse është filli i një shtjelle globale të dhunës së njeriut ndaj njeriut?

Nëse bota është në luftë, nëse agresioni i Rusisë në Ukrainë është një shtjellë katastrofe në botë, si mund të shkruhet, të lexohet e të ekspozohet një roman si ai “Ngjizja e papërlyeme” i Agron Tufës. Roman që flet për përzënie, dhunimin dhe vrasjen e qytetarëve rus në Shqipërinë e viteve gjashtëdhjetë. Një konflikt në vete, konflikt ndërmjet letërsisë dhe aktualitetit. Të çmosh njerëzinë, dhe fisnikërinë e grave ruse, të çmosh dashurinë e tyre të pathyeshme, derisa i tërë shteti rus në aktualitet ka nxitur një botë të tërë kundër vetes, me jo më pak se me masakra dhe krime kundër njerëzimit.

Letërsia nuk është lajm, as reagim, ajo është shpirti i pashkatërrueshëm i një kolektivi, i një historie dhe i një përvoje. Secilën herë që shfaqet në të dukshmen dhe në prezencën tonë, serioze dhe fill i shpirtërores, e pastër nga animet dhe nga konstelacionet shoqërore.

Derisa aktualja jonë është tërësisht e nxitur nga motivet personale dhe nga pazgjidhshmëria e marrëdhënies politike dhe materiale.

Nëse në romanin “Ngjizja e papërlyeme” jemi të përballur me mizorinë shqiptare ndaj femrës ruse, aq më shumë që ato kishin braktisur vendin e tyre për një jetë në Shqipëri, kjo na sjellë para një konflikti dhe kompleksi të pazgjidhshëm të trajtimit të këtij romani në këtë kohë, derisa vetë Rusia si shtet është duke e nxitur një shtjellë të pandalshme dhune dhe lufte globale. Autori Agron Tufa ka gdhendur një femininitet rus i cili përballon çdo mizori dhe dhunë e agresion ndaj saj, ndaj qenies së saj dhe ndaj vetë njerëzisë së saj. Kjo assesi nuk mund të merret si përballje e feminës ruse me aktualen ruse, kjo është paradoksale, derisa autori Tufa penetron, hulumton dhe gdhendë universalen e një gruaje e cila jo vetëm luftoi të dy frontet e hapura në atë kohë, ndërmjet Rusisë dhe Shqipërisë, por edhe ishte tërë ajo që është edhe sot, një shpirt që qënieson i padyshueshëm dhe i pandryshueshëm në kohë.

Tri gratë ruse, personazhe në këtë roman, “Ngjizja e papërlyeme”, Ljuba, Olja, dhe Zineida Mihajlllovna, në të vërtetë si krijesa jashtëtokësore në njerëzinë e tyre në një Shqipëri të dhunshme e të kurtuar në lojërat e spiunazhit nxisin çdo agresion dhe çdo sjellje të çmendur e të egër pikërisht ndaj tyre, dhe atë pikërisht nga aparati i sigurimit shtetëror shqiptar. Aq me mund e estetikë të hulumtuara dhe të gdhendura, ato arrijnë dhe ndërtojnë respektin e lexuesit dhe në të vërtetë varen në botën e marrë zjarr me tërë njerëzinë e tyre, dhe në të vërtetë mbeten krijesa (këtu me shumë respekt duke evituar nocionin njerëzor për to), duke qenë se kalojnë herë nga kufiri i të njerëzishmes në djallëzoren dhe herë të tjera nga kufiri i shpirtërores në njerëzoren praktike dhe të kontekstit ku ndodh ngjarja e romanit.

Kjo shpirtërore, motiv në roman dhe në përballjen e Ljubës, Oljas dhe Zineida Mihajlllovna me sigurimin shqiptar, është në të vërtetë epiqendra e një zone e cila kishte filluar të hapej në shoqërinë shqiptare me dyzimin e shoqërive ruse dhe shqiptare, por që në të vërtetë kaloi në gjah shtrigash për një kohë të shkurtë.

Dhe, është tërësisht interesante se si pikërisht në këtë kohë, pa asnjë paramendim,

“Ngjizja e papërlyeme”, roman nga Agron Tufa

NGJIZJA E PAPËRLYEME SI EPIQENDËR E NJË DHUNE KOLEKTIVE

Letërsia si zonë e shpirtërores njerëzore, përkundër shtjellës globale të dhunës bashkëkohore

Nga Ballsor Hoxha

ky roman shfaqet si rezonim shpirtëror në shoqërinë shqiptare përmes pikërisht një shtrese të damkosur njerëzore, e që është gruaja ruse në vitet gjashtëdhjetë në Shqipërinë komuniste. Kjo në të vërtetë është vetë çarja e njerëzores brenda kolektivit komunist shqiptar, çarja ndërmjet vetë njerëzores që ruan në tërë agoninë e përndjekjes dhe të dhunës ndaj njerëzores, dhe në anën tjetër përmbytjen e njerëzores në egërsinë e dhunës dhe të sigurimit.

Shkriftësia e dhunës në shoqërinë tonë Romani “Ngjizja e papërlyeme” ngjanë në një roman paradoksal i cili fillon nga aktualja e ngjarjes dhe krejtësisht si në elevacione të dhembjes/të vërtetës, dhe krejtësisht paradoksalisht hipë – thellohet në zona edhe më të rënda, më serioze dhe më të papërmbajtshme, për të rënë më thellë në kohë, e mbi të vërtetën e aktuales së romanit, dhe prapë duke krijuar lidhjen dhe tërë historinë e një dhunë të papërmbajtur dhe të egër ndaj njëri tjetrit.

Për ta bërë më të thjeshtë romani tri katër zona/faza të historisë së dhunës, jo vetëm

ndaj këtyre grave ruse, por edhe ndaj vetë shpirtërores në Shqipërinë komuniste:

1. shpëtimin e një filli të patretshëm, të pavdekshëm të shpirtërores, njerëzores – në aktualen tonë

2. hapjen e kutisë së Pandorës me fillimin e gjahut ndaj grave ruse – vetë shpërfaqjen e shpirtërores në vitet gjashtëdhjetë të Shqipërisë – historinë e këtij gjahu

3. përmbytjen e fatit shqiptar në një dhunë vicioze me masakrat e masave të tëra të shoqërisë shqiptare, dhe atë ndaj njëra tjetrës në fund të luftës së dytë botërore.

Por autori Tufa, për të zhvilluar tutje paradoksin, jo (vetëm) të ndonjë eksperimentimi teknik apo letrar, ndërton kanalet/tunele e ndërthurjes së kësaj dhune, këto tunele/zona duke u ndërthurur dhe duke mbirë mbi stratat e njëra tjetrës.

Dhe aq më shumë këto duke u dhënë nga izolimi i tmerrshëm i çdonjërit nga bartësit e kësaj tragjedie në vetminë e tyre, mbyllur po sikur Raskolnikov i Dostojevskit në tragjedinë e tyre, duke e kaluar ngjarjen e romanit në monologjet e tmerrshme të

njerëzve të zaptuar nga sigurimi shtetëror i Shqipërisë komuniste të viteve gjashtëdhjetë.

Në të vërtetë për sa u përmend Raskolnikov, duhet cekur se autori Tufa i bën respektin e duhur edhe Ana Kareninës së Tolstoit përmes romanit të parë brenda kësaj tetralogjie përmes izolimit të personazhes Ljuba në dhunën totale që hapet si krater i pafundësisë së të ligës njerëzore.

Sidoqoftë, duke u bartur nëpër këto zona, e tunele të historisë së dhunës shqiptare, jo më vetëm ndaj grave ruse, por të të gjithëve kundër të gjithëve, ne kalojmë tërë historinë e këtij rrethi vicioz i cili ka nxënë përfund një shoqëri të tërë nën masakrat e çnjerëzore e fundit të luftës së dytë botërore në Shqipëri.

Kalimet e Tufës si autor nëpër të gjitha stratat e historisë së kësaj dhune e deri në aktualitetin mizor të mbetjeve të relikëve dhe të vazhdimësisë së jetës janë mjeshtëri e rrallë e letërsisë shqipe, por të cilat edhe hapin pikërisht zonën e shpirtërores brenda shoqërisë sonë të cilën e cekëm në fillim të këtij punimi.

“Ngjizja”

Po të shohësh përmes strukturalet së ngjarjes bërthamë të këtij romani, ngjizja e një fëmije në barkun e një gruaje (pikërisht ruse) përmes ngrënies së një romani, më saktësisht përmes zierjes dhe ngrënies së një romani, në mënyrë periferike ngjanë me përrallën e Pinokios, epiqendër e romanit, për disa famëlartë dhe për disa famkeqe, është pikërisht dhuna, agresioni, e pamundshmja e çnjerëzores së këtij sigurimi (të shtetit të Shqipërisë), por mbi të gjitha është pandalshmëria, padyshueshmëria dhe pashkatërrueshmëria e shpirtërores së njeriut.

Në të vërtetë kjo mund të merret edhe si shpërfaqja metaforike e lindjes së një Jezusi të ri në një kataklizmë të re, moderne e gati se edhe bashkëkohore.

Me kujdes autori Tufa e përcjellë këtë ngjarje asnjëherë pa e bërë eksplozive dhe as parësore në narrativ, mirëpo gjithnjë duke e vazhduar qoftë mizorinë e qoftë mrekullinë e kësaj “ngjizje”.

“E papërlyemja”

Autori Tufa, pikërisht në kataklizmin e një shoqërie, në shkatërrimin shpirtëror, hedhë një bombë metaforike, e eksplodon pikërisht në duart e sigurimit të asaj periudhe, kështu përmes një paradoksi, të mospërlyemjes së një pamundësie të përlyej tërë atë dhunë e Sodomë e Gomorë të shoqërisë në të cilën ndodh ngjarja.

Përlxyhet i tërë sistemi, i dhunës e i partisë mëmë, përmes një pamundësie të mospërlyemjes në një kolektiv rrënjësisht të përlyer në gjakun e të vrarëve të saj, masakrave e të dhunës.

Andaj të dyja së bashku, - ngjizja -, dhe e - papërlyemja - si një drejtësi poetike përshkojnë një sistem të tërë nga një person i vetëm, personazhja grua ruse, Ljuba, e cila mohan çdo rrugë të përlyemjes për dashurinë e saj.

Është paradoks mjeshtëror, derisa sistemi, si ai i sigurimit dhe po ashtu ai shtetëror, në tërë armatën e tij dhe në tërë mobilizimin e tij kundër disa grave ruse, ngjizi papërlyer një fetus, që do të thotë një të ardhme megjithëse të zaptuar nën sigurimin e saj dhe tij, për të gjykuar dhe për të vërtetuar një luftë të vërtetë dhe pikërisht të papërlyer të një zone të hapur shpirtërore dhe njerëzore në shoqërinë shqiptare.

Sigurisht e tërë kjo duke konotuar me mitin apo të vërtetën biblike të Jezusit, dhe aq më shumë duke e dhënë explicit në shprehjen e njërit nga personazhet Samuil Ismarit, si përsëritje e historisë së njerëzimit, dhe atë pavarësisht dogmave, ritualeve e besimeve.

Në këtë konotim Tufa rithekson tërë historinë e njerëzimit, jo vetëm të dhunës së një shoqërie ndaj një komuniteti, por historinë e përsëritje e pandryshueshmërisë, pashkatërrueshmërisë, dhe të padyshueshmërisë së vazhdimësisë së rrugës së njerëzimit, pandryshueshmërisë së fatit të njerëzimit.



“Fjalori i veprës së Fishtës”, me autor Frano Kullin, një tjetër vepër serioze që i shtohet skedarit të leksikografisë të së ashtuqejtunës “Biblioteka e Letrave Shqipe”, sjell edhe një vlerë të re e të çmueshme në thesarin e shqipes, sidomos me një lëndë të saj të “harruar”, a më saktë të nxjerrë përdhunshëm e të tretur qëllimshëm në skutat e harresës. Është e njohur e gjithëpranuar se vepra e At Gjergj Fishtës, ngrerthen brenda vetes një pasuni të pashtershme gjuhësore, me një larmi trajtash e formash, që i kanë dhënë posë të tjerash edhe profilin e epërm letrar e dominues për së paku katër dekada, autorit. E njohur dhe e pohuar tashmë kjo e dhënë, ç’ka përbën edhe veçorinë e spikatur të korpusit të veprës së autorit shënon një sipërmarrje jo të lehtë, medjë (madje) të guximshme siç është hartimi i një fjalori të saj. Në përgjithësi, fjalorët e veprës së autorëve të traditës letrare, janë një kontribut i vlerë dhe i spikatur për gjuhën shqipe. Për më tepër fjalori i veprës së një autori të një formati si Fishta sidomos, me një pasuri e larushi leksikore, të dallueshme i vendosun në “kryet e vendit” të bashkëkohësisë së vet. Megjithatë, mendoj se Frano Kulli ia ka dalë me sukses një pune të tillë të mundimshme, gërmuese e hulumtuese, në radhë të parë, por edhe të parashtruar, në respekt të rregullave të mirëfillta akademike, duke na dhanë kështu një vepër të parametrave të kënaqshëm shkencorë. Dhe po aq, një fjalor doracak lehtësisht të përdorshëm. Fjalori na jep informacionin e duhur për secilën fjalë a shprehje, kuptimësinë në përdorimin e sotëm, në një a më shumë forma të saj, por sjell për secilën fjalë a shprehje edhe veprën në të cilën ajo fjalë a shprehje gjindet, apo kontekstin në të cilin është përfshi e kuptimin që merr në vargje. E për më tej, në përmbushje të kësaj kërkese sillen si shërbesë ilustruese edhe shprehje apo idioma që e permbajnë atë fjalë.

Natyrisht qëllimi kryesor i autorit të këtij fjalori, siç ai vetë e pohon që në krye të herës është rivendosja e urave të komunikimit midis lexuesit dhe veprës së Poetit Kombëtar, nevojë kjo që evidentohet që në parathanimin e tij ku shprehet: **“Shkëputja e gjatë shkrimtar-lexues, padyshim që ka krijuar një përthyerje, në mos te kuptimi, te shijimi i veprës së Fishtës”.**

Por, më përtej kësaj, Kulli ka zgjedhur të ndërtojë një fjalor, brenda të gjitha rregullave leksikore, siç do ta kërkonte një punë profesionale e akademike, pavarsisht vështirësive të reja që dalin në këtë drejtim. Shumë idioma apo vargje të tana të Fishtës, asht ma e lehtë me i shpjegue të plota, ashtu siç bahet rëndom në botimin e veprave poetike të Tij; por autori i këtij fjalori ka zgjedhë rrugën tjetër ma të vështirë, atë që asht edhe më e kodifikuara shkencërisht, në të njejtën kohë, duke na zberthyer fjalën në fillim dhe pastaj duke na e ilustrue atë me shembujt e përdorimit të saj në tekstin letrar. Për shembull: para se me shpjegue vargun: **“ia lnuren zemren”**, Franoja në fillim shpjegon foljen **“lnur”** dhe pastaj e paraqet vargun e masiperm si një figuracion, por e shpjegon edhe atë e kuptimin shprehimor. Në këtë kontekst, ky fjalor, përveçse një çelës për leximin e Fishtës, asht edhe një veper studimore, e konceptueme me qartsi e synim akademik.

Në fakt, nisima për të hartuar një fjalor të veprës së Fishtës ka pasë edhe mjaft ma heret. Është ajo e Benedikt Demës, që në vitin 1941 me **“Fjalori i fjalëve të rralla shqipe e i fjalëve të hueja të përdoruna në veprën e At Gjergj Fishtës “Lahuta e e Malcis”**, më vonë ajo e Tahir Kolgjinut, me **“Shpalime rreth Lahutës”**, Istanbul 1969. Sikurse, autori ikurse, autori çmon edhe punën e bërë nga Tonin Çobani, Ndue Zef Toma, Tefë Topalli, Stefan Çapaliku e Hamit Boriçi me fjalësin shpjegues, të veprës së plotë të Fishtës, përgatitur nën redaksinë e tyre

FJALORI FISHTJANI I FRANO KULLIT

Nga Ernest Marku

dhe botuar nga **“Enti Botues Gjergj Fishta”**. Kurse Profesor Topalli, sipas tij, ka ofruar edhe një kontribut të veçantë në hartimin e këtij fjalori, si specialist i spikatur gjuhe, me punën e kujdesshme redaktoriale që ka ba. Por, përtej kësaj sa më sipër, **“ena”** leksikore e fjalorit ka mbrenda edhe **“të vjelat”** nga burime të tjera fishtjane, përpösë korpusit të plotë të veprës letrare. Në fjalor zënë vend edhe një numër jo i paktë fjalësh e fjalëforma, që janë vjelë nga letërkëmbimi i Fishtës, të cilat nuk gjinden në veprën letrare. Porse janë sjellë edhe një buqetë fjalësh nga fusha e arkitekturës, gjithashtu, hulumtuar nga dorëshkrime arkivore të Fishtës, duke synuar kështu në një vjelje sa më shterruese të gjithë asaj lënde-thesar për gjuhën shqipe. E gjitha kjo kerkon një punë të mundimshme filtruese, investiguese dhe konverguese, të cilen Franoja e ka perballue me sukses. Vite ma parë, autori i këtij shkrimi, pati ndermarrë një punë për hartimin e një fjalësi, si një çelës për veprat e Fishtës, Camajt, Koliqit dhe e korifejve të tjerë të letersisë gege të shekullit XX, tue tentue me rrujtë e me sjellë në kujtesë, mjaft fjalë e shprehje që po rrezikojnë të humbin; por i gjithi ky arsenal fjalësh e shprehjesh, mbeti pa u kornizue brenda rregullave të leksikografisë dhe metodave të trajtimit etimologjik të një fjalori të mirëfilltë. E solla këtë shembull, per me tregue vleren e punës së autorit Kulli, me këtë veper dinjitoze, me t’cilen ai e ka pasunue biblioteken e admiruesve e lexuesve të veprave të Fishtës në veçanti, si dhe të letersisë gege në përgjithsi. Kudo qofshin, jo vetëm në veri, po edhe në jug të Shqipërisë e kudo ku janë dashamirë të leximit të saj, përreth nesh e në diasporë, që në respekt të së vërtetës, do pohuar se nuk janë të paktë.

Natyrisht që, në konceptin e ndërtimit të këtij fjalori, janë të pashmangshme turqizmat, arabizmat e sllavizmat, po ashtu edhe fjalëforma autentike të fjalorit fishtjan

të huazueme nga latinishtja, italishtja, frengjishtja apo gjermanishtja. Fjalët me origjinë lindore apo si me thanë fjalët e huazueme nga popujt brenda Perandorisë Osmane, janë përdorë shpesh prej Fishtës, në zhargonin e kohës kur asht shkruue vepra; gja e cila asht pasë parasysh prej z. Kulli dhe asht respektue gjatë shpjegimit të tyne, sipas kontekstit. Neologjizmat e autorit të **“Lahutës së Malcis”**, apo edhe fjalë të tjera të fjalorit fishtjan, të cilat janë përdorë apo ngërthejnë kuptime të pashpjeguese ma parë; janë trajtue me kujdes nga ana e autorit të këtij fjalori, duke i shplalue mjaft mirë kuptimet e nenkuptimet, kontesktet e nentekstet; me një gjuhë të zhdervjellët interpretative, por edhe me ilustrime të larmishme nga teksti. Respekti që Frano Kulli ka ndaj paskajores dhe gjuhës gege në tanësi, e shtyn atë që, gjatë shpjegimit të foljeve me fjalë të fjalorit të sotëm, ai i vendos ato sërish në mënyrën paskajore. Por edhe për një arsye tjetër studimore, siç na e shpjegon autori: **“Foljet në paskajore, mënyra e të cilave në “standart” nuk e jep kuptimin që ka në fjali, shpjegohet po ashtu në paskajore. Shembull: nis me hjekë- nis me heqë, me dhanë shpirt, me i dalë shpirti.”**


Tue e shfletue këtë fjalor, ndeshesh me fjalë e shprehje që ta ka andja me qenë pjesë e të folmes s’perditshme, që do ta kishin pasurue e rivalizue gjuhën shqipe, në perballjen e saj me nderkalljen e fjalëve teknologjike apo t’atyne mediatike. Fenomen ky i gjithëpohuar si një shqetësim i madh që po e rruhd shqipen, krejt përkundër rrjedhës, që do të kishte nevojë të ndiqte cilado gjuhë, e vogël a e madhe. Po nuk është rendi i kësaj trajtuese në këto radhë. As qëllimi kryesor i autorit të këtij fjalori nuk ka qenë ky. Por të merresh me fjalorin fishtjan dhe t’mos e kesh këtë pritshmëri, asht e pamujtun. Një lexuesi të censhëm, a mundet mos me ia ndezullue leximin fjalë si: **i amshtë,**

animirë, ma ka anda, perbind, çukurmoj, gurroshin, gjakim, gjallon, knellet, ia kande, kacagjelas, kulihum, lazdrues, mbamendje, mirakande, mirgjendje, mungullojshin, prujshem, pamashtri, e patranshme, pretare, papajambajtas, ryset, qanderr, t’lemje, trupoj, e thukët zhgjanderr e plot e plot të tjera?

Padyshim që ky fjalor asht një hap i randsishem perpara në këtë terren linguistik, ku enigmat shtohen sa ma thellë që të futesh dhe ku nderkohë, rriten edhe mundësitë për me zbulue thesare të reja gjuhsore, si edhe per me rizbulue rrajët tona etno-kulturore të mbarsuna në këtë skelet të pavdekshem gjuhsor.

“Fjalorthi i emnave të njerëzve e vendeve, zanave, hyjnive e personazheve mitologjikë” që i bashkëngjitet fjalorit si shtojcë, asht një vlerë e shtueme e k’tij botimi. Emna zanash, perëndish pellazg-ilire, emna heronjsh të mitologjisë greke a romake, apo edhe personazhe të letersisë botnore, që nga latinët e helenët e deri te Dantja apo Shekspiri; kraher per kraher me emnat e herojve dhe të vendeve-arenë të ngjarjeve heroike, t’permenduna kryesisht në **“Lahuten e Malcis”**; vijne në këtë fjalor, t’shtjellueme me përgjegjësi studimore e kompetencë, por edhe me erudicion, fantazi e koherencë kontekstuale, duke qëmtuar deri thellë nentekstit fishtjan.

Në fakt, ky fjalor, ma shumë se sa **“Fjalori Vepres së Fishtës”**, siç e ka emnue autori; do ta quejsha edhe unë siç e pagëzoi profesori e akademiku i asociuar, Stefan Çapaliku, si Fjalori i Gjuhës Shqipe deri në gjallje të Fishtës. Me këtë percaktim, po duem me thanë se gjuha e Fishtës asht gjuha e popullit shqiptar, popull mes të cilit e per të cilin ai gjalloi e punoi; popull i cili i kuptoi, i shijoi dhe i mësoi permendësh vargjet e Tij, prej Shkodret e n’Gjirokaster. Ndoshta, ma shumë se bukuria e vargjeve, ma shumë se ndjenja e atdhedashunisë që ato ngjallën në shpirtin e shqiptarve; vlera ma e naltë e veprës së Fishtës, qendron te fakti se Ai shkroi e krijoi mjaft bukur shqip. Kater janë shtyllat mbi të cilat e shërbyen Rilindjen Kombtare, françeskanët me Fishtën në krye, por edhe jezuitët e Mjedës dhe plot patriotë të tjerë, nga Jugu në Veri: **“Gjuha, E Drejta Zakonore, Folklori dhe Prralla Shqipe”**. Në këtë kontekst duhet ta shohim veprën e françeskanve të papersëritshem të gjysës së parë të shekullit XX, në këtë qasje duhet ta njohim e ta vlersojmë Poetin tonë Kombtar, si dhe në këtë hulli kemi plot arsye ta mirëpresim daljen e këtij fjalori të Frano Kullit.



1

Në xhungël nuk duhet shkuar i pari.

2

Për këdo me durim për të pritur mbrëmjen, Stokholmi tregon përralla çdo mbrëmje.

3

Përbrenda Stokholmit molet nuk janë kurrë përtej kundërmimit të ujit. Zjarre bredhacake dhe glasa zogjsh, dridhjet e përhime të dritës mbi gjeometrinë kubike të valëve. Në Stokholm mbërrin udha e çelur gjithmonë diku larg kushedi se si.

4

Binatë mbijnë nga mali si gogozhelë. Përvijimet e tyre të nxira janë mbushur me dritën joshëse të të paarritshmes. Kështjella e princeshave syrgjyne, përgjysmë zhytur në qiell, ngjitet dhe një kat më lart.

5

Në Stokholm uji xixëllon nën ura; askush s'e di vërtet cili është i humburi.

6

Do lexuar si të ishim të vdekur tashmë. Çdo emër i përveçëm është dallim në tekst, asgjë më shumë: kaq pak prej gjësë bën fjalë për ne. Dhe të shkosh drejt qytetit me një vështrim aq të ngadaltë sa ai të shpopullohet.

7

Kënga e kullës më të lartë. Tani i shoh të gjitha nga dritarja dhe mund t'i dëgjoj si rënkojnë në erë: Këtu jam në këmbë duke pritur të bie. (Kujdes: po, është vërtet Rimbaud.)

8

Në ca ditë takoj vetëm të vdekur në Rugën e Rennes (Drottingatan), miq dhe kolegë të ndjerë prej shumë kohësh, ani pse kjo hiç s'më ngazëllen: kujtesa është më shqisore se vështrimi.

9

Sidomos kalimi nga Parlamenti është më i qashtër për fantazmat dhe shpirtrat e trazuar.

Poemë e pastrehë

Poemë në prozë nga

KRISTOFFER LEANDOER

Përktheu Besnik Mustafaj



10

Vjen një ditë kur çdonjëri jeton në një qytet fantazmë të vizatuar prej atij vetë.

11

Çdo qytet e sheh harabelin si zogun e vet, të pacipë e dinak, veç Stokholmit, ku harabeli është shpërfillur, i huaj në shtëpinë e vet, i përjashtuar nga zogjtë e tjerë më të mëdhenj të livadheve, pyjeve, që e kanë urinë më të madhe.

12

Jo, zogu tipik i Stokholmit është më fort laraska, gjithnjë në merak për ta zbukuruar e zmadhuar folenë e vet.

13

Një çast të shkurtër vala mëngjesore e metrosë bëhet njësh nga nxitimi i përbashkët, për një çast të shkurtër ne rrëmbehemi nga e njëjta dëshirë dhe nxitojmë në një krah. Për një çast të shkurtër ne më trembemi.

14

Në ca ditë, një jet – stream përmbi Stokholm është një jet – stream përmbi Stokholm. Në ditë të tjera, një pyetje: Ku?

15

Ka shkëmbime të fshehta mes qyteteve, pika ku ato merren vesh aq mirë ndër vete sa mbivendosen ose dyzohen.

16

Te këto kalime do pasur një kujdes i tejskajshëm.

17

Ai që humbet me tepri përqendrimin mund të zbresë nga një trotuar në Stokholm dhe të hipë në anën tjetër në Paris.

18

E kush do të donte që kjo të ndodhte?

19

Kam një hartë lagjeje ku këto vende janë shënuar, por nuk duhen ndjekur.

20

Asnjë qytet pa pemë. Asnjë qytet pa erë. Asnjë qytet pa brava dyersh që nuk mbyllen kurrë.

21

Domethënia e një qyteti shprehet në irealitetin e tij të afërt, përvijimet që ngjajnë të hapërdara në bisht të syrit. Stokholmi e ka shterruar aftësinë e vet bindëse dhe mban shpresë te mosbesimi qenësor i banorëve për të tjerrur një anti – qytet më së paku po aq realist.

22

Vetëm ne të pagjumët e dimë se, në fund të fundit, Stokholm është qytet i pabanuar.

23

Do parë me dyshim të madh përmbushja e ëndrrave të veta.

24

Çfarë prite ti që të ishte Stokholm? Aparat për të prodhuar kujtesa? Stokholm është një aparat për të prodhuar e venë në punë trazirën.

25

Çdo pasqyrë është një shpallje irealiteti, çdo pasqyrë uji është dhe më shumë se kaq, vështrimi i kapur në të i përket dikujt të mbytur tashmë: ne jemi çfarë uji sheh në ëndërr për ne.

26

Me këmbët mbi tokën e dystë nuk mund të kuptohet vërtet Stokholm.

27

Nata e verës është nja maskë që mund ta mbajë kushdo: unë jam më i lehtë se ajri dhe po aq i ndërkëmbshëm.

28

Kurrë s'ka jetuar njeri në Stokholm.

Hera e parë që kam parë flokëgjatë ka qenë në Pragë. Në hollin e hotelit ku rrija hynë dy djem të huaj, me flokë të gjatë deri në supe. Kaluan përmes hollit, mbërritën në një qoshe pak të mënjanuar dhe u ulën në një tryezë. Qëndruan të ulur aty për një gjysmë ore, të vëzhguar prej klientëve, mes të cilëve unë; pastaj ikën. Edhe kur kaluan përmes njerëzve të mbledhur në holl, edhe kur qenë të ulur në qoshen mënjanë, nuk folën (ndoshta - por nuk e kujtoj - pëshpëritën diçka mes tyre: por, mendoj, diçka krejt praktike, të pashprehshme).

Në fakt ata, në atë situatë të veçantë-që ishte krejt publike apo sociale dhe do të thosha, zyrtare- nuk kishin fare nevojë të flisnin. Heshtja e tyre ishte rreptësisht funksionale. Dhe ishte thjesht sepse fjala ishte e panevojshme. Ata të dy, në fakt, përdornin për të komunikuar me të pranishmit, me vëzhguesit- me vëllezërit e tyre të atij çastin- një gjuhë tjetër prej asaj që formohet me fjalë. Ajo që zëvendësonte gjuhën tradicionale me fjalë, duke e bërë të panevojshme- e për më tepër duke gjetur vendosjen e menjëhershme në zotërim të gjerë të "shenjave", pra të fushës së semiologjisë- ishte gjuha e flokëve të tyre.

Bëhej fjalë për të vetmen shenjë- pikërisht për gjatësinë e flokëve të tyre deri mbi supenë të cilët ishin përqendruar të gjitha shenjat e mundshme të një gjuhe të artikuluar. Cili ishte kuptimi i mesazhit të tyre të heshtur dhe vetëm fizik? Ishte ky: "Ne jemi dy flokëgjatë. I përkasim një kategorie të re njerëzore që po bën të shfaqet këto ditë në botë, që e ka qendrën e vet në Amerikë dhe që, në provincë (si për shembull- madje, sidomos- këtu në Pragë) nuk njihet. Pra ne jemi për ju një shfaqje. Ushtrime propagandim e doktrinës sonë, tashmë plot me një dituri që na përmbush e na dërmon tërësisht. Nuk kemi asgjë për t'i shtuar gojarisht apo me arsye asaj që fizikisht dhe në mënyrë ontologjike thonë flokët tanë.

Ditura që na mbush, edhe nëpërmjet propagandës sonë, do t'ju përkasë një ditë edhe juve. Tani për tani është një Gjë e Re, një Gjë e Re e madhe, që krijon në botë, me skandalin, një pritshmëri: e cila nuk do të tradhtohet. Borgjezët bëjnë mirë që na shikojnë me urrejtje dhe tmerr, sepse është gjatësia e flokëve tanë që i kundërshton në mënyrë absolute. Por të mos na marrin për njerëz të paedukatë e të egër: ne jemi shumë të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë. Ne nuk ju shikojmë, rrimë në punën tonë. Bëni kështu edhe ju, dhe pritni Ndodhitë." Unë isha marrës i këtij komunikimi, por qeshë edhe në gjendje ta deshifroja menjëherë: ajo gjuhë pa leksik, pa gramatikë, pa sintaksë, mund të kuptohej menjëherë, edhe sepse duke u folur në mënyrë semiologjike, nuk ishte tjetër veçse një formë e asaj "gjuhës së prezencës fizike" që gjithmonë njerëzit janë në gjendje ta përdorin. Kuptova; dhe ndjeva menjëherë një antipati për ata të dy. Pastaj m'u desh ta kapërdija antipatinë dhe t'i mbroja flokëgjatët nga sulmet e policisë e të fashistëve: qeshë, natyrisht, për shkak të parimit, në anën e Living Theatre, të Beats etj.; dhe parimi që më bënte të isha në anën e tyre ishte një parim thellësisht demokratik.

Flokëgjatët u shumuan mjaft- si të krishterët e parë: por vazhdonin në mënyrë misterioze të ishin të heshtur; flokët e gjatë ishin gjuha e tyre e vetme dhe e vërtetë dhe pak u interesonte të arrinin gjë tjetër. E folura e tyre përkonte me qenien e tyre. Pashprehshmëria ishte ars retorica (oratoria) e protestës së tyre. Çfarë thoshin, me gjuhën e pa artikuluar, të qëndrueshme në shenjën monolite të flokëve, flokëgjatët e viteve '66 - '67? Thoshin këtë: "Qytetërimi konsumist na është neveritur. Ne protestojmë në mënyrë radikale. Po krijojmë një antikorp për këtë lloj qytetërimi përmes kundërshtimit. Duke sikur gjithçka shkonte mirë, apo jo? A duhej të ishte brezi ynë një brez i plotësuar? Përkundrazi, ja si janë gjërat në realitet. Ne i kundërvëmë marrëzinë një prapësie të "ekzekutuesve".

Po krijojmë vlera të reja fetare në entropinë borgjeze, pikërisht në momentin kur po bëhet tërësisht laike dhe hedoniste. E bëjmë me një bujë dhe një dhunë revolucionare (dhunë e të pa-dhunshme!) sepse kritika jonë ndaj shoqërisë sonë është totale dhe e pandryshueshme." Po të pyeteshin sipas

Kundër flokëve të gjatë

Pier Paolo PASOLINI

Përktheu: Zija Vukaj

sistemit tradicional të gjuhës së folur, nuk e besoj se ata do të ishin në gjendje ta shprehnin në mënyrë kaq të artikuluar tezën e flokëve të tyre: fakti është se në thelb këtë donin të shprehnin.

Për sa më përket mua, edhe pse dyshoja deri atëherë se "sistemi i tyre i shenjave" ishte produkt i një nënkulture proteste që i kundërvihet një nënkulture të pushtetit dhe që revolucioni i tyre jo marksist ishte i dyshimtë, vazhdova për një periudhë të isha në anën e tyre, duke u mbështetur të paktën në elementin anarkist të ideologjisë sime. Gjuha e atyre flokëve, edhe pse e pashprehshme, shprehte "gjëra" të së Majtës. Madje të së Majtës së Re, të lindur brenda universitetit borgjez (në një dialektikë të krijuar ndoshta në mënyrë artificiale nga ajo Mendje që rregullon, përjashta ndërgjegjes së Pushteteve të veçanta e historike, fatin e Borgjezisë).

Erdhi 1968. Flokëgjatët qenë thithur nga Lëvizja Studentore; u valëvitën me flamuj të kuq mbi barrikada. Gjuha e tyre shprehte gjithnjë e më shumë "gjëra" të së Majtës. (Çe Gevara ishte flokëgjatë etj.) Në 1969- me tragjedinë e Milanos, Mafien, emisarët e kolonelëve grekë, bashkëpunimin në krim të Ministrave, komplotin e zi, provokatorët-flokëgjatët ishin tepër të përhapur: edhe pse nuk ishin akoma në shumicë numerike, kishin marrë një peshë të madhe ideologjike.


Tani flokëgjatët nuk ishin më të heshtur: nuk ia delegonin më sistemit shenjues të flokëve të tyre të gjithë kapacitetin komunikues dhe shprehës. Përkundrazi, prania fizike e flokëve, në njëfarë mënyre, ishte katandisur në funksion dallues. Ishte kthyer në funksion përdorimi tradicional i gjuhës verbale. Dhe nuk them verbale rastësisht. Madje e nënvizoj. Kaq është folur nga '68 në '70, kaq shumë, sa për një periudhë i është

nxjerrë fundi verbalizmit; dhe verbalizmi ka qenë ars retorica e re e revolucionit (goshizmi, sëmundja verbale e marksizmit!)

Edhe pse flokët- të përthithur në furinë verbalenuk u flisnin më në mënyrë të pavarur marrësve të hutuar, prapëseprapë unë gjeja forcën ta mprehja kapacitetin e deshifimit dhe në rrapëllimë, u përpoqa t'i kushtohesha dëgjimit të diskutimit të heshtur, të pandërprerë, të atyre flokëve gjithnjë e më të gjatë. Çfarë thoshin ata, tani? Thoshin: "Po, është e vërtetë, themi gjëra të së Majtës; kuptimi ynë- edhe pse pastërtisht përkrahës i kuptimit të mesazheve verbale- është një kuptim i së Majtës... Por... Por..." Diskutimi i flokëve të gjatë ndalonte këtu: duhej ta plotësoja vetë.

Me atë "por" ata donin të thoshin qartë dy gjëra: 1) "Pashprehshmëria jonë shfaqet gjithnjë e më shumë e natyrës iracionale dhe pragmatiste: epërsia që ne i veshim në heshtje veprimit është e karakterit nënkulturor dhe prandaj në thelb është e djathtë". 2) Ne kemi qenë të parapëlqyer edhe nga provokatorët fashistë, që u përzihen revolucioneve verbale (por verbalizmi mund të çojë edhe në veprim, sidomos kur e mitizon): dhe krijojmë një maskë të përsosur, jo vetëm në pikëpamjen e aspektit fizik- rrjedhja dhe valëzimi ynë i çrregullt priret t'i bëjë homologe të gjitha fytyrat- por edhe në pikëpamjen kulturore: në fakt një nënkulturë e së Djathtës mund të ngatërrohet shumë bukur me një nënkulturë të së Majtës".

Shkurt kuptova se gjuha e flokëve të gjatë nuk shprehte më "gjëra" të së Majtës, por shprehte çdo keqkuptim e Majtë- e Djathtë, që bënte të mundur prezencën e provokatorëve. Para nja dhjetë viteve, mendoja, ndër ne të brezit të mëparshëm, një provokator ishte gati i pakonceptueshëm (veç nëse ishte një aktor i madh): në fakt nënkultura e tij do të dallohej, edhe fizikisht, nga kultura jonë. Do



ta njihnim nga sytë, nga hunda, nga flokët! Do ta demaskonim menjëherë dhe do t'i jepnim menjëherë mësimin që meritonte. Tani kjo nuk është e mundur. Askush më në botë nuk mund të dallojë një revolucionar nga një provokator. E Djathta dhe e Majta janë shkiritë fizikisht. Kemi arritur në 1972. Isha këtë shtator në qytetë Isfahan, në zemër Persisë. Vend në zhvillim, siç thuhet në mënyrë të tmerrshme, por po aq të tmerrshme thuhet, në ngritje të plotë. Mbi Isfahanin e dhjetë viteve më parë- një nga qytetet më të bukura të botës, kushedi, ndoshta më i bukur- ka lindur një Isfahan i ri, modern e shumë i shëmtuar. Por nëpër rrugët e tij, për punë apo për shëtitje, rreth darkës shihen të rinjtë që shiheshin në Itali para dhjetë vitesh: bij dinjtozë dhe të përlulur, me qafat e bukura dhe fytyrat e bukura e të kthjellëta nën cullufet e pafajshme krenare. Dhe ja që një mbrëmje, duke filluar nga rruga kryesore, pashë mes gjithë atyre të rinjve të hershëm, shumë të bukur e plot dinjitet të hershëm njerëzor, dy qenie të përbindshme: Nuk ishin tamam nga flokëgjatët, por flokët e tyre ishin prerë evropiançe, të gjatë mbrapa, të shkurtër mbi ballë, të rriposur nga tërheqja, me dy cullufe të ndyra, ngjitur në mënyrë artificiale përreth fytyrës sipër veshëve. Çfarë thoshin këta flokët e tyre? Thoshin: "Ne nuk i përkasim numrit të këtyre njerëzve të uritur, të këtyre mjeranëve të pazhvilluar, që kanë mbetur prapa në kohët barbare! Ne jemi punonjës banke, studentë, bij të njerëzve të pasuruar që punojnë në shoqëritë e naftës; e njohim Evropën, kemi lexuar. Ne jemi borgjezë: dhe ja, flokët tanë të gjatë, që dëshmojnë modernizmin tonë internacional prej të privilegjuarish!" Pra ata flokë të gjatë aludonin "gjëra" të së Djathtës. Rrethi është mbyllur. Nënkultura në fuqi ka thithur nënkulturën në opozitë. Me shkathtësinë djallëzore e ka bërë atë me durim një modë, që nëse nuk mund të thuhet tamam fashiste në kuptimin klasik të fjalës, në fakt është një "ekstrem i djathtë" real. Përfundoj me hidhërim. Maskat e neveritshme që të rinjtë vënë në fytyrë, duke u bërë të ndyrë si kurvat e vjetra të një ikonografie të pathemeltë, rikrijojnë objektivisht mbi fizionomitë e tyre atë që vetë ata e kanë dënuar gjithmonë me fjalë. Kanë dalë fytyra të vjetra priftërinjsh, gjykatësisht, zyrtarësh, anarkistësh të rremë, punonjës qesharakë, avokatë ngatërrestarë (Axekagbulë), Don Ferrante, mercenarë, batakcinj, konformistë rrugaçë. Pra dënimi radikal dhe pa dallim që ata kanë shpallur kundër baballarëve të tyre- që janë historia në evolucion dhe kultura e mëparshme- duke ngritur kundër tyre një barrierë të pakapërcyeshme, ka përfunduar me izolim, duke u penguar atyre një raport dialektik me baballarët e tyre. Tani, vetëm përmes një raporti të tillë dialektik- qoftë edhe dramatik dhe i ekstremizuar- ata do të mund të kishin ndërgjegjen reale historike të vetvetes dhe të shkonin përpara, "t'i kapërcenin" baballarët. Përkundrazi, izolimi në të cilin janë mbyllur- si në një botë mënjanë, në një geto të rezervuar për rininë- i ka mbajtur të ndaluar në realitetin e tyre të pamposhtshëm historik: dhe kjo ka përfshirë- në mënyrë fatale- një regres. Në realitet ata kanë shkuar më prapa se baballarët e tyre, duke shkaktuar në shpirtin e tyre tmerr dhe konformizma dhe në pamjen e tyre fizike rregulla të ngurta e mjerime që duke se ishin kapërcyer përgjithmonë. Kështu thonë tani flokët e gjatë, në gjuhën e tyre të pa artikuluar e të xhindosur të shenjave joverbale, në ikonizmin e tyre banditesk, në "gjërat" e televizionit apo të reklamave të produkteve, ku tashmë është e pakonceptueshme të parashikosh një të ri që të mos ketë flokë të gjatë: fakt që sot do të ishte skandaloz për pushtetin. Ndjej një pakënaqësi të singertë e të pafund të them (madje, një dëshpërim të vërtetë): por tashmë mijëra e qindra mijëra fytyra të rinjsh italianë, i ngjasojnë gjithnjë e më shumë fytyrës së Merlini. Liria e tyre për t'i mbajtur flokët siç duan, nuk është më e mbrojtur, sepse nuk është më liri. Ka ardhur çasti t'u thuhet të rinjve se mënyra e tyre e mbajtjes së flokëve është e tmerrshme, sepse është skllavëruese dhe vulgare. Madje, ka ardhur çasti që ata vetë ta vënë re dhe të çlirohen nga ky ankthi i tyre fajtor për t'iu përmbajtur rregullit degradues të hordhisë.

Banksy, *Dashuria është në ajër*, 2006

ABSURDITETI I LUFTËS: "DASHURIA ËSHTË NË AJËR" E BANSKY-T

Nga Sotheby's

Dashuria është në ajër është një pikurë tipike e Banksy-t. Imazhi i një militanti të maskuar gati për të hedhur një buqetë me lule është bërë sinonim me stilin e pashlyeshëm të artistit. Një nga veprat në kanavacë më të lakmuara të Banksy-t, është një shembull arketip i përdorimit të humorit të errët të artistit, satirës dhe perspektivës së tij, komenteve stimuluuese për ngjarjet bashkëkohore politike dhe shoqërore. Vepra e ndan titullin e saj me këngën hit të 1978 nga John Paul Young, emblematike e mençurisë së Banksy-t dhe shprehës i mesazhit pozitiv të veprës. Hedhësi ikonik i lules është bërë një mesazh i fuqishëm që shpreh absurditetin e luftës dhe zërin advokues për paqe të artistit.

Në përsëritjen e tij origjinale guerile në West Bank Barrier, *Dashuria është në ajër* dëshmon aftësinë unike të Banksy-t për të aktivizuar mjediset urbane dhe arkitekturën publike në një mënyrë që i superfuqizon mesazhet e tij, duke u dhënë imazheve një menjëhershëri përvëluese e cila zgjerohet përtej atyre që jetojnë aty apo vizitojnë rajonin, duke kundërvënë gjestin aktiv të protestës me simbolin pajtues të buqetës me lule. Imazhi ka ilustruar ballinën e monografisë së 2005 të Banksy-t *Wall and piece*, dhe brenda librit ishte

shoqëruar me një pasazh mbi rënien e regjimit të President Çausheku të Rumanisë, treguar nga John Simpson për BBC News.

Banksy është i njohur për artin e rrugës goditës, ironik dhe imazhet pacifiste. Kundërshtimi i militarizmit dhe luftës janë temat kyçe që eksplorojnë përgjatë veprës së tij, duke kundërvënë simbole të paqes me imazhe të dhunës për të shkundur shikuesin nga vetëkënaqësia. Kjo mund të vihet re në shumë vepra grafiti të artistit, sidomos ato të realizuara në fillimet e viteve 2000, nga imazhi i Mona Lizës që mban një hedhëse rakete e cila u shfaq në një mur në Soho në 2001, te vajza e vogël që përkund një predhë në ikoniken *Bomb Hugger* të Banksy-t, dhe protagonistët e *Pulp Fiction* që përdorin banane. Sentimenti anti-luftë i *Dashuria është në ajër* përbëhet nga jehonat vizuale të veprës prej lëvizjes, fuqia e lules dhe protestave të studentëve që zunë vend në Francë dhe Amerikë në vitet '60. Subjekti rinor që hedh lule si armë na kujton fotografinë e famshme të 1967 të një protestuesi të ri që vendos lule në tytën e pushkës të drejtuar në kokën e tij gjatë demonstratës anti-luftë. Me këtë imazh tashmë ikonik, Banksy na ofron një mesazh universal: duhet të shfrytëzojmë virtytet e paqes

“Më pëlqen të mendoj se kam guximin të ngrihem anonimisht në një demokraci perëndimore dhe të bëj thirrje për gjëra tek të cilat askush nuk ka besim – si paqe dhe drejtësi dhe liri.”

BANKSY, 'WALL AND PIECE', fq. 24

për të mposhtur ndarjen dhe konfliktin që na rrethon dhe të shohim përpara drejt një të ardhmeje shpresëplotë.

Imazhi i *Dashuria është në ajër* u shfaq fillimisht në anë të një garazhi në Beit Sahour, një qytet Palestinian në lindje të Bethlehemit, pranë murit 708 kilometra që ndan Izraelin nga territoret West Bank të Palestinës. Banksy ka realizuar një numër veprash grafiti në mur pak pas ndërtimit të tij në 2002, duke shprehur padrejtësinë sociale e politike dhe efektet e terrorizmit dhe militarizmit. Banksy ka qenë shumë prodhimtar dhe aktiv në rajon, duke e dedikuar misionin e tij për të theksuar militarizmin dhe ndarjen e shkaktuar nga konflikti Izrael-Palestinë. Shumë vepra nga artisti janë shfaqur në Gaza dhe West Bank që në mes të viteve 2000, dhe në 2017, Banksy hapi The Walled

Off Hotel përgjatë Murit Ndarës në Bethlehem, duke e faturuar atë si “hoteli me pamjen më të keqe në botë”.

Lulet rrezatuese të pikturuara me dorë të *Dashuria është në ajër* janë një veçori unike që rrallë shihet në veprën e Banksy-t. Përfaqëson një kontrast mes butësisë së luleve të pikturuara me delikatesë dhe mprehtësisë të figurës së militantit të pikturuar me spraj, duke na kujtuar dorën e artistit në procesin thujse-mekanik të krijimit të imazheve shabllon. Përdorimi i shablloneve dhe sprajit evokon lidhjen e grafitit me lëvizjet e fshehta politike dhe kulturën punk, dhe përdorimin e tij në aktivizmin bazë.

Realizuar më 2006, *Dashuria është në ajër* u krijua pas kalimit të Banksy-t në serinë e pikturave në vaj të vandalizuara, *Crude Oil: A Gallery of Re-mixed Masterpieces, Vandalism and Vermin* (2005), një largim nga ndërhyrjet në rrugë dhe grafitet arketipike duke përdorur bojë spraj dhe shabllone. Në *Dashuria është në ajër*, Banksy përdor dhe bojëra vaji dhe bojë spraj në të njëjtin imazh, duke e bërë një nga punimet në kanavacë më të dashura të artistit.

Me vepra si *Dashuria është në ajër*, Banksy bashkohet me një brez të rëndësishëm artistësh të cilët e kanë përdorur artin e tyre për të komentuar çështje politike dhe problemet sociale, nga *Liria udhëheq popullin* të Eugène Delacroix, e krijuar pas Revolucionit të Korrikut të 1830, si simbol për lirinë dhe demokracinë; te përdorimi i shablloneve nga Andy Warhol për të përmbysur imazhe shpesh shumë politike nga kultura popullore, siç shihet te *Race Riot* në 1964; dhe shumë artistë të cilët kanë dalë në rrugë për të shpërndarë mesazhin e tyre që ta shohë bota. Imazhi i *Dashuria është në ajër* është përsëritur dhe riprodhuar shpesh në kulturën popullore, duke e bërë këtë vepër një shembull të rëndësishëm e shumë të kërkuar nga krijimtaria bindëse dhe provokuese-mendimesh e artistit të shquar të rrugës. Sot, mesazhi i rëndësishëm i *Dashuria është në ajër* mbetet po aq aktual si gjithmonë.

Përktheu: Enxhi Hudhri



Banksy, Londër 2003

Rastësia objektive më njohu me Vassiliki Raptin në një mënyrë krejt të pazakontë. Nuk ishte bulevard operash apo teatros parizianë, por thjesht një “happenings” i ditëve të sotme moderne, me ngjyrimet rastësore komunikuese. “Transitorium” i Vassiliki Raptit, pedagoge e Letërsisë Moderne Greke në Departamentin e Studimeve Klasike në Universitetin e Harvardit që prej 2008, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Maklena Nika, Botimet Aleph. Është një përmbledhje me poezi e botuar për herë të parë në gjuhën greke dhe angleze nga Shtëpia Botuese Somerset Hall Press, Boston, SHBA, në vitin 2015.

Lakonike, e prerë, e saktë dhe e qartë në mendim apo provokim, moderne dhe e lashtë njëkohësisht, tragjike dhe e dhimbshme deri në kufijtë ekstremë të ndjenjës, e ndjeshme për ngjarje të jetës dhe e pamëshirshme për të pranuar fundin e tyre, e ëmbël dhe e hidhët në përzgjedhje imazhesh dhe ndjesish, Vassiliki Rapti na fton në botën e magjishme të “Transitorium” për të zbuluar dalëngadalë kiminë e trupave dhe të shpirtërave, për t’u ndjerë sa afër dhe larg me të, për të parë trillet e ditës dhe të natës së saj poetike, për të shijuar disi ndryshe, me një erëzim portokalli apo trumze, Safon, Nikos Eggonopoulos, Jorgos Seferisin, për të perceptuar lirinë e shkrimit dhe përjetësinë e magjisë së artit, për të ironizuar jetën tonë mediokre, pa i dhënë shumë rëndësi dhe thjesht duke mermëritur “E çfarë pastaj...?”, fatalisht për të prerë me gërshërë fatin tonë të mjerë nga e përditshmja, dhe pse jo, për të gjuajtur me gurë diellin që përcëllon trupat tanë, por edhe shpirtërat tanë, kur shndrit aq fort nga lart.

Magjia fonetike që ajo krijon me lojërat e fjalëve dhe muzika e brendshme, herë funebër e herë plot ngjyra romantike vagneriane, ishin një sfidë e vërtetë për përkthimin e poezive në gjuhën shqipe. Sikurse shprehet edhe Besnik Mustafaj në parathënien e librit “Vatrat nguruese të dritës së Vassiliki Raptit”{...poetja ka zgjedhur të na pasqyrojë një jetë të ndërmjetme, të përkohshme, pa rrënjë, e cila sigurisht që ka ankthet e veta të mëdha, dilemat e veta ekzistenciale, dëshpërimin e vet pse dashuria nuk mund të ketë vazhdim pikërisht sepse është një jetë e përkohshme, pa aftësinë për të ngjizur brenda vetes iluzionin e përjetësisë, qoftë ky iluzion edhe si vdekje. Kjo do të ishte qasja paraprake e lexuesit, përgatitja e tij e natyrshme mendore për të hyrë në këtë transitorium. Madje, duket sikur edhe vetë poetja ka ndonjëherë ngasjen ta shtyjë përfytyrimin e lexuesit në këtë drejtim...}. Ndërsa Vrasidas Karalis, profesor në Universitetin Sidney, Australi shprehet se poezitë e Vassiliki Raptit janë të ngjeshura, precize, të matura, plot polivalencë semantike, hartojnë një realitet të ri emocional për lexuesin e tyre, duke gërshetuar gjendje emocionale, atmosfera dhe ndjeshmëri. Lexuesit depërton në një univers emocionesh paradoksalë, të cilat prezantojnë një realitet të qenies njerëzore pa siguri të historisë apo iluzionet e besimit. Këto janë poezi të ndjeshmërisë ekstreme, në kufijtë ekstremë të gjuhës dhe të heshtjes, ku brenga dhe euforia bashkëzistojnë dhe forcojnë njëra-tjetrën.

ENË KOMUNIKIMI ME VASSILIKI RAPTIN

Nga Prof.ass.dr. Maklena Nika

Gur

Dashuri e gurtë
përndryshe si?

Gjuajtje me gurë
Kurthe
Kthesa.

Deri sa
Lëfyti i trurit u pengua dhe ra mbi zall.

Të ngurta këto kohë
Sflitje gjithkund
Të thatë muret
Për përqaftime s’ka kohë!

Vetëm thëngjij
Dhe dy pika shi
Çaj në gurin.

Gjuhë të bronza

Për Antigoni Kefalanë

Gjuhë të bronza
në vend të boshësisë ose
të fytyrave të brengosura.
Drita sipërfaqësore
që me inat ndriçojnë
ndonjë rrënojë të mërziqshme
të Errësirës së madhe.
Natë e ethshme
mes disa dallgëve
të një dridhjeje prehistorike.
Një lot i argjenduar
Nga gurrat mbrojtëse
të statujave prej alabastri
“që i kishin shndërruar
në lugore prej balte
për perënditë”.

Fatale

Larg, edhe më larg
Fitili ngadalë po shuhet
Vështrim i turbullt
Flakëz e shuar
“Che fece ... Il gran rifiuto”
Si një mace e egër që i druhet
Rrënimt?
Hiri e mbështjell
Dhe bëhet mumje

Fati
Im
I heshtur

4 Stinët

Shpresoja

Vera e bukur
do të shpërthente
do të ziente
do të përflakte
nyjëzimet
e ngurimeve.


Vjeshta e gështenjtë
do të varroste në vetvete
acidet e trishtimit
dhjamërat e dhimbjes
thatësisën e mundimit.

E bardha dimërore
do të ngjyroste sytë
e panginjur
të tejdukshëm
të mesoburrave
mendjelehtë
që përndjekin
të shkuarën.

E gjelbra e Viktorias
do të hapte
dritaret e harresës
së skajshme
dhe do të sillte mbrapsht
nostalgjikët e fundit
të fyeje
të braktisur.

Shpresoja

Mos!
Se mos!
E thyer
E trishtë / e varrtë.





Cézanne, Gratë që bëjnë banjë

GRATË QË BËJNË BANJË

Dr. Bledar Kurti

Cézanne është babai i të gjithëve prej nesh” u shpreh Pablo Picasso, teksa fliste në emër të gjithë artistëve modernë. Por, jo vetëm piktorë, edhe shkrimtarë të shquar si Ernest Hemingway shprehën vlerësimin më të madh për Paul Cézanne duke u shprehur se ishte Cézanne ai që e kishte mësuar atë se si të ndërtonte peizazhet e tij foljore. “Të shkruash mirë,” ankohej Hemingway, është po aq e vështirë sa të pikturosh një tablo të Cézanne.”

Paul Cézanne (1839-1906) ishte artisti që shërbeu si një urë lidhëse midis shekullit të 19-të dhe atij të 20-të. I njohur si babai i artit modern, nuk ka “izëm” që i përshtatet artit të tij: ai nuk i përkiste impresionizmit edhe pse ishte i atij brezi, dhe ai nuk i përkiste as modernizmit, sado që kubistët u frymëzuan prej tij. Madhështia e artit të Cézanne është se është i pa-kategorizueshëm ndërkohë që transmeton një qartësi formash figurative, një thjeshtësi të natyrshme, dhe shpalos një çlodhje pamore dhe mendore.

Vepra *Gratë që Bëjnë Banjë* (1905), më e njohura ndër veprat e tij, përshkruan një skenë të çuditshme por të mrekullueshme. Tabloja është vaj në kanavacë ndonëse duket sikur është pikturuar me akuarel. Në të mbizotërojnë bluja, okra dhe jeshilja. Figurat femërore nudo dominojnë tablonë dhe skena zhvillohet në një breg lumi në fshat. Ishte në modë në Francën në fund të shekullit të 19-të që njerëzit të bënin banjë në lumenj, apo edhe vizitorë të ndryshëm nga qytetet të

shkonin për piknik e laheshin në zonat rurale, duke lënë pas jetën e ngarkuar apo mjedisin e ndotur për shkak të industrializimit.

Kjo tablo nuk ka asnjë mesazh tematik, por është një shpërthim absolut artistik. Vepra përfundoi në prag të vdekjes së artistit por zgjati rreth shtatë vjet për t’u kryer. Dhe, pavarësisht se mund të duket si e shkujdesur, e shpejtë dhe impulsive, në fakt ajo është e organizuar dhe e pikturuar me një kujdes të madh. Ndoshta që Cézanne priste edhe njëzetë minuta duke u menduar përpara se të hidhte një penelatë nga tjetra. Figurat dhe kompozimi në tërësi i veprave të tij nuk janë kurrë rastësore por të paramenduara me imtësi. Edhe në këtë tablo, figurat e shumta duken të shpërndara por ndërkohë janë të gjitha të pikturuara në formën gjeometrike të trekëndëshit.

Nëse ndjekim me sy dy qoshet e poshtme të tablosë ato krijojnë një trekëndësh të madh që ngjitet drejt kulmit përmes dy figurave në këmbë, më pas dy trungjeve të pemëve në plan të parë, duke arritur në majë të kanavacës. Edhe gratë që lahen janë të ndara në dy grupe prej të cilave krijohen dy trekëndësh të tjerë, e madje çdo trup i tyre është modeluar për të treguar një trekëndësh më vete. Hapësira në qendër të figurës krijon gjithashtu një trekëndësh me kokë poshtë.

Kjo është një vepër arkitektonike. Figurat dhe pemët janë kompozuar për të ndërtuar një arkitekturë plastike të pikturës. Në të vërtetë, sipas disa kritikëve, madhështia e kësaj tabloje të

kujton fasadën e një katedraleje. E gjithë tabloja është e kulluar, e shpalosur me një art të pastër dhe solid, me një përshkrim integral të natyrës, e mbuluar me një ndjesi të dukshme gjallërie, vlera estetike dhe elementë të harmonizuar. Ndërsa lakuriqësia e femrave i jep veprës edhe një emocion dramatik.

Cézanne u tërhoq marrëzisht me përdorimin e formës femërore si një motiv. Ndjesia e tij plastike e trupave femërore manifestohet me vëllime të bollshme dhe të përcaktuara në mënyrë të thjeshtë. Ndjenjat e artistit në raport me femrat ishin të komplikuar dhe ai

terrorizohej nga gjinia femërore. Ai nuk guxonte të tërhiqej nga modelet nudo dhe nuk ndihej komod në praninë e tyre. Kjo na bën të kuptojmë se çfarë humbje e madhe ishte kjo pengesë për artin e tij. Ai e shpjegoi këtë drojë të tijën ndaj trupit femëror me një traumë fëmijërie, teksa një ditë në shkollë një shok e kishte goditur shumë fort e dhunshëm me shkëlqim teksa ai po qëndronte në një palë shkallë. Ky incident, bashkë me kompleksin që kishte për pamjen e tij, e shtyu të mos kishte shumë besim tek njerëzit dhe të mbyllej në vetvete. Për më tepër, për shkak se vinte nga një fshat me mentalitet provincial ai nuk arriti të mposhte druajtjen ndaj femrave. Për këtë arsye femrat në këtë tablo nuk kanë fytyrë, e duken si qenie të pa-personalizuara, pa personalitet dhe shprehi. Ato janë prototipa. Për artistin forma ishte më e rëndësishme se sa individualiteti i tyre. Cézanne ishte më shumë i interesuar në kompozimin e tërë, në harmoninë midis figurave dhe natyrës, formës dhe ngjyrave. Kësisoj, nuk dallohet asnjë element erotizmi në trupat e tyre. Përkundrazi ato janë me forma të rënda trupore, kokë të vogla, gjymtyrë të tejzgjatura. Ato duken të mbyllura në botën e tyre, duke ekzistuar vetëm për veten e tyre, një pasqyrë e vetë personalitetit të Cézanne. Ato nuk janë të shpalosura mbi një pedestal të idealizuar, e nuk kanë as finesë e as elegancë, por shpalosen si figura të jetës së përditshme. Një trajtim i tillë hapi udhën për një lloj të ri arti në të cilin kompozimi, forma dhe ngjyrat janë kryesore në një vepër.

E gjithë tabloja duket sikur shfityrohet e tërhiqet me magnetizëm drejt majës së piramidës. Figurat dhe natyra duket sikur kanë si pikë graviteti majën e trekëndëshit në krye të tablosë. Duket sikur figurat dhe natyra reagojnë e kundërveprojnë nga një thirrje prej së larti, dhe kjo vihet re më qartë jo vetëm nga dy trungjet e pemëve bojëkafë në qendër të kanavacës por edhe tek figura femërore e shtrirë në të djathtë të veprës. Ajo buron nga këndi i poshtëm e pluskon drejt majës. Kjo qasje i jep kompozimit një aspekt shpirtëror pasi Cézanne ishte gjithnjë në kërkim të Tokës së Premtuar. Në një letër ai shkroi, “E shoh Tokën e Premtuar përpara meje. A do kem edhe unë të njëjtin fat si udhëheqësi madhështor i hebrenjve (Moisiu), apo do lejohem të hy në Tokën e Premtuar?”



Cézanne, Burrat që luajnë me letra

Dhe, kjo përforcohet edhe nga figura e vogël e turbullt përtej lumit e cila, duke simbolizuar vetë artistin, nën kullën e dukshme të kishës, e vështron nga bregu tjetër me admirim atë skenë lumturie dhe harmonie, duke pyetur veten nëse do mund ta kapërcejë atë lumë e të mund të shkojë në atë Tokë të Premtuar.

Kjo vepër ka përmasat më të mëdha se çdo vepër tjetër e Cézanne e madje ishte më e rëndësishmja për të. Cézanne e pikturoi atë brenda studios së tij, por për shkak se ishte e madhe ai hapi një të çarë në mur në mënyrë që ta nxirrte veprën jashtë për ta parë nën dritën e diellit. Risia e veprës ka të bëjë edhe me konceptin e thellësisë dhe dimensionit të tretë. Ai refuzonte ta konsideronte pikturën si dy dimensionale, por tentonte të shihte edhe anën e padukshme të figurave dhe natyrës, duke e bërë edhe shikuesin të dallonte të padukshmen. “Shiheni natyrën si cilindër, sferë dhe kon,” shkroi ai, “të gjitha në perspektivë, në mënyrë që secila anë e një objekti apo plani të drejtohet për nga një pikë qendrore ... Natyra është për ne më shumë një çështje thellësie sesa sipërfaqe.” Dhe kjo vepër përfaqëson më së miri teorinë e tij të thellësisë, të cilën ai e arriti përmes ndërtimit arkitektonik, formave gjeometrike, dhe integritit të okrës me blunë. Në të ai ka shpalosur dashurinë e tij për vëllimin dhe format plastike të arritura përmes ngjyrave.

Cézanne bëri vetëm tre tablo të ndryshme të mëdha mbi tematikën e banjës. Repertori i veprave të tij përbëhet kryesisht nga peizazhe, portrete dhe natyra të qeta me frutjera. “Unë do ta befasoj Parisin me një mollë”, tha në rini Paul Cézanne për një nga pikturat e tij me natyrë të qetë frutash. Megjithatë, mollës së tij iu desh kohë e gjatë për t’u pjekur: ai nuk shiti as edhe një tablo të vetme jashtë rrethit të tij miqësor derisa ishte 35 vjeç dhe nuk hapi asnjë ekspozitë vetjake derisa ishte 56 vjeç. Dhe, artisti që lindi në fshat e që doli vetëm një herë të vetme jashtë Francës, madje vetëm sa kaloi kufirin për në Zvicër, revolucionoi një botë të tërë të artit. Kurrë bota nuk kishte parë frutat e frutjerat, pjatat dhe shishet të shpaloseshin me madhësi të papërshkrueshme. Objektet e tij trajtoheshin si njerëz ndërsa figurat njerëzore integroheshin mrekullisht me natyrën. Ndaj edhe Cézanne i kërkonte

modeleve që pikturonte të qëndronin pa lëvizur për orë të tëra sikur të ishin objekte të një natyre të qetë. Për të, një kokë njeriu nuk dallonte nga një mollë për sa i përkiste kompozimit, sikurse edhe një mollë nuk dallonte nga një portret njeriu. Emocionet nuk i interesonin aspak, as individualiteti, por vetëm kompozimi dhe tabloja si e tërë, si një njësi artistike dhe pioniere e dimensioneve të panjohura të artit.

Cézanne jetoi vetëm për pikturën. Ai vinte nga një familje e pasur, ndaj edhe pse nuk arrinte të shiste piktura nuk i duhej të siguronte jetesën përmes artit. Ai punoi për shumë vite si bankier në bankën e babait të tij, por pasi babai e kuptoi pasionin e të birit për artin e la të lirë dhe e mbështeti financiarisht. Një herë Cézanne shkroi mbi një faturë llogarie: “Bankieri Cézanne frikë ka shumë / Pas kësaj tavoline një artist ndihem unë.” Ai e njihte artistin brenda vetes, por për shkak të refuzimit të madh që iu bë veprave të tij, dhe prishjes së miqësisë së ngushtë me shkrimtarin e njohur Émile Zola, ai vuajti nga depresioni dhe paranoja. Ai jetoi shumë vite në Paris por mbarti gjithnjë me vete rëndësën e refuzimit dhe kompleksitetit të tij si provincial ashtu edhe personal.

Cézanne shpesh fliste për fundin e tij dhe betohej se “unë do të vdes duke pikturuar.” Për një herë të vetme në jetën e tij, dëshira iu plotësua. Më 15 tetor 1906, teksa po pikturonte në natyrë, e zuri një shtrëngatë e fortë. Ai qëndroi me orë të tëra jashtë i lagur dhe e sollën në shtëpi me karrocë. Të nesërmen doli në oborr të pikturonte dhe kur u kthye në shtrat nuk u ngrit më. Ai vdiq për shkak të pneumonisë më 22 tetor 1906 duke mos e kuptuar kurrë ndikimin e jashtëzakonshëm që do linte në artin e shekullit të 20-të.

“I përlurur dhe kolosal” e përshkroi poeti gjerman Rainer Maria Rilke, “i urtë por madhështor.” Cézanne, artisti më i kritikuar e i tallur nga shtypi dhe publiku i kohës, sot njihet si më të rëndësishmit në historinë e artit. Ato tablo që askush nuk donte t’i blinte tashmë kanë vlera marramendëse, si në rastin e tablosë *Burrat Që Luajnë Me Letra* (1895), e cila u shit me vlerën e mbi 250 milionë dollarëve në vitin 2012, dhe emrat e kritikëve janë harruar nga historia ose kujtohen me turp, ndërkohë Paul Cézanne do njihet ndër shekuj si pionieri i modernizmit.



POETI

poezi nga

GEORGE WALLACE

Përktheu nga anglishtja
Edita Kuçi Ukaj

Poeti është një dhomë e braktisur në një qytet të tmerrshëm, ai jeton me të huaj, ai jeton me të vdekurit, ai është i përndjekur nga kujtimet, lart mbi kokë një llambë ndriçimi lakuriq lëkundet, brenda kokës së tij jaguarët bredhin, jaguarët dhe çakejtë poeti shpenzon gjuhë ditën duke mbushë kokën e tij si një rubinet që rrjedh në një lavaman të bllokuar, ai është një njëri në një mision, është një njëri me një problem të vogël kumari, ai është duke mbushë një biletë lotarie me gjithë numrat e gabuar,

sa qesharake! Poeti është një detektiv pa distinktiv, ai është i pranishëm në skenën e

krimit, secili e injoron atë, sidoqoftë kush është ky njeri, pasi që policët largohen ai provon të gjitha rrobat në dollap, asnjë nuk i bie; ai fut në xhepat e tij karamete të forta dhe kremë lëkure; ai është një mbledhës leckash, ai është e gjitha thënë sipër, historia njerëzore është nyjtuar në grusht si një lak, ai është lojë e ndershme për të dashuruarit dhe tregtar i ëndrrave, ai flet të gjitha gjuhët, të gjitha frazat e shqiptuara nga kombe të humbura janë në lojë në kokën e tij, truri i tij është hieroglif, ai jeton në varre të mbretërve të harruar, gjuha e tij është piktura shpellore, testament i tij ishte shkruar nga një fëmije i frikësuar, dhe qyteti e urren atë, ai nuk ka para të shpenzojë dhe asgjë të ofrojë përveç fjalëve, fjalëve, kur pronari i banesës vjen te dera ai shtiret si i vdekur.



Cézanne, Shporta me mollë



BASHKIA KAMËZ

PANAIRI I LIBRIT “KAMZA LEXON”

*“Një ditë lexova një libër dhe e
gjithë jeta ime ndryshoi”*

-Orhan Pamuk-

13 - 14 - 15 Maj 2022, sheshi “Nënë Tereza”